



STUDIME TË DOKTORATËS – CIKLI I TRETË

TEZA:

**“POLITIKBËRJA DHE BALANCIMI NË FUNKSIONIMIN E SISTEMIT
POLITIK TË SHBA-VE”**

Kandidatja:

Mr. Emine Emurllai

Mentori:

Prof. Dr. Etem Aziri

Tetovë, 2018

Deklarata e ndershmërisë

Unë Emine Emurllai, studente në studimet e ciklit të tretë në Fakultetin e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë, nën përgjegjësi të plotë morale dhe ligjore deklaroj që ky punim doktore është rezultat i punës sime hulumtuese dhe asnjë pjesë e tij nuk është marrë nga autorët tjerë, në përjashtim të pjesëve që janë të regjistruara me referencat përkatëse.

Maj, 2018

Mr. Emine Emurllai

Tetovë

Mentor

Prof.dr. Etem Aziri

Universiteti i Evropës Juglindore

Komisioni

Prof.dr. Etem Aziri

Universiteti i Evropës Juglindore

Prof.dr. Zemri Elezi

Universiteti i Evropës Juglindore

Prof.dr. Memet Memeti

Universiteti i Evropës Juglindore

Prof.dr. Alba Dumi

Universiteti “Ismail Qemali” - Vlorë

Prof.dr. Abdulla Azizi

Universiteti i Evropës Juglindore

ABSTRAKT

Hulumtimi i sistemit politik të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe jetës politike të qytetarëve të saj imponohet nga dy arsye, arsyeja shkencore-teorike dhe arsyeja praktike. Ky sistem politik i llojit të vet befason me mekanizmat e vetëpërsosjes. Kuhtetuta edhe pse aq e shkurtër ka dhënë përgjigje në të gjitha dilemat që u paraqitën ndër vite. Të hulumtosh sistemin politik të Shteteve të Bashkuara në të njejtën kohë është kënaqësi, nder, por mbi të gjithat përgjegjësi.

Meqë është fjala për një sistem politik mjaftë kompleks në këtë punim doktrate definova tre qëllime kryesore që shpresoj ti kem deshifruar në përmasa të një doktoranti. E para, jam munduar ti precizoj specifikat bazë të paraqitjes dhe të zhvillimit të sistemit politik të Shteteve të Bashkuara. E dyta, është tentativa që përmes një analize të zhvillimit ekonomik dhe politik të SHBA-ve ti përcaktoj faktorët që determinuan një zhvillim aq të bujshëm të sistemit amerikan të qeverisjes. Në kuptimin e kësaj që u tha, sistemin politik e trajtojmë si ndërthurje apo gërshetim të institucioneve politike të cilat zhvillohen nga një bazë e caktuar shoqëro-ekonomike që nuk paraqet asgjë tjetër veç se element konstituiv të sistemit politik. Duke i analizuar rethanat shoqëro-ekonomike dhe rethanat tjera, historike, kulturore, demografike e kështu me radhë kemi tentuar të vijmë në përfundim se sa janë institucionet e sotme politike që veprojnë brenda sistemit politik të SHBA-ve rezultat i zhvillimit të hovshëm dhe permanent prej fazave më të hershme e deri më sot. Dhe e treta, të vërtetojmë se funksionaliteti i sistemit politik të SHBA-ve është rjedhojë e demokratizimit permanent të shtetit, krijimit të kushteve të barabarta për të gjithë qytetarët e SHBA-ve dhe funksionimit të mirëfilltë të shtetit ligjorë.

Këtë që u tha më lartë jam munduar ta zbërthej përmes pesë pjesëve apo kapitujve me një lidhshmëri të lartë kuptimore. Kështu në pjesën e parë hulumtoj lindjen e Shteteve të Bashkuara, shiquar prej perspektivave historike, ku një hapësirë e mjaftueshme u është kushtuar kolonive angleze dhe formës së organizimit të tyre si në rafshin politik ashtu dhe në atë ekonomik, rebelimit të kolonive dhe shpalljes së pavarësisë. Në pjesën e dytë një vëmendje

më të madhe i kemi kushtuar sjelljes së Kushtetutës, kalimit të sistemit politik të SHBA-ve nga ai konfederativ në atë federativ. Në pjesën e tretë jemi marë kryesisht me funksionimin e institucioneve të sistemit dhe praktikën e një sistemi politik ku me një përkushtim të madh janë respektuar teoritë e Lokut dhe Monteskeut për ndarjen e pushteteve. Në pjesën e katërt kryekëput jemi marë me strukturat e shteteve të veçanta, pra njësive federative, institucionet e tyre dhe raportet e tyre me federatën. Në pjesën e pestë jemi munduar ta sqarojmë logjikën e veprimit të grupeve të interesit dhe partive politike në sistemin amerikan të qeverisjes. Shpresojmë në nivel të kënaqshëm ti kemi zbërthyer tezat dhe hipotezat e parashtruara dhe ky punim doktrinal të paraqesë një kontribut modest shkencor-teorik, dhe të shërbejë në plotësimin e nevojave teorike dhe praktike të lexuesve.

АБСТРАКТ

Истражувањето на политичкиот систем на Соединетите Американски држави и политичкиот живот на нејзините граѓани се наметнува од две причини: научно-теоретската причина и практичната причина. Овој политички систем изненадува со механизмите на самоусовршување. Уставот и ако толку краток дал одговори на сите дилеми кои се појавија во текот на годините. Да го истражуваш политичкиот систем на САД во исто време претставува задоволство, чест, но над се одговорност. Бидејќи станува збор за политички систем кој е многу комплексен, во ова докторска дисертација дефинирам три основни цели кои се надевам дека сум ги дешифрирал на нивото на еден докторант.

Како прво, сум се трудел да ги прецизирам основните спецификации на развојот на политичкиот систем на САД. Второ, преку напорот на една анализа на економскиот и политички развој на САД да ги дефинирам факторите кои беа одредница на толку брз развој на американскиот систем на владеење.

Во смисол на ова што го кажав , политичкиот систем го третираме како комбинација на политичките институции кои се развиваат од одредена општествено-економска база која што претставува ништо друго освен конститутивен елемент на политичкиот систем. Анализирајќи ги општествено-економските околности како и историските, културолошките и демографските околности и така натаму сме се труделе да дојдеме до заклучок за тоа колку денешните политички институции кои работат внатре во политичкиот систем на САД се резултат на брзиот и перманентниот развој од почетните фази до денес.

И трето, да потврдиме дека функционалниот политички систем на САД е последица на перманентната демократизација на државата, создавањето на еднаквите услови за сите граѓани на САД и соодветното функционирање на правната држава. Ова што го кажав погоре сум се трудела да го изанализирам преку петте делови или поглавја со високо ниво на значајно поврзување.

Така што во првото поглавје го истражувам раѓањето на САД преку историските перспективи, каде што задоволителен простор им е посветен на англиските колонии и формите на организирање како на политички така и на економски план, колонискиот бунт и прогласувањето на независноста. Во второто поглавје големо внимание е посветено на донесувањето на уставот, преминувањето на политичкиот систем од конфедеративниот на федеративниот систем.

На третото поглавје поголем акцент е даден на функционирањето на институциите на системот и практиките на еден политички систем каде што со голема посветеност се респектирани теориите на Лок и Монтеске за поделба на овлатувањата. Во четвртото поглавје се анализирани структурите на државите во склоп на САД, значи федеративните единици, нивните институции и нивниот однос со федерацијата. Во петтото поглавје сме се труделе да ја објасниме логиката на однесувањето на интересните групи и политичките партии врз американскиот систем на владеење. Се надеваме дека сме ги анализирале на добро ниво претставените тези и хипотези така што ова докторска дисертација да дава скромна научна и теоретска придонес и да им служи за дополнување на теоретските и практичните потреби на читателите.

ABSTRACT

The study of the political system of the United States of America and the political life of its citizens is imposed by two reasons, the scientific-theoretical reason and the practical reason. This political system of its kind surprises with the self-restraint mechanisms. The constitution though so short has responded to all dilemmas which were presented over the years. To research the United States political system at the same time is pleasure, honor, but above all responsibility.

As it is a very complex political system, in this Ph.D. thesis I defined three main goals, which I hope to have decoded (deciphered) in the dimensions of a doctorate. First, I tried to specify the basics of presentation and development of the United States political system. Second, it is an attempt by an analysis of US economic and political development to determine the factors that led to such a sensational development of the American system of governance. In this sense that was said, We treat the political system as well as a combining or weaving (conjunction or intermingling) with political institutions which are developed from a certain socio-economic basis which represents nothing but constitutive element of the political system. Analyzing socio-economic conditions and other circumstances, historical, cultural, demographic and so on, we have tried to come to the conclusion of today's political institutions operating within the US political system the results of the ever-expanding and permanent development from the earliest stages to date. And third, to confirm the functionality of the US political system is the result of the permanent democratization of the state, creating equal conditions for all US citizens and the proper functioning of the rule of law.

This which was said above, I tried to analyze (break it down) through five parts or chapters with a high sense of attachment. So in the first part I research the birth of the United States, seen from historical perspectives, where enough space has been devoted to English colonies and the form of their organization both in the political and the economic spheres, colonial rebellion and declaration of independence. In the second part we have paid a greater attention to the

conduct of the Constitution, the transition of the US political system from that federal to the federal one. In the third part, we have mainly taken into account the functioning of the system institutions and the practices of a political system where with a great devotion the theories of **Locke** and **Montesquieu** have been respected in the separation of powers. In the fourth part, we have been dealing with the structures of individual states, namely federal units, their institutions and their relations with the federation. In the fifth part we tried to explain the logic of action of interest groups and political parties in the US system of governance.

We hope in a satisfactory level we have broken the theses and hypotheses put forward, and this doctoral thesis presents a modest scientific-theoretical contribution, and serve in meeting the theoretical and practical needs of readers.

Përmbajtje e shkurtër

Kapitulli I: Lindja e Sistemit Politik të SHBA-ve

Kapitulli II: Karakteristikat thelbësore të federalizmit amerikan

Kapitulli III: Funksionimi i institucioneve të sistemit në teori dhe praktikë

Kapitulli IV: Organizimi i njësive federale në sistemin politik të SHBA-ve

Kapitulli V: Roli dhe vendi i partive politike dhe grupeve të interesit në sistemin politik të SHBA-ve

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT.....	4
HYRJE.....	14
1. Arsyetimi i tezës	16
2. Qëllimi i hulumtimit.....	17
3. Hipotezat dhe nën hipotezat.....	18
4. Metodologjia e hulumtimit.....	19
5. Rëndësia e punimit	20

KAPITULLI I

LINDJA E SISTEMIT POLITIK TË SHBA-VE.....	23
1. Pozita e kolonive Britanike në Amerikë deri në shpalljen e pavarësisë së SHBA-ve.....	23
2. Shkaqet dhe shkasat e rebelimit të kolonive Britanike.....	30
3. Konfederata si opsion-anët pozitive dhe negative të organizimit konfederativ.....	34
4. Sjellja e Kushtetutës së vitit 1787 si domosdoshmëri.....	40
5. Federalizmi si alternativë e vetme për zhvillimin e mëtutjeshëm të SHBA-ve.....	50

KAPITULLI II

KARAKTERISTIKAT THELBËSORE TË FEDERALIZMIT AMERIKAN.....	55
1. Afirmimi i ideve për një organizim federativ të SHBA-ve.....	55
2. Kundërshtimi i federalizmit si opsion.....	59
3. Ratifikimi i Kushtetutës së vitit 1787 dhe lindja e sistemit presidencial të SHBA-ve.....	63
4. Organizimi i pushtetit – balancimi dhe kontrolli i ndërsjelltë.....	68

KAPITULLI III

FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE TË SISTEMIT NË TEORI DHE PRAKTIKË.....74

1. Pozita e kongresit në sistemin politik të SHBA-ve.....74
2. Organizimi i Kongresit- përbërja e dhomave.....87
3. Karakteristikat themelore të zgjedhjeve të Kongresit të SHBA-ve.....93
4. Marrëdhënjet e Kongresit me presidentin e SHBA-ve.....98
5. Presidenca e SHBA-ve.....104
6. Mënyra e zgjedhjes së presidentit.....118
7. Pozita dhe kompetencat e presidentit.....131
8. Gjykatat federale – mënyra e organizimit dhe funksionimit.....135

KAPITULLI IV

ORGANIZIMI I NJËSIVE FEDERALE NË SISTEMIN POLITIK TË SHBA-VE.142

1. Organizimi i pushtetit ligjvënës.....142
2. Organizimi i pushtetit ekzekutiv.....150
3. Organizimi i gjyqësorit.....156
4. Organizimi i pushtetit lokal.....160

KAPITULLI V

ROLI DHE VENDI I PARTIVE POLITIKE DHE GRUPEVE TË INTERESIT NË SISTEMIN POLITIK TË SHBA-VE.....166

1. Origjina dhe konstituimi i partive politike.....	166
2. Karakteristikat themelore të partive politike.....	172
3. Kontributi i partive politike në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dy partiak.....	177
4. Koncepti dhe vendi i grupeve të interesit në sistemin politik të SHBA-ve.....	184
5. Raportet ndërmjet grupeve të interesit dhe partive politike.....	196

PËRFUNDIMI.....	200
------------------------	------------

BIBLIOGRAFIA.....	205
--------------------------	------------

HYRJE

Studimi i sistemit politik të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, decenie me rradhë ka nxitur interesim te shkencëtarët dhe teoricienët duke filluar prej Alexise de Tocquevillit e deri te hulumtuesit dhe teoricienët bashkëkohorë. Kushedi sa të shkruhet për këtë sistem politik, përsëri mbetet shumë çka pa u përmend.

Sistemi politik i Shteteve të Bashkuara, në shumë aspekte paraqet një sistem sui generis. Ai dukshëm dallon nga sistemet politike evropiane, si për nga struktura ashtu dhe për nga mënyra e konstituimit dhe funksionimit.

Interesimi i hulumtuesve për sistemin amerikan të qeverisjes, duhet kërkuar edhe në pozitën që SHBA-të e kanë në marrëdhëniet ndërkombëtare, pozitën e tyre si superfuqi ekonomike, politike dhe njëri nga shtetet me një demokraci shumë shumë të avancuar.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës sot në botë njihen si shtet me sistem presidencial, falë pozitës shumë të fuqishme të presidentit të shtetit i cili sipas Kushtetutës është bartës i pushtetit ekzekutiv, njëres nga tre shtyllat mbi të cilat ndërtohet sistemi politik amerikan.

Etërit themelues të Shteteve të Bashkuara, duke i marrë parasysh shumë të aritura të sistemeve politike të asaj kohe, e sidomos avantazhet dhe disavantazhet e sistemit politik të shtetit amë, pra Britanisë së Madhe, me kushtetutë u përcaktuan për një sistem politik ku do të vjen në shprehje një ndarje sa më cilësore mes pushteteve, ndarje kjo që nisej nga sovraniteti i popullit.

Pra, etërit e SHBA-ve, gjatë përpilimit të Kushtetutës u nisën nga qasja teoriko-shkencore mirë e elaboruar në veprat e Lokut, Monteskeut dhe Zhan Zhak Rusoit. Megjithatë, për ata ndarja e pushteteve nuk do ishte e plotë pa kontrollin e ndërsjelltë të tre shtyllave të pushtetit. Andaj, kur flitet për sistemin politik të Shteteve të Bashkuara duhet çdo herë të kemi parasysh ndarjen dhe balansimin e pushtetit.

Principet e më lartë përmendura, nuk do të kishin pasur ndonjë domethënie të veçantë pa ndërtimin e mekanizmave që historikisht kanë ndihmuar sistemin politik të Shteteve të Bashkuara që të veçohet për nga funksionaliteti nga sistemet tjera politike në botë. Këtë me të

madhe gjithësesi e ka ndihmuar edhe fleksibiliteti dhe elasticiteti i Kushtetutës e cila u soll pas shumë debateve të zjarta, ku erdhën në shprehje argumentet dhe kundër argumentet e delegatëve të pranishëm pa marrë parasysh a u përkisnin ata shteteve më të mëdhaja apo shteteve më të vogla.

Përndryshe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës pas sjelljes së Kushtetutës janë zhvilluar si një federatë moderne, ndërsa para sjelljes së Kushtetutës, 13 kolonitë angleze pas pavarësisht e ndërtuan shtetin e përbashkët me një regullim shoqëror-politik konfederativ.

Shiquar në vija të përgjithshme, sistemi politik i SHBA-ve, dallon nga sistemet tjera politike nga aspekti i organizimit dhe veprimit të partive politike, ndikimit shumë të madh dhe inkorporimit në sistemin politik të një numri shumë të madh dhe mirë të organizuar të grupeve të llojllojshme të interesit, si dhe ndërtimit të një baze shumë të qëndrueshme për një zhvillim të ideologjisë liberale dhe neo liberale në ndërtimin e shtetit.

Në aspektin e veprimit të partive politike, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, veçohen dhe mburen me sistemin e tyre të qëndrueshëm dhe mjaft funksional dy partiak. Më shumë se një shekull e gjysëm në arenën politike amerikane dominojnë dy parti politike, Partia Republikane dhe Partia Demokratike. Çdo tentativë për ndonjë ndryshim eventual që do ta kishte rezikuar monopolin e republikanëve dhe demokratëve ka rezultuar pa sukses.

Të gjithë hulmtuesit pajtohen me atë se në formësimin e sistemit politik të Shteteve të Bashkuara, kanë ndikuar kushtet e veçanta të zhvillimit të këtij shteti, e para së gjithash mos ngarkesa me fazën e feudalizmit dhe hapësirat e gjëra si dhe pasuritë e shumta natyrore.

Tokat e lira në drejtim të perëndimit, të cilat deri më vitin 1896 ishin res nullius, dhe mundeshin lirisht të okupohen dhe përpunohen si dhe pasuritë natyrore paraqisnin faktorë të rëndësishëm në zbutjen dhe eliminimin e tendosjeve sociale.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në zhvillimin e tyre kanë shënuar një përparim fantastik material-teknologjik. Nga një vend bujqësorë të kolonistëve të dikurshëm britanik, u shëndruan në një shtet që paraqet superfuqi industriale. Sot, shteti amerikan është në ballë të shteteve

me një progres shumë të avansuar shkencor teknik teknologjik. Automatizimi, kompjuterizimi dhe kibernetizimi janë karakteristika kryesore të zhvillimit ekonomik të këtij shteti.

Shteti amerikan me institucionet e veta paraqet dorën e shtrirë për korporatat multinacionale. Lidhja e ngushtë e ekonomisë me politikën ka mundësuar që ndërmarjet amerikane të jenë të pranishme në tërë globin.

Zhvillimi shkencor teknik teknologjik i Shteteve të Bashkuara ka ndikuar edhe në sistemin politik dhe strukturat e tij. Ky zhvillim imponoi nevojën e zgjerimit të departamenteve dhe agjencioneve qeveritare të cilat sot kanë koncentruar shumë pushtet në duart e tyre.

Pra, duke u nisur nga e më lartëshënuara mundemi lirshëm të konkludojmë se sistemi politik i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në të gjitha aspektet mbetet sistemi më joshës për hulumtuesit e sistemeve politike të profileve të ndryshme.

1. Arsyetimi i tezës

Studimi i sistemit politik të SHBA-ve tani me decenie të tëra e preokupon mendimin teoriko-shkencor që nga Aleksis de Tokvili e deri te hulumtuesit bashkëkohorë. Kjo problematikë nuk shterret pa marrë parasysh numrit shumë të madh të gjithë atyre teoricientëve dhe shkencëtarëve të cilët angazhohen të sqarojnë segmente të caktuara të sistemit presidencial amerikan ose të shkruajnë në përgjithësi për këtë sistem. Me siguri arsyet për një interesim kaq të madh duhet kërkuar në tiparet specifike të këtij sistemi politik, për proceset që ndodhin brenda-përbrenda tij e në radhë të parë për proceset ekonomiko-sociale, shoqëro politike, kulturore e kështu me radhë. Këtu gjithsesi duhet veçuar faktin se sot SHBA-të si shtet dhe si shoqëri paraqesin faktorin kyç brenda bashkësisë ndërkombetare, duke luajtur në shumë situata rol dominant në politikat ndërkombëtare.

Shiquar me një dozë më të madhe të kritikizmit mundemi lirshëm të themi se sistemi politik i SHBA-ve në shumëçka është i dallueshëm krahasuar me sistemet politike të shteteve evropiane, e në radhë të parë dallon struktura e tij, mënyra e konstituimit të institucioneve të sistemit por

edhe menyra e funksionimit të sistemit në përgjithësi. Në qoftë se futemi në detaje të organizimit dhe funksionimit të sistemit politik të SHBA-ve, gjithësesi se duhet të nisemi nga kompetencat shumë të gjera të shefit të pushtetit ekzekutiv që solli deri te ajo që vetë sistemi të emërtohet sistem presidencial, pa mos lënë anash organizimin pak më ndryshe të partive politike, ndikimin shumë të madh të grupeve të llojllojshme të interesit dhe inkorporimit të tyre në sistemin politik, mënyrat e grupimeve politike e deri te fakti se sistemi politik i SHBA-ve paraqet federatën më të vjetër në botë.

Sistemi politik i SHBA-ve, edhe pse për nga shekulli i jetës bën pjesë në grupin e sistemeve të reja politike në menyrë shumë efikase ia doli të vë një ekuilibër ndërmjet polarizmit klasorë dhe politik gjë që nuk mundet të thuhet për vendet e kontinentit të vjetër. E gjithë kjo duhet përshkruar faktin se SHBA-të si shtet nuk kanë mund të jenë të ngarkuara me ndonjë trashëgimi feudale, borgjezia shumë herët e shenoi dominancën e vet sepse zhvillimi kapitalist i vendit gjeti një hapsirë të përshtatshme falë resurseve të begatshme energjetike dhe natyrore. Tokat e lira drejtë perëndimit deri në vitin 1896 mundeshin pa problem të okupohen dhe përpunohen dhe e gjithë kjo ndikonte në uljen e tensioneve sociale dhe pakënaqesive në mes njerëzve duke u mundësuar atyre të jetojnë një jetë që në vendet tjera vështirë realizohej. Duke u nisur nga të lartëshënuarat bëhet më se e qartë se një temë e kështu ka arsyetim të plotë të hulumtohet. Aq më tepër se në mesin e punëtorëve shkencëtar shqiptarë sistemi amerikan i qeverisjes është studjuar shumë pak. Në gishterinjtë e njërës dorë mund të numërohen autorët shqiptarë që janë marrë me këtë problematikë. Edhe ata pak autorë që munden të përmenden, sistemit politik të SHBA-ve i kanë dhënë po aq hapësirë sa edhe sistemeve tjera në kuadër të teksteve universitare ku trajtohen sistemet politike.

2. Qëllimi i hulumtimit

Ky hulumtim duhet të përmbush më tepër qëllime:

E para, hulumtimi (edhe pse në princip është përshkruar) duhet të ofrojë një qasje më ndryshe në lidhje me funksionimin dhe efikasitetin e sistemit politik të SHBA-ve. Ndryshe thënë do të

tentojmë me fuqinë e argumenteve të dëshmojmë anët pozitive dhe negative të sistemit amerikan të qeverisjes, duke marrë çdo herë qëndrim kritik ndaj referencave dhe burimeve tjera që do të shërbejnë si „material” për shkrimin e punimit.

E dyta, qëllim po aq i rëndësishëm i hulumtimit në fjalë do të jetë ofrimi i një pasqyre sa më të kthjelltë për fleksibilitetin dhe elasticitetin e sistemit presidencial të SHBA-ve krahasuar me tipet tjera të sistemeve politike ku vjen në shprehje principi i Lokut dhe Montesjeut mbi ndarjen e pushteteve.

E treta, qëllimi i hulumtimit do të jetë ofrimi i të dhënave burimore për lexuesit në lidhje me mjeshtrinë e përpiluesve të kushtetutës së vitit 1787 që po të njëjtën ta konceptojmë mbi të arriturat më të larta teorike shkencore të asaj kohe, duke i shfrytëzuar gjithmonë edhe praktikatat pozitive në veprimin e regjimeve politike të asaj kohe.

E katërta, një ndër qëllimet e këtij punimi mbetet ofrimi i informacioneve për një zhvillim permanent të SHBA-ve në planin social-ekonomik dhe shkencorë teknik-teknologjik. Nënkuptohe se në konceptin zhvillimorë do të hulumtohen edhe krizat me të cilat është ballafaquar sistemi presidencial i SHBA-ve dhe sfidat për një ardhmëri të sigurtë.

Dhe e pesta, qëllimi i këtij hulumtimi do të jetë edhe funksionimi më ndryshe i partive politike krahasuar me kontinentet tjera si dhe hapësira „manevruese” që vetë sistemi politik dhe partitë politike ua sigurojnë grupeve të interesit dhe lobi grupeve.

3. Hipotezat dhe nën hipotezat

Punimi do të bazohet në një hipotezë kryesore dhe disa hipoteza ndihmëse.

Hipoteza kryesore:

Qëndrueshmëria dhe efikasiteti i sistemit presidencial të SHBA-ve është rrjedhojë e fleksibilitetit të Kushtetutës së vitit 1787 dhe demokratizimit permanent të shoqërisë amerikane.

Hipotezat ndihmëse:

1. Niveli i efikasitetit të sistemit presidencial të SHBA-ve është rrjedhojë e ndërtimit hap pas hapi të shtet –kombit amerikan.
2. Funksionaliteti i sistemit politik të SHBA-ve është rezultat i funksionimit mjaftë efikas të shtetit ligjorë.
3. Funksionaliteti i sistemit politik të SHBA-ve është rezultat i një zhvillimi progresiv socio-ekonomik.
4. Funksionaliteti i sistemit politik të SHBA-ve është rrjedhojë e zhvillimit të hovshëm në rrafshin shkencor-teknik teknologjik.

4. Metodologjia e hulumtimit

Gjatë shkrimit të këtij disertacioni doktorate do të shfrytëzojmë disa metoda standarde që janë të domosdoshme në shkrimin e disertacionit të kësaj natyre dhe atë:

1. Metoda historike
2. Metoda krahasuese
3. Metoda statistikore si dhe
4. Intervista dhe vëzhgimi indirekt

Metoda historike do të vjen në shprehje para se gjithash në pjesët e punimit ku do të studiohet zanafilla e sistemit politik të SHBA-ve si dhe fazat zhvillimore të tij.

Metoda krahasuese do të vjen në shprehje si në pjesët e hulumtimit ku do të veçohen përparësitë dhe hendikepet e mundshme të sistemit presidencial të SHBA-ve krahasuar me sistemet tjera që praktikojnë ndarjen e pushteteve, ashtu dhe në pjesët ku do të krahasohen aktivitetet dhe evaluimi i institucioneve të sistemit presidencial të SHBA-ve shiquar nga prizmi i zhvillimit historik.

Metoda statistikore do të vjen në shprehje sidomos në pjesët ku analizohen zgjedhjet për Kongres dhe zgjedhjet për presidencë, normalisht edhe në pjesët e hulumtimit ku do të flitet për sferën socio-ekonomike e sidomos në pjesën ku do të analizohet progresi shkencor-teknik-teknologjik.

Intervista dhe vëzhgimi (indirekt) shpresojmë të vjen në shprehje po që se na mundesohet të bëjmë një interviste në lidhje me funksionimin e sistemit presidencial të SHBA –ve, me ambasadorin e SHBA –ve në SHkup ose ndonjë zyrtar tjetër të lartë.

Ndërsa vëzhgimi indirekt shpresojmë të vjen në shprehje me rastin e analizimit të ndonjë dokumenti që ka të bëjë me sistemin presidencial të SHBA-ve.

5. Rëndësia e punimit – të priturat

Duke u nisur nga ajo se do t'ia dalim të vërtetojmë hipotezën kryesore dhe hipotezat ndihmëse në një shkallë të lartë, shpresojmë punimi të ketë një rëndësi të veçantë teoriko shkencore dhe politike.

Rëndësia teoriko-shkencore konsiston me faktin se në gjuhën shqipe ka mungesë të shkrimeve mbi sistemin politik të SHBA-ve dhe ky punim shpresojmë të jetë një kontribut me relevancë të veçantë.

Rëndësia praktike e punimit ndërlidhet me nevojat e qytetarëve shqiptarë ta njohin sa më mirë funksionimin e sistemit politik të një superfuqie botërore.

KAPITULLI



LINDJA E SISTEMIT POLITIK TË SHBA-VE

Pozita e kolonive Britanike në Amerikë deri në shpalljen e pavarësisë së SHBA-ve

Shkaqet dhe shkaset e rebelimit të kolonive Britanike

Konfederata si opsion-anët pozitive dhe negative të organizimit konfederativ

Sjellja e Kushtetutës së vitit 1787 si domosdoshmëri

Federalizmi si alternativë e vetme për zhvillimin e mëtutjeshëm të SHBA-ve

1. Pozita e kolonive Britanike në Amerikë deri në shpalljen e pavarësisë së SHBA-ve

Historia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në shumëçka dallon nga historitë e vendeve tjera në botë. Kjo para së gjithash duhet të shihet si rrjedhojë e kushteve dhe rethanave në të cilat u zhvilluan SHBA-të, si shtet që lindën dhe u zhvilluan në një pjesë të rruzullit tokësorë të pa njohur (deri në kolonializimin e kontinentit amerikan) së paku për popujt evropian.

Në lidhje me zbulimin e kontinentit amerikan ekzistojnë fakte botërishtë të pranuar por edhe teori që mundet të supozohet se kanë edhe diçka të vërtetë. Sipas disa burimeve, kontinenti amerikan ka qenë i populluar me popullsi jo autoktone shumë më herët se të ishte zbuluar nga europjanët. Në këtë kuptim vlen të përmendet se sipas disa burimeve supozohet se popujt indigjenë të SHBA-ve, përfshirë edhe vendësit e Alaskës, të kenë mërguar nga Azia. Ata filluan të vinin në kontinentin e Amerikës së paku 12 mijë deri më 40 mijë vjet më parë.¹ Disa nga ata, gjate periudhes parakolumbiane, zhvilluan bujqësi të avancuar, arkitekturë të lartë, si dhe shoqëri të nivelit shtetërorë. Pas fillimit të vendosjes së evropianëve në hemisferën perëndimore, miliona amerikanë vendës vdiqën nga epidemi të sëmundjeve të importuara sikurse që ishte lija dhe sëmundje të tjera.²

Nga ana tjetër patjetër të thuhet edhe ajo se norvegjezët thonë se ata e kanë zbuluar kontinentin e Amerikës shumë para kolombos duke aluduar në „aventurat e vikingëve,,.

¹*Peopling of Americas*. Smithsonian Institution, National Museum of Natural History (June 2004). Vizituar në 19 qershor 2007.

²Meltzer, D.J. (1992). "How Columbus Sickened the New World: Why Were Native Americans So Vulnerable to the Diseases European Settlers Brought With Them?". *New Scientist*: 38–38.

Megjithatë e verifikuar dhe botërishtë e pranuar është ajo se më vitin 1492, Kristofor Kolombo, i kontraktuar nga kurora spanjolle, bëri një udhëtim për të zbuluar rrugën detare për në Indi dhe rastësishtë mbërriti në disa prej ishujve të Karaibeve, duke shënuar kontaktin e parë me popullsinë vendase.

Pra, Kristofor Kollombo ariti në ujdhesat e Kubës dhe Ispanjolës duke menduar se kishte zbarkuar në brigjet e Indisë.

Kontinenti i ri u quajt Amerikë për nder të një peshkatari të quajtur Ameriko Vespuçi i cili sipas gjeografit Martin Voldsimiler i pari e kishte zbuluar këtë pjesë të botës.

Më 2 prill 1513, konkuistadori spanjoll Juan Ponce de León zbarkoi në tokën që e quajti “La [Florida](#)” — që sot i përket SHBA-ve. Së shpejti pas kësaj shtetet evropiane vazhduan në mënyrë intensive ta kolonizojnë teritorin që sot e përfshijnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pra, migrimet spanjolle në rajon u ndoqën nga koloni në SHBA-të e sotme jugperëndimore, të cilat tërhoqën mijëra banorë përmes Meksikës. Tregtarët francezë të leshit themeluan avanposte në Francën e Re rreth Liqeneve të Mëdha. Franca pretendonte një hapsire të madhe të brendisë së Amerikës së Veriut, deri te [Gjiri i Meksikës](#). Shpërnguljet e para të suksesshme të anglezëve rezultuan me ndërtimin e kolonisë së parë, kolonia e Virgjinisë në Jamestoën më 1607 dhe Plymouth i pelegrinëve më 1620. Më 1628 u dha leja për koloninë e Gjirit të Masaçusetsit, gjë që rezultoi me një valë të mërgimeve. Rreth viti 1634, Anglia e Re kishte afro 10 mijë kolonë puritanë. Mes fundviteve 1610 dhe Revolucionit Amerikan, afro 50 mijë të dënuar shkuan në kolonitë britanike të Amerikës.³ Nga ana tjetër më 1614, holandezët u vendosën në rrjedhën e poshtëme të lumit Hudson, duke përfshirë Amsterdamin e Ri në ishullin e Manhattanit.

³. *British Convicts Shipped to American Colonies*. *American Historical Review* 2. Smithsonian Institution, National Museum of Natural History (October 1896). Vizituar në 21 qershor 2007.

Më 1674, holandezët ia lëshuan trevën e tyre në Amerikë Anglisë; krahina e Holandës së Re u riemërua Nju Jork. Shumë imigrantë të ri, sidomos në jug, ishin shërbëtorë me kontratë, psh këtë status e kishin rreth dy të tretat e të gjithë imigrantëve të Virgjinisë mes viteve 1630 dhe 1680.⁴ Kah fundi i shekullit, skllevërit e sjellur nga Afrika po bëheshin burimi parësor i punës së detyruar. Me ndarjen e Karolinës në dy koloni më 1729 dhe kolonizimin e Gjeorgjisë më 1732, u themeluan trembëdhjetë kolonitë britanike nga të cilat u lindën Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Të gjitha kolonitë angleze në kontinentin e ri kishin qeveri vendore me zgjedhje të hapura për shumicën e njerëzve të lirë, me përkushtim në rritje për të drejtat e lashta të anglezëve dhe një ndjesi të vetëqeverisjes që nxiste republikanizmin.

Pra, kolonitë angleze në kontinentin amerikan ishin të organizuara si bashkësi në vete me një shkallë të caktuar të pavarësisë ndaj kurorës dhe pa ndonjë raport institucional ndërmjet veti. Të gjitha kolonitë legalizuan tregtinë me skllevër afrikanë. Lindshmëria e lartë dhe vdekshmëria e ulët, bashkë me imigrimin e vazhdueshëm, bënë që popullsia e kolonive të rritej me shpejtësi. Lëvizja e ringjalljes së krishterimit e viteve 1730 dhe 1740 e njohur si „Zgjimi i Madh,, ngjalli interesim në religjion dhe liri fetarr.

Migrantët në kontinentin e posa zgjedhur i importuan edhe shumë karakteristika të kontinentit të vjetër. Përveç mënyrës së organizimit të pushtetit ata importuan edhe mentalitetin konfliktuoz të shprehur si kompleks për zgjerim të hapësirave gjeografike që nënkuptonte luftëra dhe konflikte shumë të përgjakshme. Në këtë kontekst duhet të përmendet lufta anglo-daneze e vitit 1652 e cila rezultoi me okupimin e Nju Jorkut të sotëm nga ana e Anglisë në vitin 1674, dhe ndarja e Karolinës, në Karolinën e Veriut dhe Karolinën e Jugut. Në konfliktet luftarake shpesh përfshihenin edhe fiset vendore. Kjo erdhi sidomos në shprehje në luftën anglo-franceze.

⁴Russell, David Lee (2005). *The American Revolution in the Southern Colonies*. Jefferson, N.C., and London: McFarland, p. 12. ISBN 0-7864-0783-2.

Kështu në Luftën kundër Francezëve dhe Indianëve, forcat britanike morën Kanadën nga francezët, por popullsia frëngjisht folëse mbeti politikisht e izoluar nga kolonitë jugore. Duke përjashtuar amerikanët vendës të Shteteve të Bashkuara (të njohur si amerikanët indianë), të cilët qenë zhvendosur, këto trembëdhjetë koloni kishin një popullsi prej 2.6 milion banorësh më 1770, që nënkuptonte rreth një të tretën e popullsisë së Britanisë. Gati çdo i pesti amerikan ishte skllav.⁵ Trembëdhjetë kolonitë britanike ishin të obliguara të paguanë tatime të llojllojshme shtetit amë edhe përpos faktit që me kalimin e kohës këta nuk ndjeheshin pjesë përbërëse e Mbretërisë së Bashkuar sepse nuk gëzonin të drejtën e përfaqësimit në Parlamentin e Britanisë së Madhe. Ndjenja e një pabarazie u zhvillua në veçanti pas përfundimit të luftës shtatë vjeçare francezo-britanike që filloi më vitin 1756 dhe përfundoi në vitin 1763.

Me rastin e kësaj lufte me plotë viktime dhe harxhime të shumta materiale, Britania vendosi arbitrarisht që përmes tatimeve shtesë një pjesë të harxhimeve të luftës të bijnë mbi kurizin e kolonëve.

Ashtu siç do të konstatojmë në vazhdim ky vendim i Britanisë ishte aq iritues për kolonitë dhe solli deri te rebelimi i tyre.

Kur bëhet fjalë për pozitën e kolonive angleze në kontinentin e Amerikës, patjetër të thuhet prerazi se mbreti i Anglisë, George i Tretë, në asnjë mënyrë nuk i merrte parasysh kërkesat e kolonistëve. Ai që i vendosur që kolonistët t'i bindeshin dhe të paguanin taksa vazhdimisht pa kundërshtim. Populli i të 13 Kolonive Britanike po zjente atëherë nga shpirti i revoltës kundër sundimit shfrytëzues të Anglisë.

⁵Blackburn, Robin (1998). *The Making of New World Slavery: From the Baroque to the Modern, 1492–1800*. London and New York: Verso, p. 460. ISBN 1-85984-195-3.

Gjithë banorët e kolonive po përqaфонin gjithnjë e më shumë sloganin: “No taxation without representatives”, që do të thoshte “jo taksa pa përfaqësuesit tanë”. Gjithnjë e më shumë kolonistët kishin filluar ta quanin veten jo “anglezë”, po “anglezo-amerikanë, ose vetëm amerikanë. E gjithë kjo solli deri te formimi i organizatave patriotike siç ishin “The sons of Liberty” dhe “Daughter of Liberty”, në çrast u dalluan mendimtarë e aktivistë të shquar si George Washingtoni, Patrik Henry, Samuel Adams, John Adams, Thomas Jefferson e të tjerë. Në këtë kohë Patrik Henry deklaroi trimërisht në sallën e përfaqësuesve të Virxhinias: “Give me liberty, or give me the death” (më jepni vdekje , ose liri), e thënë shkurt shqip, “Liri a vdekje”

Pra, nga dita në ditë atmosfera revolucionare po bëhej gjithnjë e më shpërthyesë në të gjitha kolonitë Britanike të Amerikës së Veriut. Shenja e parë e rëndësishme e stuhisë revolucionare ishte Masakra e Bostonit më pesë Mars, 1770. Këtë ditë mijëra qytetarë të Bostonit dolën në revoltë popullore, siç shprehenin ata kundër sunduesve anglezë. Ata ecnin duke hedhur parulla protestuese. Ushtarët britanikë, të pa zotë për ta frenuar turmën e revoltuar, hapën zjarr mbi popull. Nga të shtënat u vranë pesë protestues dhe u plagosën me dhjetra të tjerë. Kjo ngjarje e përgjakshme bëri bujë dhe jehona e saj u ndje në të gjitha kolonitë. Masakra e Bostonit u bë pretekst i Revolucionit Amerikan.

Me këte rast duhet të kujtojmë se ushtarët që qëlluan me armë zjarri mbi demonstruesit, si edhe ata që dhanë urdhërin, u akuzuan dhe dolën para gjyqit. Qeveria nuk ndërhyri te gjyqësori për këtë çështje. Ajo që duhet veçuar për këtë rast , është se avokati mbrojtës për të pandehurit, ishte John Adams, një nga ideatorët e Revolucionit Amerikan, i cili u zgjodh pas Washintonit, Presidenti i Dytë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Tre vjet më vonë, më 16 Dhjetor, 1773, një grup patriotësh, të maskuar me veshje si indianë u futën në anijet e ngarkuara me pako të medha çaji, të cilat i hodhën në det në gjirin e Bostonit. Për këtë aksion patriotik antiqeveritar, juristi John Adams, do të shprehet: “This is the most magnificent movement of all”. (Kjo është levizja më madhështore se të gjitha lëvizjet në përgjithësi).

Pastaj, pas dy vjetësh, në Prill 1775, shpërtheu beteja e Lexingtonit, që u bë fillimi i pandalshëm i revolucionit Amerikan që po ndizej në të gjitha kolonitë Britanike.

Atëherë, në këto rrethana revolte dhe proteste masive, u mbledh në fshehtësi dhe në mënyrë shumë sekrete Kongresi Kontinental Amerikan, që filloi më 5 shtator 1774. Ky kongres qysh në mbledhjen e tij të parë diskutoi për çështjen e pavarësisë së kolonive, por ende nuk vendosi të shpallte menjëherë luftë për pavarësi. Megjithatë, kjo luftë dukej se ishte e pashmangëshme. Kolonistët tashmë e dinin se nuk kishin ç` prisnin më nga Anglia.

Në mbledhjen e tij të dytë, më 15 Qershor 1775, Kongresi Amerikan duke shqyrtuar për organizimin dhe drejtimin e një ushtrie që të përballonte luftën me Mbretërinë e Anglisë vendosi që të zgjidhte edhe komandantin e përgjithshëm të kësaj ushtrie. Kongresi aprovoi propozimin e juristit të njohur, John Adams, i cili sugjeroi që George Washingtoni të emërohej komandant i përgjithshëm i ushtrisë Amerikane. Ky komandant i famshëm, që si një strateg i talentuar njihte artin ushtarak, udhëhoqi ushtrinë e Revolucionit Amerikan në tërë ato beteja fitimtare.

Pas gati një vit luftimesh, që nga koha kur George Washingtoni mori detyrën e kryekomandantit, Kongresi Amerikan më 4 Korrik 1776, shpalli Deklaratën e Pavarësisë. Ky lajm i shumëpritur u bë publik në sheshin para godinës shtetërore të Filadelfias më datën 8 korrik.. . Atë ditë korriku një këmbanë e madhe buçiti . (the Big Bell rang). Ajo kambanë, që peshon 943 kilogram , e ka gjuhëzen e saj prej me shumë se 22 kilogram. Me buçitjet e saj kambana mbledhi në shesh mijëra e mijëra njerëz për të dëgjuar fjalët e Deklaratës së Pavarësisë. Ideatori dhe hartuesi kryesor i kësaj Deklarate ishte Thomas Xhefersoni, i cili u quajt “Ati i Deklaratës së Pavarësisë”.

Firmëtari i parë i kësaj deklarate qe presidenti i Kongresit Kontinental, John Hancock, i cili e shkroi emrin e vet me shkronja të zmadhuara, duke thënë: “I guess King George will be able to read that” (Unë e marr me mend se mbreti do të arrijë ta lexojë këtë.)

Në pjesën e parë Deklarata konfirmonte se njerëzit janë të barabartë para ligjit. Në pjesën e dytë flitet për qendrimin kritik ndaj mbretit të Anglisë, George i Tretë, i cili pat abuzuar me pushtetin dhe se kolonistët kishin të drejtë të rebeloheshin ndaj regjimit të tij. Dhe, në pjesën e tretë të këtij dokumenti historik deklarohet se kolonitë Britanike shpalleshin tani e përgjithmonë “The United States of America” (Shtetet e Bashkuara të Amerikës)

I mbështetur në parimet e Deklaratës së Pavarësisë, George Washingtoni udhëhoqi me trimëri e zgjuarësinë e një strategu të vërtetë ushtrinë revolucionare të Amerikës në sa e sa beteja të përgjakshme, duke nisur që nga beteja e famëshme e Saratogës, te Long Island, Princeton, Trenton e deri te beteja e Yorktownit, më 19 Tetor 1781. Këtë ditë gjenerali anglez Lord Cornwallis me gjithë ushtrinë e tij prej 7200 trupash iu dorëzua Komandës së Gjeneral Washingtonit. Dy ditë pas kësaj ngjarjeje banda e ushtrisë britanike do të këndonte këngën:

“The World turned upside down” që do të thotë se bota u kthye përmbys.

Me këtë betejë u mbyll epopeja heroike e popullit Amerikan për pavarësi.

Kështu në Amerikë u krijua një shtet i ri, dhe një komb i ri.

Ky shtet i ri do të njihej botërisht , mbas shtatë vjet luftimesh, prej të gjitha vendeve, më datën 3 shtator, 1783, në bazë të vendimeve të Traktatit të Paqes, që u mbajt në Paris midis Mbretërisë së Anglisë dhe Sh.B.A-së.

Revolucioni Amerikan doli vërtetë fitimtar, por vendi nuk qeverisej ende nga një kushtetutë e kompletuar. Në të vërtetë të trembëdhjetë Shtetet e Amerikës qenë marrë vesh që të administroheshin nga një dokument i titulluar “nenet e Konfederatës” (The Articles of Confederation), që ishin esencialisht vazhdimi i orientimeve të Kongresit të Dytë Kontinental.

2. Shkaqet dhe shkaset e rebelimit të kolonive Britanike

Për zhvillimin e sistemit politik të ShBA-ve dhe shoqërisë amerikane në përgjithësi janë me rëndësi të veçantë tre momente dhe atë: periudha e kolonializimit të Amerikës Veriore, lufta për pavarësi dhe fitimi i pavarësisë si dhe faza pas pavarësimit të cilën e karakterizon në fillim karakteri i shprehur patriarkal dhe bujqësorë i vendit e më vonë shëndërrimi i saj në një superfuqi industriale.

Fillet e sistemit politik të SHBA-ve duhet kërkuar në të kaluarën kushtimisht thënë të largët, më saktë në kolonitë angleze të vendosura në pjesën veriore të kontinentit nga të cilat lindën Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Patjetër të thuhet edhe ajo se procesi i ndërtimit të kolonive nuk ishte drejtëvizor sepse secila koloni kishte specifikat e veta dhe mundësi të ndryshme zhvillimore. Si faktorë më të rëndësishëm në formimin e kolonive mund të numrohen: luftërat në të cilat ishte përfshirë Anglia dhe Evropa Perendimore në shekullin e 17 dhe 18-të; konfliktet fetare dhe politike si dhe dëbimet dhe përndjekjet në Angli në fillim të shekullit të 17-të; ndryshimet në marrëdhëniet shoqërore-ekonomike nga një varfëri e aty për atyshme; tendencat për liri më të gjëra fetare dhe formimi i kishave vetanake sipas bindjeve vetanake religjioze; vizioni për fat dhe lumturi në kontinentin e ri; dëshira për pasurim më të shpejtë etj etj. Me formimin e kolonive angleze u krijua një bazë për forcimin dhe zhvillimin e një kombi të rij në Amerikë i cili gjatë zhvillimit të tij do të formojë struktura ekonomike, sociale dhe politike të cilat do të dallojnë nga strukturat e ngjajshme në vendin amë. Për shkak të dallimeve klimatike dhe kushteve tjera natyrore si dhe për shkak të ardhacakëve me prejardhje të ndryshme kolonitë dallonin ndërmjet tyre.

Kolonitë britanike si pjesë integrale e perandorisë, shikuar përgjithësisht ishin të detyruara në një dëgjueshmëri mjaft të lartë ndaj mbretërisë. Kolonitë me mbretërinë i ndanin obligimet e jo gjithmonë edhe të drejtat. Varshmëria dhe ndikimi i kolonive nga Britania mund të konstatohet edhe për nga mënyra e organizimit të jetës shoqërore politike në koloni. Kështu për shembull me pushtetin egzekutiv të kolonive udhëhiqnin guvernatorët e emëruar nga kurora, ndërsa gjyqet ishin të ngjajshëm me ata në Angli dhe gjykoni sipas Common Law. Edhe

qeverisja lokale ishte e organizuar si në shtetin amë, duke u praktikuar disa forma të demokracisë së drejtëpërdrejtë. Në të gjitha kolonitë egzistonte një organ përfaqësues, që ishte një lloj organi ligjvënës. Megjithatë zhvillimi i shpejtë ekonomik i kolonive dhe largësia nga vendi amë që shikuar realisht rezultonte me pamundësinë e një kontrolli të drejtëpërdrejtë dhe efikas, lindën idenë dhe ambiciet e kolonive për pavarësi.⁶

Shiqvar në përgjithësi dy momente ishin vendimtare për rebelimin e kolonive dhe mëvetësimin e tyre, imponimi i respektimit të vendimeve të parlamentit britanik dhe pagesa e taksave të ndryshme të shtetit amë. Një farë lloj kulmi i acarimit të marrëdhënieve në këtë aspekt u arrit pas luftës shtatëvjeçare (1756-1763), në mes Britanisë dhe Francës, të ndihmuar nga fiset indiane për kontrollin e territoreve në Amerikën Veriore. Edhe pse, lufta përfundoi në favor të Britanisë, ishin të shumta shpenzimet e luftës të cilat duhej mbuluar. Britania vendosi që të gjitha harxhimet e luftës ti mbulojnë kolonitë nëpër mes taksave të ndryshme. Kjo kërkesë e Britanisë nuk u mirëprit nga kolonitë të cilat vendosën të shprehin padëgjueshmërinë e tyre. Ndaj padëgjueshmërisë shteti amë mori masa ndëshkuese me qëllim të disiplinimit të kolonive. Masat e ndërmarra nga kurora ishin të njëanshme dhe të papranueshme për kolonitë sepse ata së fundi as që merrnin pjesë në Parlamentin Britanik.

Ndër masat që i ndërmori Britania kundër kolonive të veta në kontinentin amerikan duhet veçuar Ligjin mbi aktet e lundrimit detar që lejonte vetëm lundrimin e anijeve britanike në brigjet detare të kolonive, Ligji i sheqerit (1764) përmes së cilit parlamenti britanik vendosi taksa për sheqerin, kafën, verën dhe disa artikuj tjerë që transportoheshin te kolonitë, Ligji mbi vulat (1765) që nënkuptonte vulosjen me vulë të posaçme të të gjitha dokumenteve, vendimeve shtetërore, përfshirë këtu edhe gazetatat dhe magazinat e ndryshme që lexoheshin në kolonitë britanike dhe Ligji i strehimit që parashihte sigurimin e dhomave të strehimit për ushtarët britanik në shtëpitë e kolonive. E gjithë kjo provokoi reagime të ashpra në kolonitë britanike dhe ndërmarrjen e aktiviteteve që çonin drejtë një pavarësie të plotë.⁷

⁶ Etem Aziri, Sistemet politike, Tetovë 2012, faqe 157.

⁷ Etem Aziri, Sistemet politike, Tetovë 2012, faqe 158.

Masave të Kurorës, kolonitë u kundërpërgjigjën përmes vendimeve të Kongresit të Parë Kontinental që u mbajtë në Filadelfi në vjeshtë të vitit 1774. Në Kongresin e Parë Kontinental ku morën pjesë përfaqësues të të gjitha kolonive me përjashtim të Gjeorgjisë, kolonitë veç tjerash vendosën ti bojkotojnë produktet britanike. Por, gjithsesi për zhvillimet e metutjeshme më e rëndësishme është deklarata politike përmes së cilës kolonitë shprehnin pakënaqësinë e tyre kolektive ndaj Kurorës dhe Parlamentit Britanik. Një vit më vonë, më 1775, në Konkord dhe Leksinton të Masaçusetsit filluan rebelimet e para të kolonëve kundër pushtetit britanik që shënonin dhe fillimin e luftës së armatosur të kolonive për pavarësi. Për të shqyrtuar situatën e krijuar, në maj të po të njëjtit vit në Filadelfia u tubua Kongresi i Dytë Kontinental. Kongresi i Dytë Kontinental pushoi së vepruari në vitin 1781, kur drejtimin e vendit e mori Qeveria që doli nga Nenet e Konfederatës.

Kongresi i Dytë Kontinental që për nga përkrahja e popullit i kishte të gjitha performancat e Qeverisë së parë Amerikane, në periudhën 1776-1781 solli shumë vendime me karakter historik për zhvillimin e ardhshëm të SHBA-ve. Vlen të përmendet organizimi i luftës revolucionare, formimi i ushtrisë, marrëveshjet e bëra me shtetet e jashtme e sidomos sjellja e Deklaratës për pavarësi me 4 korrik 1776 me të cilën 13 kolonitë shpallën pavarësinë e tyre dhe vendimi për formimin e konfederatës në vitin 1777 pas miratimit të Neneve të Konfederatës. E ngushtuar nga situata e krijuar në vitin 1783 Britania e Madhe me marrëveshjen e Versajit e pranoi sovranitetin e Trembëdhjetë Kolonive të veta në kontinentin e Amerikës.

Megjithatë edhe më tutje mbahet e hapur çështja, cilët ishin shkasit e cilat ishin shkaqet e vërteta të rebelimit të 13 kolonive angleze në kontinentin amerikan?! Gjithashtu parashtrohet pyetja a ekzistonin mbrenda kolonive edhe forca që e kundërshtonin shtetin e ardhshëm të pavarur në kontinentin e ri?! Pyetjes së dytë më lehtë mundemi ti japim përgjigje. Gjithsesi në kolonitë angleze vepronin forcat rojaliste, pra forcat pro kurorës. Këto forca ishin të pakta krahasuar me ata që u përcaktuan për një pavarësi të plotë të kolonive nga shteti amë. Me kalimin e kohës fuqia e këtyre forcave u zbeh plotësisht. Sa i takon shkaqeve të vërteta të pavarësimit të gjitha analizat shkojnë në një drejtim, kushtet shumë të volitshme në kontinentin

e Amerikës për një zhvillim të hovshëm që kolonët mirë e përceptuan dhe filluan të gjitha aktivitetet ti zhvillojnë në atë drejtim. Momentet që i përmëndëm më lartë e që u shëndrruan në katalizatorë shumë të fuqishëm e nxitën dhe e ndihmuan në skajshmëri idenë e pavarësisë të kolonive. Edhe pa ata pavarësi do të ndodhte, por me siguri pak më vonë.

3. Konfederata si opion-anët pozitive dhe negative të organizimit kofederativ

Edhe një herë të rikujtojmë se tensionet midis kolonive amerikane dhe britanikëve gjatë periudhës revolucionare të viteve 1760 dhe fillim viteve 1770 çuan në [Luftën Revolucionare Amerikane](#), që zgjati nga 1775 deri më 1781. Më 14 qershor 1775, Kongresi Kontinental, i tubuar në Filadelfi, themeloi Ushtrinë Kontinentale nën komandën e [George Washingtonit](#). Duke proklamuar se “të gjithë njerëzit krijohen të barabartë” dhe të pajisur me “të drejta të patjetërsueshme.” Ashtu siç u potencua më lartë Kongresi nxori Deklaratën e Pavarësisë, të hartuar kryesisht prej [Thomas Jeffersonit](#), . Më 1777, Nenet e Konfederatës themeluan një qeveri të dobët federale që funksionoi deri më 1789.

Pas disfatës britanike nga forcat amerikane të ndihmuara edhe nga francezët, Britania e Madhe njohu pavarësinë e Shteteve të Bashkuara dhe sovranitetin e shteteve mbi trevat në perëndim të lumit Misisipi. Njohja e pavarësisë nga Britania e Madhe nënkuptonte një zhvillim më ndryshe ekonomiko-politik dhe kulturorë të ish kolonive angleze në kontinentin amerikan. Pra, pas përfundimit të luftës kundër Anglisë, Kongresi Kontinental, vendosi që marrëdhëniet e ndërsjella politike të kolonive ti vendos mbi një bazë të re të organizimit. Ashtu siç u përmend gjatë luftës revolucionare u krijuan forcat e përbashkëta ushtarake por jo edhe shteti i përbashkët. Megjithatë, në kushtet e pas luftës u krijuan rethana që në një far lloj mënyre impononin nevojën e një bashkëpunimi më cilësorë të tani më ish kolonive britanike. Rrethanat e krijuara kërkonin diçka më shumë se ajo që kishte nënkuptuar lidhja ushtarake. Forcat

shoqërore të atëhershme, e në radhë të parë borgjezia industriale dhe tregëtare e afirmonte idenë dhe nevojën e një bashkimi, gjegjësishtë lidhje më të fortë të ish kolonive.

Borgjezia në fakt me plot të drejtë kishte ardhë në përfundim se një lidhje më cilësore të 13 shteteve të pavarura paraqet një mundësi shumë më të mirë për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe mbrojtjen e gjithë asaj që ishte arritur gjatë luftës revolucionare. Aktivitetet e Kongresit Kontinental rezultuan me të ashtuquajturit „Artikuj të konfederatës,, të cilat Kongresi revolucionar në Filadelfia pas shumë debatesh i miratoi më 15 janar 1777 ndërsa të gjitha shtetet i ratifikuan në mars të vitin 1781. Në këtë mënyrë ish kolonitë britanike në kontinentin amerikan, formën e parë të organizimit të përbashkët politik do ta shijojnë përmes një organizimi konfederativ të SHBA-ve.

Shiquar në përgjithësi konfederata është sistem (njësi) shtetërorë relativisht kompleksë. Konfederata përbëhet nga disa **shtete** sovrane me disa të drejta të kufizuara (ekonomike, politike). Zakonisht këto të drejta kur janë në pyetje SHBA-të kanë të bëjnë me politikën dhe tregtinë e jashtme të konfederates.

Konfederata krijohet në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare, ndërmjet shteteve të cilat dëshirojnë të kenë raporte të ndërsjellta duke krijuar organe të përbashkëta për lëmi përkatëse. Kjo lidhje e shteteve zakonisht bëhet nëpërmjet një kontrate (akti juridik) lidhur me autorizimet e caktuara, ndërsa shtetet anëtare këtë bashkësi të shteteve edhe mund ta lëshojnë në çdo kohë.

Konfederata, si trajtë e shtetit të përbërë, mund të krijojë organe të përbashkëta të cilat do të marrin vendime të njëzëshme, por të cilat nuk gëzojnë forcën detyruese në qoftë se shteti anëtar nuk i ka pranuar. Vendimet e këtilla, edhe pse mund ta kenë shumicën e votave apo pajtimin e më shumë shteteve anëtare, prapë shtetet anëtare kanë mundësi të dalin nga konfederata. Autorizimet e përbashkëta zakonisht i kanë takuar fushës së jashtme (politikës së jashtme).

Në shumicën e trajtimeve shkencore në fushën e shtetit dhe të së drejtës, konfederatën nuk e përcaktojnë si organizëm i cili qëndron mbi shtetet, por e konsiderojnë si lidhje të shteteve, ku çdo shtet ruan pavarësinë, pra janë shtete sovrane, që do të thotë, shtete të

pakufizuara në ushtrimin e pushtetit vetanak shtetëror. Pra, konfederata s'është organizëm shtetëror, s'është krijim i shtetit të ri, por është raport kontraktues ndërmjet shteteve.

Rregullimi konfederativ i shtetit se shpejti do të dëshmojë paqëndrueshmërinë dhe mosfunktionalitetin e vet si dhe nevojën për ndryshime të domosdoshme.

Konfederata ishte një bashkësi labile e shteteve me një qeveri federale me kompetenca shumë të kufizuara. Segmentet më të rëndësishme për funksionimin e një shteti i cili pas shpalljes së pavarësisë kishte nevoja të shtuara për një funksionim normal ishin nën kontrollin e shteteve të veçanta.

Organi i vetëm i përbashkët i konfederatës ishte Kongresi i Dytë Kontinental (që në fakt e udhëhoqi luftën revolucionare) organ një dhomësh në të cilin secili shtet pa marrë parasysh numrin e banorëve dhe parametra tjerë kishte të drejtë vetëm të një vote, edhe pse delegonin prej 2-7 delegatë. Anëtarët e Kongresit i zgjidhnin kuvendet përfaqësuese të shteteve të veçanta, sipas sistemit zgjedhor të tërthortë e jo zgjedhësit në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Pra, sipas Neneve të Konfederatës pushteti ligjvënës ndodhej në duart e Kongresit njëdhomësh i cili kishte autoritetin të sjellë ligje, të përkujdeset për implementimin e tyre . Kjo sipas të gjitha gjasave duhet ti përshkruhet çastit historik kur Nenet e Konfederatës janë shkruar. Faktikisht ato u miratuan vetëm një vit pas luftës për pavarësi, kur për një pjesë të madhe të njerëzve personifikim i pushtetit egzekutiv ishte mbreti kundër të cilit kishin luftuar. Për këtë arsye, Nenet e Konfederatës nuk parashikonin fare ndarjen e pushtetit në degë të veçanta. Megjithatë, mosegzistimi i degës egzekutive dhe gjykatave kombëtare paraqiste prej fillimi një problem serioz për funksionimin e sistemit politik të SHBA-ve në periudhën në fjalë.

Pra, kompetencat e Kongresit edhe pse shiquar nga aspekti formal-juridik dukeshin shumë të gjëra, në të vërtetë ishin shumë të kufizuara. Përveç sjelljes së ligjeve në kompetencë të Kongresit ishte edhe sfera e punëve të jashtme, kontrolli i marrëdhënieve diplomatike, sjellja e vendime për aktivitete luftarake dhe lidhje të paqes, shtypja e valutave, organizimi i shërbimeve postale, rregullimi i tregëtisë me fiset indiane si dhe zgjidhja e problemeve kufitare ndërmjet shteteve të konfederatës.

Megjithatë, në sferën financiare kompetencat e Kongresit ishin më pakë se minimale. Kongresi nuk e gëzonte të drejtën e caktimit të tatimeve e as që kishte të drejtë në mënyrë të drejtëpërdrejtë të sigurojë të ardhura, kështu që në aspektin financiar ishte i varur nga dëshira e shteteve, gjegjësishtë njësive konfederale. E drejta e kontrollit të tregëtisë ishte nën kompetencat e shteteve të veçanta, kështu që për sjelljen e vendimeve të rëndësishme, do të thoja ekzistenciale konfederata mvarej plotësisht nga vullneti i mirë i delegacioneve të të gjitha shteteve. Për vendimet dytësore duhej të sigurohej më së paku pëlqimi i dhjetë delegacioneve, respektivishtë dhjetë shteteve. Vendimet e Kongresit ishin të detyrueshme për anëtarët e konfederatës por jo edhe për qytetarët që jetonin në kornizat e shtetit konfederativ. Ata bëheshin të obligueshme për qytetarët e shteteve të veçanta prej momentit kur shteti i tyre e ratifikonte një vendim të Kongresit. Konfederata në fakt nuk dispononte me organe ekzekutive e as me një gjyqësor të përbashkët.

Në vitet e para të jetës së përbashkët disa shtete përjetonin kriza të thella ekonomike, ndërsa nuk mungonin as konfliktet brenda njësive konfederative dhe ndërmjet tyre. Luftat tregëtare dhe kufizimet doganore ndërmjet shteteve të veçanta i rrezikonin interesat e borgjezisë amerikane ndërsa Kongresi nuk kishte kompetenca që me autoritetin e vetë do të kishte ndikuar në tejkalimin e gjendjes së krijuar.

Kongresi dalngadal u shëndrrua në një organ të dorës së dytë, pa autoritet politik, me kompetenca të imta, me një fjalë i pa aftë të udhëheqë me shtetin dhe shoqërinë në përgjithësi.

Kompleksi për një barazi të plotë të shteteve të veçanta, autonomia e gjerë e tyre dhe kompetencat tepër të kufizuara të qeverisë qëndrore, sipas fjalëve të Xhorxh Uashingtonit i bënin 13 shtetet të bashkuara vetëm “një litar prej rëre”. Qeveria qëndrore e cila nuk kishte të drejtën e vjeljes së taksave dita-ditës futej thellë e më thellë në borxhe. E gjithë kjo e ulte funksionalitetin dhe autoritetin e saj. Në qoftë se kësaj ia shtojmë edhe mospasjen e autorizimeve për rregullimin e marrëveshjeve tregëtare dhe rregullimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, situata bëhet edhe më e qartë. Në mungesë të autorizimeve të qeverisë kombëtare për rregullimin e disa çështjeve jetike për funksionimin e shtetit erdhi deri te disa situata që çonin drejtë një paralizimi të plotë të funksionimit të konfederatës. Këtu vlen të

përmenden disa nga iniciativat vetanake të shteteve të veçanta. Kështu për shembull disa shtete filluan vetë ti ndërtojnë marrëdhëniet me shtetet e jashtme, disa formuan ushtritë dhe nxorrën valutat e tyre ndërsa në Masaçusets njerëzit filluan të përdorin dhunën kundër Qeverisë Kombëtare. Situata që dita ditës bëhej më e rëndë për funksionimin e Konfederatës kishte vetëm një zgjidhje, ndryshimin e Neneve të Konfederatës.⁸

Kur bisedojmë për konfederatën amerikane, çdo herë duhet të kemi parasysh faktin se ajo u krijua në ato momente ku çdo shtet i veçantë donte ta ruaj sovranitetin e vet, në kohën kur konfliktet tregtare ndërmjet shteteve nuk ekzistonin, në kohën kur obligimet financiare ndaj vendeve tjera ishin shumë të vogla, me një fjalë Konfederata lindi në kohën kur një organizim i atillë shoqërorë e politik ishte joshës për të gjitha shtetet që dolën nga ish kolonitë britanike dhe shtetasit e tyre. Problemet me të cilat ballafaqohej Federata filluan të nxisin ide të tjera të cilat kishin një emërues të përbashkët, ndërtimin e një shteti me qeveri të fuqishme qendrore, me të tre shtyllat e pushtetit, ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësorë por pa mos u dëmtuar edhe të drejtat e njësive konstituive. Për këto ide më detajishtë do të flasim në kapitullin e radhës.

Megjithatë, edhe pse kompetencat e Kongresit ishin shumë të cunguara, shikuar prej këtij dimension kohorë, ata përsëri kanë një peshë të caktuar juridike dhe politike. Në Nenin VI të Neneve të Konfederatës theksohet qartë se pa lejen e Kongresit asnjëri nga shtetet individuale nuk mund të vendosë ambasada e as të lidhë ndonjë aleancë apo marrëveshje me ndonjë mbret, princ ose shtet. Pos kësaj potencohet se asnjë zyrtarë i SHBA-ve nuk mundet të pranojë as dhuratë e as titull nga asnjë mbret, princ ose shtet i huaj. Kjo pjesë e nenit VI është shumë e rëndësishme pasi që nëpërmjet saj për herë të parë Kongresi i lejohet të ketë ndikim të fuqishëm mbi politikën e jashtme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në Nenin VI vërehen edhe hapat e para të kontrollit të zmadhuar të Kongresit mbi forcat e armatosura të vendit. Kështu theksohet se në kohë paqe Kongresi determinon se çfarë mjetesh luftarake mundet të mbajnë shtetet individuale nën kontrollin e tyre.

⁸ Etem Aziri, Sistemet politike, Tetovë 2012, faqe 161

Neni VI i Neneve të Konfederatës kur është në pyetje Kongresi i tejkalon kornizat e kontrollit mbi armatën dhe mbi çështjet e politikës së jashtme. Ai thellë ndërhyr në rregullimin e marrëdhënieve të brendëshme në suaza të SHBA-ve të atëhershme. Kështu, në këtë nen përcaktohet se pa lejen e Kongresit shtetet individuale nuk mund të lidhin kurfarë aleance, marrëveshje ndërmjet tyre. Pos kësaj edhe në rastet kur Kongresi do të lejojë diçka të tillë shtetet përkatëse duhet që paraprakisht ta tregojnë qartë qëllimin dhe kohëzgjatjen e marrëveshjes apo aleancës së tyre. Kjo është shumë e rëndësishme pasi që kufizoheshin dukshëm mundësitë e shteteve individuale që të grupohen në baza të interesave të tyre.

Kur bëhet fjalë për Nenet e Konfederatës një rëndësi e veçantë duhet kushtuar nenit IX, edhe atë për dy arsye kryesore. Së pari në këtë nen theksohet qartë se Kongresi është i vetmi organ në Shtetet e Bashkuara të Amerikës i cili ka të drejtë të shpallë luftë. Dhe së dyti me këtë nen bëhen orvatjet e para për ti dhënë Kongresit një kontroll më të madh mbi politikën monetare dhe tregtinë e vendit, por me të vetmin kusht që vendimet e Kongresit të mos bien ndesh me interesat e shteteve individuale .

Është më se e qartë se Nenet e Konfederatës nuk i kanë zgjedhur të gjitha çështjet e funksionimit dhe autorizimeve të Kongresit amerikan, megjithatë rëndësia e tyre është e pashmangshme për shkak se me Nenet e Konfederatës për herë të parë filluan shtetet individuale ti zgjerojnë autorizimet e Kongresit.⁹

⁹Më gjërësishtë,Etem Aziri,Sistemet politike,Tetovë 2012,faqe 170-172.

4. Sjellja e Kushtetutës së vitit 1787 si domosdoshmëri

Pasi fituan pavarësinë në Luftën Revolucionare (1775-1783), shtetet tani më të pavarura u ballafaquan me problemin e ngritjes së një qeverie në kohë paqeje. Shtetet duhet të vendosnin ligjin dhe rregullin, të mblidhnin taksat, të paguanin borxhet e mëdha shtetërore dhe të organizonin mbi baza ligjore tregëtinë midis tyre. Ato duhej të merreshin gjithashtu edhe me fiset indiane dhe të hynin në bisedime me qeveri të tjera. Udhëheqësit kryesorë si Xhorxh Uashingtoni dhe Aleksandër Hamiltoni, filluan të shqyrtonin krijimin e një qeverie të fuqishme kombëtare të dalë nga një kushtetutë e re.

Hamiltoni dha ndihmën e tij për thirrjen e një kuvendi kombëtar, që duhej ti shqyrtonte Nenet e Konfederatës. Por shumica e delegatëve në kuvend vendosi hartimin e një programi të ri për qeverisjen e vendit, të Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara. Kushtetuta nuk krijoi thjesht një bashkim shtetesh, por një qeveri që ushtroi pushtetin e saj drejtpërsëdrejti mbi të gjithë shtetasit. Kushtetuta përcaktoi qartë gjithashtu kompetencat e qeverisë kombëtare. Krahas kësaj, ajo vendosi mbrojtjen e të drejtave të shteteve dhe të çdo individ.

Kompetencat federative të renditura në Kushtetutë përfshijnë të drejtën për të mbledhur taksat, për të shpallur luftë dhe për të kontrolluar tregëtinë. Krahas këtyre kompetencave të ngarkuara apo të shprehura (ato që janë shprehur në Kushtetutë), qeveria kombëtare ka edhe kompetenca të nënkuptuara (ato që parakuptohen nga Kushtetuta). Kompetencat e nënkuptuara i japin mundësi qeverisë t'u përgjigjet nevojave të ndryshme të vendit. Kështu për shembull, nuk është në kompetencën e ngarkuar të Kongresit që të shtypë kartëmonedha. Por një kompetencë e tillë nënkuptohet në kompetencat e ngarkuara për të huazuar dhe nxjerrë në qarkullim monedha. Ka edhe disa kompetenca që Kushtetuta nuk ia jep qeverisë kombëtare, por që nuk ua ndalon as shteteve. Këto kompetenca të veçanta i përkasin popullit ose shteteve. Kompetencat e shteteve përfshijnë të drejtën për të nxjerrë ligje mbi shkurorëzimin, martesën dhe shkollat shtetërore. Kompetencat që i përkasin popullit përfshijnë të drejtën për të zotëruar pasuri dhe për t'u gjykuar nga një juri. Në disa raste, qeveritë kombëtare dhe

shtetërore kanë kompetenca që i ushtrojnë njëkohësisht bashkë, d.m.th. mund të veprojnë të dyja nivelet qeveritare. Në rast mosmarrëveshjes qeveria kombëtare ka pushtetin më të lartë. Gjykata e Lartë ka pushtet të prerë në shpjegimin e Kushtetutës. Ajo mund të shfuqizojë çfarëdo lloj ligji, federativ, shtetëror apo lokal, që bie në kundërshtim me ndonjë pjesë të Kushtetutës.

Koha po kërkonte që Amerika të udhëhiqej nga një kushtetutë më e studiuar. Revolucionarët amerikanë progresivë e dinin që fitorja kundër anglezeve ishte vetëm fillimi. Ruajtja e fitores dhe forcimi i pushtetit qendror ishin shumë të rëndësishme. Lidhur me këtë problem midis ligjvënësve amerikanë lindi një debat i ashpër. Ishin krijuar dy grupe. Ata që kërkonin forcimin e pushtetit qendrorë, pra, qeverinë e gjithë kombit, quheshin Federalistë. Midis tyre ishin Washingtoni, Hamilton, Medison dhe Xheims Willson.

Aleksandër Hamilton, që kishte punuar për një kohë të gjatë si sekretar personal i Washingtonit, e shprehte hapur mospëlqimin e tij për “Nenet e Konfederatës”. “Kombi, shkruante ai, është si një i sëmurë, dhe që të shërohet do një ilaç të fortë dhe ky ilaç qartësonte ai, është një qeverisje e fortë nacionale”. Kurse ata që nuk donin një qeveri të fortë nacionale, por një qeveri të fortë të shteteve të veçanta, u quajtën Antifederalistë. Këta të fundit nuk e donin një qeveri qendrore federative të fortë, sepse, sipas tyre, një qeveri e tillë fuqiplotë do të zëvendësonte tiraninë britanike me një tjetër qeveri të fuqishme që nuk do të dallonte nga qeveria britanike. Midis opozitarëve antifederalistë, që nuk donin ratifikimin e kushtetutës ishte edhe revolucionari i momenteve të para të Revolucionit Amerikan, Patrik Henry, që arsyetonte se kështu me një qeveri qendrore të fortë “presidenti bëhet një zyrtar shumë i lartë, i cili fare lehtësisht kthehet në mbret”. Pra, midis 13 Shteteve të Bashkuara të Amerikës egzistonte një konfuzion politik përse i përkiste administrimit shtetëror.

Në një atmosferë të tillë plot me debate dhe kundërshtime të ndërsjellta, në verën e vitit 1787 mbledhet në Philadelphia Konventa Konstitucionale. Delegati më brilant i kësaj konvente ishte Xhejms Medison.. Ai ishte më i riu ndër delegatët, por në të njejtën kohë edhe më i përgatituri, më i kulturuari, më profesionali për gjithë çështjet konstitucionale. Ai në fakt ishte hartuesi kryesor i kushtetutës së re Amerikane, prandaj u quajt nga të gjithë si “Babai i Kushtetutës”.

Megjithatë edhe përkundër të gjitha mesazheve dhe informacioneve juridike që jepte me shumë mençuri Medisoni, mosmarrëveshjet nuk eliminoheshin lehtë. Më në fund, delegati i Konectikut, Roger Sherman propozoi kompromisin e tij të famshëm, që u pranua nga shumica e delegatëve të pranishëm. Në bazë të këtij propozimi të gjitha shtetet do të përfaqësoheshin në Kongres në mënyrë të barabartë, duke pasur në Senat nga dy senatorë secili, kurse popullata e shteteve të veçanta do të zgjidhte përfaqësuesit e vetë për në dhomën e përfaqësuesve sipas numrit të banorëve, pra në mënyrë proporcionale.

Kushtetuta e SHBA-ve (anglisht: *Constitution of the United States*) është ligji sipërorë ose akti me i lartë juridik në [Shtetet e Bashkuara të Amerikës](#).¹⁰ Kushtetuta fillimisht përbehej vetëm nga shtatë nene sa ka edhe sot, nënkuptohet pa andamentet që janë sjellë në ndërkohë e që janë po aq të rëndësishme për nivelin e lartë të funksionimit të sistemit politik të SHBA-ve.

Tri Nenet e para ngërthejnë doktrinën e ndarjes së pushteteve, sipas së cilës qeveria federale ndahet në tri degë: ligjvënësi, i përberë prej Kongresit dydhomësh të Shteteve të Bashkuara; ekzekutivi, i përberë nga Kryetari i Shteteve të Bashkuara; dhe gjyqësori, i përberë nga Gjykata e Lartë dhe gjykatat federale.

Nenet pesë dhe gjashtë vendosin doktrinën e federalizmit, duke përshkruar marrëdhëniet ndërmjet shteteve të veçanta dhe ndërmjet shteteve dhe qeverisë federale. Neni i pestë përcakton ecurinë për ndryshimin e Kushtetutës, ndërsa Neni i shtatë përcakton ecurinë për miratimin e Kushtetutës.

Kushtetuta u soll më 17 shtator 1787 nga Kuvendi Kushtetutes në Filadelfi, Pensilvani, dhe u miratua nga kuvendet në njembëdhjetë shtete. Hyri në fuqi më 4 mars 1789.¹¹

¹⁰ Adams, J.Q., and Pearlie Strother-Adams (2001). *Dealing with Diversity*. Chicago: Kendall/Hunt. [ISBN 0-7872-8145-X](#)

¹¹ Cohen, Eliot A. (July/August 2004). ["History and the Hyperpower"](#). *Foreign Affairs*. Marrë më 2006-07-14.

Prej se është vendosë si ligj, Kushtetuta është ndryshuar njëzeteshtatë herë. Dhjetë ndryshimet e para (bashkë me dy të tjera që nuk ishin të miratuara në atë kohë) i paraqiti Kongresi më 25

shtator 1789 dhe u miratuan me tre të katërtat e shteteve të nevojshme më 15 dhjetor 1791.¹² Këto dhjetë ndryshime të para njihen si Karta e të Drejtave.

Kushtetuta interpretohet, plotësohet dhe zbatohet përmes nje korpusi të gjerë të ligjeve kushtetuese. Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara qe e para kushtetutë e llojit të vet dhe ka ndikuar në kushtetutat e shumë vendeve tjera.

Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara paraqet ligjet themelore të shtetit. Ajo vendos formën e qeverisë kombëtare dhe përcakton të drejtat dhe liritë e popullit amerikan. Në të renditen gjithashtu qëllimet e qeverisë dhe metodat e realizimit të tyre. Kushtetuta u hartua duke synuar krijimin e një qeverie të fuqishme kombëtare për shtetet amerikane. Më parë, udhëheqësit e vendit e kishin ngritur qeverinë kombëtare në bazë të Neneve të Konfederatës. Por Nenet e Konfederatës i njihnin pavarësinë çdo shteti. Krahës kësaj, ato nuk mundën të realizonin bashkëpunimin e shteteve për zgjidhjen e problemeve kombëtare.

Qeveria e dalë nga Nenet e Konfederatës nuk ishte plotësisht në gjendje të qeveriste shtetin e ri. Kështu për shembull, asaj i mungonte një degë ekzekutive dhe një sistem gjykatash kombëtare. Ajo nuk mundi të drejtonte tregtinë midis shteteve, as të tatonte shtetet apo shtetasit e tyre. Ajo nuk ishte veçse një kuvend i përfaqësuesve të 13 shteteve të pavarura.

Në vitin 1783, pas Luftës Revolucionare, vendi hyri në një periudhë rrethanash të paqëndrueshme tregtare e politike. Aleksandër Hamiltoni me përkrahësit e tij nuk do të kishin qenë aq të suksesshëm në fushatën e tyre për një kushtetutë të re, sikur gjendja të kishte qenë më e mirë. Disa historianë i kanë përshkruar me ngjyra shumë të errëta vështirësitë e republikës së re. Megjithatë pa dyshim që pas vitit 1783, gjendja u keqësua pandërprerë. Çdo shtet vepronte pothuajse si vend i pavarur. Secili i drejtonte punët ashtu siç e shikonte të përshtatshme, pa treguar shumë interes për nevojat e republikës.

¹². "[Madison Debates September 15](#)". *The Avalon Project at Yale Law School*. Retrieved April 16, 2016.

Shtetet qarkullonin një sërë monedhash të ndryshme, shumica e të cilave kishin vlerë të ulët. Shtetet fqinje tatimonin mallrat e njëri-tjetrit. Britania e Madhe nuk pranoi të rihapte kanalet e tregtisë prej të cilave varej mbarëvajtja ekonomike e ish kolonive. Legjislaturat shtetërore nuk pranonin të paguanin borxhet që kishin marrë gjatë Luftës Revolucionare. Shumë shtete nxorrën ligje që u dhanë mundësi debitorëve t'i shmangeshin pagimit të detyrimeve.

E keqja më e madhe ishte se pati edhe nga ata që filluan të mendonin për zgjidhjen me armë të problemeve. Në vitin 1786, në përfundim të shtetit Masaçusets, qindra fshatarë me në krye kapitenin Deniell Shejz u ngritën kundër qeverisë shtetërore në Boston. Përfundimisht rebelimi i Shejzit u shtyp nga forcat shtetërore. Xhorxh Uashingtoni me disa udhëheqës të tjerë dyshonin se mos kolonitë kishin ngritur krye më kot kundër Britanisë së Madhe. Ata e ndjenë se kishte ardhur koha për t'i dhënë fund trazirave të tilla dhe për të vendosur paqen e rregullin nëpërmjet krijimit të një qeverie të re kombëtare. Kësaj qeverie të re do t'i duhej të ishte tepër e fuqishme që të fitonte bindjen e popullit brenda vendit dhe respekt jashtë tij.

Në vitin 1786, përfaqësuesit e pesë shteteve u mbledhën në Annapolis të Merilendit. Ata propozuan që shtetet të caktonin delegatët që do të mbledheshin në Filadelfia për të bërë rishikimin e Neneve të Konfederatës.

Kongresi e pranoi propozimin e bërë dhe dha mendimin që çdo shtet të zgjidhte delegatët për një kuvend kushtetues.

Kuvendi pritej të hapej më 14 maj 1787. Atë ditë në Filadelfia kishte ardhur vetëm një numër i vogël nga 55 delegatët e propozuar. Përfundimisht Kuvendi u hapi punimet zyrtarisht në 25 maj, në Sallën e Pavarësisë. Thirrjes për në Kuvend i ishin përgjigjur vetëm dymbëdhjetë shtete. Rhode Island nuk pranoi të dërgonte delegatë, pasi ishte kundër ndërhyrjes së qeverisë kombëtare në punët e tij.

Jo të gjithë delegatët pjesëmarës e nënshkruan kushtetutën e sjellur. Vetëm 39 prej 55 delegatëve e nënshkruan Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara më 17 shtator 1787. Njëri prej nënshkruesve ishte edhe Xhon Dikinsoni nga shteti Delaware, i cili ndonëse e la Kuvendin, i tha delegatit Xhorxh Rid të nënshkruante në emër të tij. Nënshkrimi i Kushtetutës u bë në praninë e sekretarit të Kuvendit, Uilliam Xhekson. Midis delegatëve ishin disa prej njerëzve më patriotë dhe më me përvojë të republikës së re. Xhorxh Uashingtoni ishte kryetar i Kuvendit. Benxhamin

Frenklini përfaqësoi Pensilvaninë në moshën 81 vjeçare. I madhërishtmi Aleksandër Hamilton përfaqësoi Nju-Jorkun. Me fjalimet, bisedimet dhe përpjekjet për kompromis, Xhejms Medisoni i shtetit Virxhinia mori titullin "Babai i Kushtetutës". Medisoni u tha delegatëve se po shqyrtonin një program që "do të përcaktonte përgjithmonë fatin e geverisë republikane". Ai protokolloi diskutimet dhe vendimet e delegatëve. Ndër ata që u morën më shumë me shkrimin e Kushtetutës së re ishin Xhon Dikinson, Guverne Moris, Edmund Rendëllf, Roxhër Shermën, Xhejms Uillson dhe Xhorxh Uaidh. Morisi ishte ndoshta delegati më me influencë pas Medisonit dhe Uashingtonit. Atij i ishte ngarkuar detyra për të formuluar sa më bukur rezolutat dhe vendimet e Kuvendit. Në të vërtetë, Morisi e "shkruajti" Kushtetutën. Një kopje origjinale e dokumentit ruhet në ndërtesën e Arkivit Kombëtar në Uashington, D.C.

Në Kongres nuk morën pjesë disa prej figurave të rëndësishme të kohës. Xhon Edëmsi me Tomas Xhefersonin nuk ishin të pranishëm, pasi ishin me detyra të tjera qeveritare. Semjuell Edëmsi dhe Xhon Xhej nuk arritën të zgjidheshin delegatë nga shtetet e tyre. Pas zgjedhjes së tij si delegat, Petrik Henri nuk pranoi të shkonte, pasi ishte kundër zgjerimit të pushtetit të qeverisë kombëtare. Tre anëtarët kryesorë të Kongresit, Elbrixh Gerri, Xhorxh Mejson dhe Edmund Rendëllf, nuk pranuan ta nënshkruanin Kushtetutën, pasi nuk pajtoheshin me disa pjesë të saj.

Gjatë punës për një rend të ri kushtetues, delegatët në Kuvend u mbështetën shumë në përvojën e së kaluarës. Ata rikujtuan shumë ngjarje të rëndësishme që kishin ndodhur gjatë qeverisjes kushtetuese të shteteve të ndryshme, si për shembull: nxjerrja e dokumentit kushtetues anglez Magna Carta në vitin 1215 dhe mbledhja e Asamblesë Përfaqësuese të Xhejmstaunit në vitin 1619. Si shembuj formash kushtetuese të qeverisjes së vendit shërbyen gjithashtu edhe disa prej kolonive amerikane. Ato kishin të meta, megjithatë kishin përparuar më shumë se qeveritë e tjera të kohës në ndërtimin e një shoqërie të lirë, ku vepronin ligjet.

Në kohën e Luftës Revolucionare, disa shtete amerikane vendosën qeveri kushtetuese. Në vitin 1777, Xhon Xhej nga Nju-Jorku kishte ndihmuar në hartimin e një kushtetute për shtetin e tij. Xhon Edëmsi nga Masaçusets kishte dhënë ndihmën e tij për hartimin e kushtetutës së Shtetit Masaçusets të vitit 1780. Delegatët e Kuvendit të Filadelfias përmendën shumë ide dhe shprehje nga kushtetutat e këtyre shteteve dhe të shteteve të tjera.

Delegatët shprehën edhe përvojat e tyre të veçanta. Kështu, në Kongresin e qytetit Ollbëni të vitit 1754, Benxhamin Frenklini kishte propozuar një plan për bashkimin e kolonive nën një qeveri qendrore. Uashingtoni përmend shqetësimet që i kishin dalë në kohën e Luftës gjatë bashkëpunimit si komandant i përgjithshëm me qeverinë e dobët të Konfederatës. Pothuajse të gjithë delegatët e Kuvendit kishin qenë ushtarakë apo drejtues të qeverisë. Shpesh delegatët nuk pajtoheshin për hollësira, megjithatë të gjithë njëzëri kërkonin që qeveria e re të ishte tepër e fuqishme në drejtimin e vendit. Ata kërkonin gjithashtu që qeveria të respektonte liritë e shteteve dhe të popullit.

Detyra për krijimin e një qeverie të re nuk u krye me shumë lehtësi. Kishte raste kur Kuvendi rrezikohej të mbyllej nga polemikat midis delegatëve. Kështu për shembull, pati mosmarrëveshje midis delegatëve të shteteve të mëdha dhe të vogla për numrin e përfaqësuesve në legjislaturën kombëtare. Shtetet e mëdha përkrahnin Planin Virxhinia, sipas të cilit numri i përfaqësuesve përcaktohej nga numri i popullsisë. Shtetet e vogla ishin për Planin Nju-Xhërsi, sipas të cilit të gjithë shtetet duhet të kishin numër të njëjtë përfaqësuesish. Ashtu siç potencuam më lartë, delegatët e shtetit Konektikat bënë një propozim që e zgjidhi problemin. Plani i tyre parashikonte që numri i përfaqësuesve në Senat të ishte i barabartë, ndërsa në Dhomën e Përfaqësuesve ky numër të përcaktohej në raport me numrin e popullsisë. Ky propozim u njoh me emrin Kompromisi Konektikat ose Kompromisi i Madh.

Kompromiset zgjidhën gjithashtu mosmarrëveshjet për çështjen e skllavërisë. Delegatët e shteteve të Veriut kërkonin që Kongresi të kishte të drejtë të ndalonte tregtinë e huaj të skllavëve. Ndërsa shumica e delegatëve të shteteve të Jugut nuk ishin për një gjë të tillë. Me kompromis u vendos që Kongresit t'i ndalohej kontrolli mbi tregtinë e huaj të skllavëve deri në vitin 1808. Një kompromis tjetër kishte të bënte me problemin se si do të kryhej numërimi i skllavëve, prej nga ku do të përcaktohej edhe numri i kongresistëve për çdo shtet. Skllavërit nuk konsideroheshin shtetas, ndaj edhe Kuvendi ra dakord që të numëroheshin vetëm tre të pestat e tyre.

Delegatët ranë dakord që çdo shtet të mbante një kuvend të veçantë, ku do të diskutohej dhe të votohej për Kushtetutën. Ata vendosën gjithashtu që sapo Kushtetuta të ratifikohej (miratohej) nga nëntë shtete, do të hynte në fuqi dhe do të fillohej pastaj me formimin e

qeverisë së re. Nuk kishin kaluar ende tre muaj nga dita e nënshkrimit të Kushtetutës, kur më 7 dhjetor 1787 shteti Delaware e ratifikoi atë. Nju-Hemshër ishte shteti i nëntë që bëri që Kushtetuta të hynte në fuqi më 21 qershor 1788. Megjithatë, baballarët e Kushtetutës nuk ishin ende të sigurtë nëse Kushtetuta do të pranohej nga të gjithë, derisa ajo u ratifikua edhe nga shtetet e rëndësishme të Nju-Jorkut dhe Virxhinias. Në këto dy shtete, si dhe në disa të tjera, kundër Kushtetutës ishte krijuar një opozitë e organizuar dhe e fortë. Ndër ata që u shprehën kundër ratifikimit të saj ishin Ibrixh Gerri, Riçard Henri Li dhe Xhorxh Mejsoni.

Kundërshtarët kritikonin mospërfshirjen në Kushtetutë të një karte të drejtash, pavarësinë tepër të madhe të presidentit dhe natyrën aristokratike të Senatit. Ata ishin gjithashtu të mendimit se Kushtetuta i jepte Kongresit dhe qeverisë kombëtare kompetenca të tepërta. Ithtarët e Kushtetutës mbledhën rreth tyre përkrahës të ratifikimit. Ata u njohën me emrin Federalistë, ndërsa kundërshtarët e tyre me emrin Antifederalistë. Të dyja grupet i mbështetën idetë e tyre në gazeta, pamflete dhe në diskutimet e bëra në kuvendet për ratifikimin e Kushtetutës. Prej këtyre grupeve lindën partitë e para politike amerikane.

Virxhinia e ratifikoi Kushtetutën më 25 qershor 1788, ndërsa Nju-Jorku më 26 korrik. Në janar të vitit 1789, të gjitha shtetet ratifikuese me përjashtim Nju-Jorkut, i kishin zgjedhur deputetët ose në legjislaturat e tyre, ose me votim të drejtpërdrejtë popullor. Më 4 shkurt, zgjedhësit caktuan Xhorxh Washingtonin President të parë të Shteteve të Bashkuara. Kongresi i parë pas miratimit të Kushtetutës u mbajt në 4 mars, në Nju-Jork. Uashingtoni e bëri betimin në 30 prill. Karolina Veriore dhe Rhode Island nuk e miratuan Kushtetutën e nuk morën pjesë në qeverinë e re, derisa Kongresi pranoi të shtonte një kartë të drejtash.

Në disa shtete të rëndësishme, federalistët mund të mos e kishin arritur kurrë ratifikimin e Kushtetutës, po të mos kishin premtuar se do të mbështetnin amendamentet. Këto amendamente u hartuan për mbrojtjen e të drejtave të individit nga ndonjë ligj i padrejtë që mund të nxirrej prej qeverisë kombëtare. Shumica e kushtetutave që kishin vepruar gjatë Revolucionit, kishin patur edhe nga një deklaratë të qartë për të drejtat e njeriut. Shumica e amerikanëve mendonin se një kushtetutë nuk mund të quhej e plotë pa një deklaratë të tillë. Për hartimin e Deklaratës së të Drejtave të vitit 1776 për shtetin Virxhinia, që është karta e parë dhe më e famshme e të drejtave në Shtetet e Bashkuara, ishte ngarkuar Xhorxh Mejsoni nga

Virxhinia. Ai dhe Petrik Henri mund ta kishin penguar ratifikimin e Kushtetutës në Virxhinia, në qoftë se federalistët nuk do të pajtoheshin me kërkesat e tyre për amendamente.

Propozimin e amendamenteve në Kongres e priu Xhejms Medisoni. Ai propozoi 15 amendamente, prej të cilave Kongresi pranoi 12, që do t'i paraqiteshin shteteve për miratim gjatë procesit të shqyrtimit të amendamenteve, të përcaktuar në nenin V të Kushtetutës. Deri më 15 dhjetor 1791, mjaft shtete kishin miratuar dhjetë prej dymbëdhjetë amendamenteve, për t'i përfshirë ato përgjithmonë në Kushtetutë. Këto amendamente njihen si Karta e të Drejtave. Njëri prej dy amendamenteve të pamiratuara kishte të bënte me numrin e anëtarëve të Dhomës së Përfaqësuesve. Amendamenti tjetër i pamiratuar parashikonte që Kongresi të mund të mos i ndryshonte pagat e anëtarëve të tij, derisa të zhvilloheshin zgjedhjet e Përfaqësuesve.

Për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme të Shteteve të Bashkuara, me kalimin e viteve Kushtetuta është zgjeruar dhe përsosur më tej. Xhejms Medisoni pati deklaruar: "Në ndërtimin e një sistemi që do të dëshironim të zgjaste me shekuj, nuk duhet të harrojmë ndryshimet që do të sjellin këto shekuj." Kushtetuta u hartua për t'i shërbyer interesave të njerëzve, qofshin të pasur apo të varfër, banorëve të Veriut apo të Jugut, fermerëve, punëtorëve dhe afaristëve. Pasi hyri në fuqi Kushtetuta, antifederalistët pranuan humbjen dhe filluan përpjekjet për ta marrë pushtetin në mënyrë kushtetuese. Veprimtaria e tyre krijoi në politikën amerikane një praktikë që nuk ka ndryshuar qysh atëherë. Ka raste kur amerikanët janë të pakënaqur me politikën dhe praktikën që ndjekin qeveritarët. Megjithatë të paktë janë ata amerikanë që mund t'ia kenë lënë fajin sistemit kushtetues, apo të kenë qenë të mendimit se një kuvend i dytë kushtetues mund të vendoste një sistem më të mirë. Delegatët e Kuvendit Kushtetues kishin besim të fortë në sundimin e shumicës, megjithatë ata kërkonin të mbronin të drejtat e pakicave nga ndonjë padrejtësi e shumicës. Këtë e arritën duke bërë ndarjen dhe balancimin e kompetencave të qeverisë. Ndër synimet e tjera kushtetuese bazë ishin: respektimi i të drejtave të individit dhe të shteteve, udhëheqja nga vetë populli, ndarja e kishës nga shteti dhe epërsia e qeverisë kombëtare.

Amandamentet janë shtojca që i janë bërë Kushtetutës. Deri në vitin 1991, Kushtetutës i ishin shtuar 26 amendamente. Ato mund të propozohen nga dy te tretat e çdo dhome të Kongresit

ose nga një kuvend kombëtar që mund të thërrasë Kongresi. Një amendament bëhet pjesë e Kushtetutës pasi të jetë ratifikuar nga legjislaturat e tre të katërtave të shteteve ose nga kuvendet po në tre të katërtat e shteteve. Kongresi vendos formën e ratifikimit që duhet përdorur dhe cakton kohën gjatë së cilës shtetet duhet të shqyrtojnë çdo amendament. Në shumë raste, Kongresi ka caktuar një periudhë shtatë vjeçare për një shqyrtim të tillë.

Ligjet e sjellura ndër vite e dekada i kanë dhënë kuptim të ri Kushtetutës. Delegatët e Kuvendit Kushtetues e kishin të qartë që nuk do të mund të hartonin ligje për çdo rast të veçantë. Për këtë arsye, ata i njohën Kongresit të drejtën për të nxjerrë ato ligje që ishin "të domosdoshëm dhe të duhur" në punën e presidentit, Kongresit dhe gjykatave federative për plotësimin e kompetencave të garantuara nga Kushtetuta. Kështu Kongresi ka nxjerrë ligje për krijimin e organizatave të tilla administrative si: Administrata Federative e Aviacionit dhe Shërbimi Postar. Kongresi ka nxjerrë gjithashtu ligje për rregullimin e tregtisë midis shteteve, duke mundësuar kështu kontrollin mbi shumë aspekte të ekonomisë amerikane.

VENDIMET GJYQËSORE. Gjyqtarët federativë dhe shtetërorë e zbatojnë Kushtetutën në shumë çështje gjyqësore. Gjykata e Lartë ka pushtet të prerë në shpjegimin e kuptimit të Kushtetutës për çfarëdo rasti të veçantë. Ajo ka të drejtën e rishikimit juridik, d.m.th. ajo mund ta shpallë një ligj si jokushtetues. Gjykata e Lartë e gëzon një të drejtë të tillë kryesisht për shkak të vendimit të marrë nga kryegjyqtari Xhon Marshëll në çështjen e Marbërit kundër Medisonit në vitin 1803. Qysh atëherë, gjykata ka gjykuar si jokushtetues më shumë se 90 ligje federative dhe qindra ligje shtetërore.

VEPRIMTARIA PRESIDENCIALE. Presidentët e fortë kanë ditur ta përdorin autoritetin e tyre duke nxjerrë nga fjalët e thjeshta të nenit dy të Kushtetutës pushtet të madh presidencial. Të tillë kanë qenë presidentët Xhorxh Uashington, Tomas Xhefërsen, Endru Xhekson, Abraham Linkoln, Theodor Ruzvelt, Udrou Uillson dhe Frenklin D. Ruzvelt. Presidenti Uashington për shembull, u bë figura kryesore në punët e jashtme. Linkoln i përdori pushtetin e garantuar nga neni i lartpërmendur për të çliruar skllevërit gjatë Luftës Civile (1861-1865) etj.

Tradita e ka bërë Kushtetutën elastike dhe i ka shtuar kompetencat e qeverisë kombëtare. Kështu për shembull, Këshilli Presidencial u formua në bazë të nenit dy, i cili e lejon presidentin

të "kërkojë me shkrim mendimin e zyrtarit më të lartë të çdo dege ekzekutive, rreth çfarëdo çështjeje që ka të bëjë me detyrat e saj përkatëse..."

Kushtetuta cakton një mënyrë të përgjithshme për zgjedhjen e Presidentit. Në të nuk përmenden partitë politike. Megjithatë ligjet shtetërore dhe praktikat politike të partive kanë bërë që në ditët tona sistemi kushtetues i votimit të zhvillohet në fushata dhe zgjedhje shumë të gjalla.

Kushtetuta është përsosur vazhdimisht nëpërmjet gjithë këtyre metodave, duke iu përgjigjur kështu kërkesave të një shoqërie në zhvillim të pandërprerë. Megjithatë fryma dhe teksti i Kushtetutës nuk kanë ndryshuar. Njerëzit e çdo brezi e kanë zbatuar atë në rrugë, që i janë dukur atyre të përshtatshme.

Shtetari anglez Uilliëm E. Gledstëun e ka cilësuar Kushtetutën e SHBA-ve si "veprën më të shkëlqyer që mund të ketë nxjerrë ndonjëherë mendja dhe vendosmëria njerëzore." Në një botë ndryshimesh dhe trazirash, populli amerikan nuk ka asgjë më të vyer se këtë dokument të madh.

5. Federalizmi si alternativë e vetme për zhvillimin e mëtutjeshëm të SHBA-ve

Federalizmi i referohet mënyrës të përzier ose të qeverisë të përbërë , duke kombinuar një qeveri të përgjithëshme (e qeverisë qendrore apo "federale") me qeveritë rajonale (provinciale, shtetërore, Tokës, kantonale, territoriale apo të qeverive të tjera nën-njësi) në një sistem të vetëm politik. Tipar i saj i veçantë, i ilustruar në shembullin themelues të federalizmit modern të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në bazë të Kushtetutës së 1787, është një marrëdhënie e barazisë në mes dy niveleve të qeverisjes së themeluar. Ajo në këtë mënyrë mund të përkufizohet si një formë e qeverisjes në të cilën ka një ndarje të kompetencave mes dy niveleve të qeverisjes të statusit të barabartë.

Termat 'federalizmi' dhe 'konfederalizmi' të dy kanë një rrënjë nga fjala latine foedus, që do të thotë "traktat, pakt apo besëlidhje". Kuptimi i tyre i përbashkët deri në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë ishte një aleancë e thjeshtë apo marrëdhënie ndër-qeveritare në mesin e

shteteve sovrane të bazuar mbi një traktat. Prandaj ata fillimisht ishin sinonime. Në rrjedhën e shekullit të nëntëmbëdhjetë kuptimi i federalizmit do të zhvendoset.

Federalizmi modern është një sistem i bazuar mbi rregullat dhe institucionet demokratike, në të cilën fuqia për të qeverisur është e ndarë në mes të qeverive kombëtare dhe provinciale / shtetërore. Termi federalist përshkruan disa bindje politike në mbarë botën në varësi të kontekstit.

Federalizmi në Shtetet e Bashkuara është marrëdhënia në zhvillim në mes të qeverive shtetërore dhe qeverisë federale të Shteteve të Bashkuara. Qeveria amerikane ka evoluar nga një sistem të federalizmit të dyfishtë në një federalizëm të bashkuar. Alexander Hamilton, duke shkruar në "Federalist nr 28", sugjeroi që të dy nivelet e qeverisë të ushtrojnë autoritetin për të mirën e qytetarëve.

Federalizmi amerikan është një sistem i qeverisjes me kompetenca të ndara në mes të dy apo më shumë qeverive me autoritet mbi të njëjtin popull dhe zonë gjeografike.¹³ Për dallim nga shteti unitar, në të cilin qeveria qendrore ka autoritet të plotë mbi organet tjera administrative, në shtetin federal bëhet ndarja e kompetencave të qeverisjes në mes të qeverisë qendrore dhe qeverive shtetërore apo regjionale. Format e para të federalizmit i hasim që nga Greqia antike nëpërmjet bashkëpunimit të qyteteve dhe shteteve greke në shekullin e tretë para epokës së re, por hartuesit e Kushtetutës amerikane të vitit 1787 janë ata që themeluan formën e parë të federalizmit modern. Ata u detyruan të bëjnë një gjë të tillë ngase shtetit të ri i nevojitej një qeveri kombëtare shumë më e fortë se sa qeveria e dalë nga Nenet e Konfederatës. Me që qeveria kombëtare, e ndërtuar nga etërit themelues, e ka burimin e pushtetit drejtëpërdrejtë nga populli, të dyja palët, si qeveria kombëtare ashtu edhe ato shtetërore, janë përgjegjëse para qytetarëve të vendit. Duke iu frikësuar tiranisë, hartuesit e kushtetutës bënë ndarjen e

¹³. Madison, James, Hamilton, Alexander and Jay, John (1987) *The Federalist Papers*, Penguin, Harmondsworth, p. 259

kompetencave qeverisëse në mes të qeverisë kombëtare dhe qeverive shtetërore. Në të dyja nivelet u bë edhe ndarja e kompetencave në mes të degëve legislative , egzekutive dhe gjyqësore. Qëllimi ishte që të formohej sistemi i parë federal në botë, në të cilin 13 shtetet e atëhershme të pavarura do të bashkoheshin së bashku nën ombrellën e një qeverie të përbashkët kombëtare. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ligjet e Qeverisë Kombëtare që e ka selinë në Uashington, D.C., zbatohen për çdo individ që jeton brenda kufijve kombëtarë, kurse ligjet, në secilin nga pesëdhjetë shtetet, zbatohen vetëm për banorët e atyre shteteve.

Në bazë të federalizmit amerikan, Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara është burim i autoritetit si për qeverinë kombëtare, ashtu edhe për ato të shteteve. Ky dokument nga ana e tij reflekton vullnetin e popullit amerikan që është pushteti suprem në një demokraci. Me një fjalë, sistemi amerikan i ligjvënies mbështetet në një themel ku autoriteti është i ndërthurur. Shtetet dhe kushtetutat e shteteve egzistojnë brenda një sistemi federal të qeverisur nga Kongresi, nga presidenti dhe nga një sistem federal gjykatash në kuadrin e Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.


Hartuesit e kushtetutës u përcaktuan për federalizmin, sepse ata donin të formonin një sistem të kundërt me sistemin unitarë, çfarë e patën në Britani, pra për një sistem më efektiv që do të mund të merret me problemet të cilat dolën gjatë qeverisjes së vendit me Nenet e Konfederatës.

Përkrahësit e kushtetutës mbronin tri argumente kryesore për federalizmin: 1. Nëpërmjet federalizmit pamundësohej tirania. 2. Federalizmi mundësonte një pjesëmarrje më të madhe në jetën politike. 3. Në sistemin federal shtetet mund të përdoren si vende eksperimentesh apo si “laboratore” për testimin e programeve dhe politikave të reja.

Baza historike për federalizmin doli në Konventën Kushtetuese në Filadelfi, ku përkrahësit e një qeverie të fortë kombëtare dolën kundër atyre që preferonin qeveri të forta shtetërore me një qeveri të dobët kombëtare. Ky mospajtim ka vazhduar deri në ratifikimin e kushtetutës, kur u gjetën kompromiset për çështjet e kontestuar, sic ishin: Përfaqësimi në Senat, skllavëria, ndarja e pushteteve, Karta e të Drejtave etj.¹⁴

¹⁴. Zenun Halili, Politika dhe qeverisja e SHBA-ve, Prishtinë, 2006, 44-45

KAPITULLI



KARAKTERISTIKAT THELBËSORE TË FEDERALIZMIT AMERIKAN

Afirmimi i ideve për një organizim federativ të SHBA-ve

Kundërshtimi i federalizmit si opsjon

Ratifikimi i Kushtetutës së vitit 1787 dhe lindja e sistemit presidencial të SHBA-ve

Organizimi i pushtetit – ballansimi dhe kontrolli i ndërsjelltë

1. Afirmimi i ideve për një organizim federativ të SHBA-ve

Ashtu siç kemi përmend në kapitullin paraprak, federata është trajtë e shtetit të përbërë, e cila paraqet një lidhje shumë më të ngushtë ndërmjet shteteve në krahasim me konfederatën. Federata është bashkim i një apo më shumë shteteve, ku krijohet organi qendrorë i cili në kuptimin e drejtë të fjalës është bartës i pushtetit shtetëror apo pushtetit sovran.

Vendimet e organit qendrorë kanë karakter obligues për të gjitha shtetet anëtare në federatë, madje edhe pa pëlqimin e tyre. Autorizimet kapitale i ka organi qendrorë në shkallë federate për tërë territorin e shtetit (federal), ku në radhë të parë hyjnë çështjet me jashtë dmth politiken e jashtme, çështjet ushtarake dhe çështjet kryesore lidhur me monedhën e shtetit (shteteve). Këto tri çështje janë rezervuar për organin qendrorë, ndërsa çështjet e tjera mund të jenë në kompetencë të organeve shtetërore të shteteve anëtare.

Nga kjo rezulton një karakteristikë e rëndësishme e shtetit federativ, se shteti i këtillë në raportet ndërkombëtare paraqitet si një shtet i vetëm (unitar), pra si subjekt i vetëm në të drejtën ndërkombëtare, ndërsa shtetet anëtare të federatës parimisht ngelin të padukshme. Ky autorizim i organit qendrorë apo këto autorizime janë të rregulluara me kushtetutë në mënyrë të përgjithshme, si edhe autorizimet e organeve të shteteve anëtare.

Në hartimin e kushtetutës s'do mend se marrin pjesë edhe shtetet anëtare të federatës nëpërmjet përfaqësuesve të tyre që ndodhen në dhomat federative. Është e njohur se shtetet federative organin ligjdhënës e kanë të përbërë prej dy dhomave. Dhoma e lartë, e cila përbëhet prej përfaqësuesve të shteteve anëtare dhe dhoma e ulët përbëhet prej përfaqësuesve të elitës që i zgjedh populli në tërë territorin e shtetit të përbërë. Dhomat në parim janë të barabarta, që domethënë se kanë status të njëjtë.

Shtetet anëtare në federatë kanë autorizime të gjëra në aspektin e brendshëm të të ushtruarit të pushtetit shtetëror. Këto këtë pushtet e bëjnë të dallohet prej pushtetit të pjesëve

të decentralizuara në shtetin unitar apo të thjeshtë. Shtetet anëtare i kanë organet e veta ligjdhënëse, ekzekutive dhe gjyqësore të pavarura, natyrisht, të zgjedhura apo të krijuara në bazë të kushtetutës së shtetit anëtar, por në pajtueshmëri të plotë me kushtetutën qendrore.

Duhet përmendur se shtetet anëtare në shtetin federal inkuadrohen në bazë të vullnetit të shprehur, duke përcaktuar autorizimet në bazë të aktit kushtetues, kushtetutës qendrore, ndërsa të konfederata kishim një lidhje kontraktuese. Kjo do të thotë se shteti federal është një bashkim i dy apo më shumë shteteve dhe paraqet një shtet të vetëm ndaj botës tjetër, ndërsa konfederata nuk paraqet një shtet të ri, por bashkësi shtetesh anëtare të cilat ruajnë sovranitetin e plotë shtetëror, madje edhe të drejtën e shkëputjes nga konfederata në çdo kohë.

Në teorinë e shtetit dhe të së drejtës parashtrohet çështja e raporteve, e bartjes së sovranitetit shtetërorë në shtetin e përbërë - shtetin federal. Lidhur me këtë çështje ekzistojnë tri mendime: 1. Se shteti federal është bartës i sovranitetit - pra pushtetin shtetëror sovran e ka federata, por jo edhe shtetet anëtare të federatës. Nga kjo del konkluzioni se shteti federal është shtet ndërsa shtetet anëtare nuk janë shtete, por gëzojnë një autonomi të gjerë juridike. 2. Shtetet anëtare janë sovrane, ndërsa bashkimi i shteteve në federatë. Domethënë federata s'është sovran dhe federata nuk paraqet shtetin e përbërë, por përbëhet prej disa shteteve të thjeshta, të lidhura me një lloj të kontratës. Më në fund, 3. Se sovraniteti është i ndarë ndërmjet federatës dhe shteteve anëtare që e krijojnë shtetin e përbërë, ndërsa as federata e as shtetet anëtare nuk do të ishin sovranë si të vetme, por të gjitha si tërësi bëjnë shtetin e përbërë dhe, natyrisht si i këtillë, si tërësi është sovran.

Nga se u tha më lart, mund të vijmë në përfundim se mendimi i parë e mohon faktin se federata është bartëse e sovranitetit shtetëror dhe natyrisht nuk e pranon si shtet të përbërë. Alternativa e dytë mohon ekzistimin e vetë federatës - dhe vërteton ekzistimin e konfederatës. Këtu kemi të bëjmë me një kundërthënie në nocionin e federatës- sepse kemi shtetin sovran dhe shtetin jo sovran. Kujtojmë se mendimi i dytë është më afër zgjidhjes së çështjes e diskutueshme, sepse sovraniteti i takon federatës dhe kjo kryesisht ndaj faktorit të jashtëm paraqet shtetin e vetëm, shtetin e thjeshtë. Ndërkaq, shtetet anëtare nuk janë shtete sovranë, sepse pushteti i tyre është i kufizuar nga pushteti qendror, ndërsa ushtrimi i pushtetit në

shtetet anëtare nuk paraqet kufizim të pushtetit qendror, por ndarje të kompetencave të cilat i përcakton vetë pushteti qendror - sovran.

Dilemat ndërmjet shtetit federal dhe shteteve anëtare zgjidhen mbi bazën terminologjike, duke mos i quajtur shtetet anëtare shtete, por njësi federale apo republika.

Sa i përket ideve federalist në SHBA, shumë çka u tha në kapitullin paraprak. Megjithatë në këtë pjesë do të shtohen edhe disa segmente të cilat ndihmojnë që koncepti federalist i ndërtimit të SHBA-ve të kuptohet sa më qartë edhe nga ata që kanë njohuri të kufizuara nga ky sistem politik i cili kohëve të fundit llogaritet si njëri nga sistemet më funksionale në glob.

Federalizmi amerikan ashtu siç u konstatua në një lloj mënyre identifikohet me një ndarje shumë të qartë të pushteteve. Kjo ishte rjedhojë e dy çështjeve shumë esenciale për mentalitetin amerikan të asaj periudhe kohore. Si e para, duhet të potencohen arsyet praktike, lufta e kolonive kundër guvernërëve të kurorës dhe si e dyta, intenca për kufizimin e pushtetit shtetërorë që të mos bëhej i plotëfuqishëm.

Parimi i vetëqeverisjes lindi si shprehje e kushteve dhe rethanave të veçanta të zhvillimit të SHBA-ve. Këtu duhet të përmendet fakti se ky shtet e kërceu fazën e feudalizmit, gjegjësishtë nuk u ballafaqua me formën feudale të organizimit evropjan. Pra, nuk i përjetoi coptimet që i impononte feudalizmi në kontinentin e vjetër. Nga ana tjetër largësia dhe mos zhvillimi i komunikacionit pamundësonin që me kolonitë të udhëhiqet në mënyrë të efekshme nga shteti amë, pra nga Britania. Kushtet shumë të vrazhda në përditshmëri i detyronin kolonistët në ndërtimin e një vetëqeverisje më ndryshe lokale dhe të shprehive ndryshe të vetë administrimit. Parimi i vetëqeverisjes u shëndrru në një shprehje.

Tentativat dhe kërkesat politike të njësive federale për një autonomi sa më të gjërë ndaj pushtetit federal datojnë nga momentet e miratimit të kushtetutës së vitit 1787. Kjo kushtetutë e afirmoi idenë e shtetit të përbërë nga më shumë njësi që sot e kanë arritë numrin 50 e që i respektojnë bindshëm parimet bazike të federalizmit modern dhe të kushtetutës së vitit 1787. Kushtetuta ndërtoi mekanizma shumë efikasë që nënkuptonin funksionimin e njësive federale por edhe praktikimin dhe zgjerimin permanent të të drejtave individuale dhe kolektive të qytetarëve të SHBA-ve në kuptimin demos të fjalës.

Mënyra e distribuimit të pushtetit ndërmjet organeve të federatës dhe njësive të federatës, pra pjesëve konstituive të federatës është në qendër të interesimit si fakt shoqërorë që nënkupton efikasitetin dhe funksionalitetin e sistemit politik dhe zhvillimin demokratik të shoqërisë amerikane. Principi bazë i funksionimit bazohet në një përpikshmëri të lartë të respektimit të parimit se organet federative duhet ti kryejnë parimisht funksionet e deleguara nga njësitë federale të parapara me kushtetutë. Kompetencat e deleguara realizohen përmes Kongresit, Presidencës dhe gjykatës Supreme. Megjithatë duhet konstatuar edhe ajo se vetëm këta kompetenca të deleguara do ta kishin bërë sistemin politik amerikan shumë të cunguar. Andaj prej sjelljes së kushtetutës e deri më sot vërehet një zgjerim i kompetencave të organeve të federatës, zgjerim i cili nuk i dëmton njësitë federale dhe të drejtat e qytetarëve. Përkundrazi, ky zgjerim i kompetencave të federatës paraqet një garancion të fuqishëm për zhvillimin e sistemit politik në përgjithësi dhe demokracisë amerikane që është shumë respektabile.¹⁵

¹⁵ <https://sq.wikipedia.org/wiki/Federata>

2. Kundërshtimi i federalizmit si opsion

Anti-federalizmi i referohet një lëvizjeje që kundërshtoi krijimin e një qeverie federale më të fortë të SHBA-së dhe që më vonë kundërshtoi ratifikimin e Kushtetutës së vitit 1787. Kushtetuta e mëparshme, e quajtur Nenet e Konfederatës, autoriteteve shtetërore (shteteve të veçanta) iu jepte më shumë autorizime.

Udhëhequr nga Patrick Henri i Virxhinias, Anti-Federalistët u shqetësuan, ndër të tjera, se pozita e fuqishme e presidentit, mund të evoluonte drejt një monarkie. Kjo duhet kuptuar si një lloj fobie ndaj organizimit monarkik të shtetit për të cilën kolonët nuk kishin përceptim pozitiv. Ndonëse Kushtetuta u ratifikua dhe zëvendësoi Artikujt e Konfederatës, ndikimi anti-federalist që shumë domethënës dhe ndihmoi dukshëm miratimin e Ligjit të të Drejtave të Shteteve të Bashkuara.

Gjatë Revolucionit Amerikan dhe menjëherë pas tij, termi federal u aplikua për çdo person që mbështeste bashkimin e kolonive, dhe qeverinë e formuar sipas neneve të Konfederatës. Pas luftës, grupi që ndjeu qeverinë kombëtare sipas neneve ishte tepër i dobët, për te përvetësuar emrin federalist për veten e tyre. Historiani Jackson Turner Main shkruante: "njeriu i" parimeve federale "të miratuara nga" masat federale ", është ai apo ata që rritën peshën dhe autoritetin, ose zgjeruan ndikimin e Kongresit të Konfederatës." ¹⁶

Në fakt federalistët ishin ata që ndërmorën nisma për të ndryshuar artikujt, që përfundimisht çuan në Konventën Kushtetuese, ata e përdorën termin anti-federalist ndaj ndaj të gjithëve që i kundërshtonin idetë e tyre. Nga ana tjetër anti-federalistët hodhën poshtë termin, duke

¹⁶ Main, Jackson Turner (1961). *The Antifederalists: Critics of the Constitution, 1781-1788*. The University of North Carolina Press. [ISBN 0-8078-5544-8](#).

argumentuar se ata ishin federalistët e vërtetë. Në korrespondencën e tyre të ndërsjellë dhe përmes grupeve të tyre lokale, ata u përpoqën ta kapnin këtë term. Për shembull, një anti-federalist i panjohur nënshkroi korrespondencën e tij publike si "një fermer federal", dhe komiteti i Nju Jorkut që kundërshtonte Kushtetutën u quajt "Komiteti Federal Republikan". Megjithatë federalistët mbanin emrin Anti-Federalist përgjithmonë të mbërthyer.¹⁷

Anti-federalistët ishin të përbërë nga elementë të ndryshëm, pra paraqisnin një përbërje heterogjene, duke përfshirë edhe ata që ishin kundër Kushtetutës, sepse mendonin se një qeveri më e fortë e kërcënonte sovranitetin dhe prestigjin e shteteve të veçanta, pastaj ato që pretendonin një fuqi të re "të pushtetit monarkik" të centralizuar, të maskuar, që do të zëvendësonte vetëm despotizmin e hedhur nga Britania e Madhe me qeverinë e propozuar;¹⁸ dhe ata që thjesht kishin frikë se qeveria e re kërcënoi liritë e tyre personale. Disa nga ata që në fakt paraqisnin një lloj opozite ndaj konceptit federativ të ndërtimit të shtetit besonin se qeveria qendrore sipas neneve të Konfederatës ishte e mjaftueshme. Por kishte edhe të tjerë që besonin se qeveria kombëtare sipas neneve ishte shumë e dobët, se qeveria kombëtare sipas Kushtetutës do të ishte shumë e fortë. Një ankesë tjetër e Anti-Federalistëve ishte se Kushtetuta siguroi, një qeveri të centralizuar dhe jo federale (dhe në The Federalist Papers, James Madison pranon se Kushtetuta e re ka karakteristikat e një forme të centralizuar dhe federale të qeverisë) dhe se një formë e vërtetë federale e qeverisjes ishte një ligë e shteteve si nën Nenet e Konfederatës.

¹⁷Main, Jackson Turner (1961). *The Antifederalists: Critics of the Constitution, 1781-1788*. The University of North Carolina Press. [ISBN 0-8078-5544-8](#).

¹⁸One or more of the preceding sentences incorporates text from a publication now in the [public domain](#): Chisholm, Hugh, ed. (1911). "[Anti-Federalists](#)". *Encyclopædia Britannica*. 2 (11th ed.). Cambridge University Press. p. 124.

Gjatë periudhës së debatit mbi ratifikimin e Kushtetutës, në të gjithë vendin u botuan fjalime dhe artikuj të pavarur. Fillimisht, shumë nga artikujt e opozitarëve u shkruan nën pseudonime, si "Brutus" (me gjasë Melancton Smith)¹⁹, "Centinel" (me gjasë Samuel Bryan), dhe "Farmer Federale". Më në fundë disa figura të famshme revolucionare si Patrick Henry dolën publikisht kundër Kushtetutës. Ata argumentuan se qeveria e fortë kombëtare e propozuar nga federalistët ishte një kërcënim për të drejtat e individëve dhe se Presidenti do të bëhej mbret. Ata kundërshtuan sistemin federal të gjykatave të krijuara nga kushtetuta e propozuar. Kjo krijoi një trup fenomenal të shkrimit politik; më të mirët dhe më me ndikim në këto artikuj dhe fjalimet u mbledhën nga historianët në një koleksion të njohur si letra anti-federaliste në aluzion në letrat federale.

Në shumë shtete kundërshtimi ndaj Kushtetutës ishte i fortë (megjithëse Delaware, Gjeorgjia dhe New Jersey ratifikuan shpejt me polemika të vogla), dhe në dy shtete Karolinën e Veriut dhe Rhode Island, ajo pengoi ratifikimin deri në vendosjen e caktuar të qeverisë së re e cila praktikisht e detyroi aderimin e tyre. Individualizmi ishte elementi më i fortë i opozitës; domosdoshmëria, ose të paktën e dëshirueshme, e një fatkeqësie të të drejtave ishte ndjerë pothuajse në formë universale.²⁰ Në Rhode Island, rezistenca ndaj Kushtetutës ishte aq e fortë sa që lufta civile pothuajse shpërtheu më 4 korrik 1788, kur anëtarët anti-federalistë të Vendit të Partituar nga gjykatësi William, përëndimorët marshuan në Providence me mbi 1,000 protestues të armatosur.²¹

¹⁹. Zuckert and Webb. *The Anti-Federalist Writings of the Melancton Smith Circle* pp. 418–419

²⁰. *Columbian Centinel*, July 5, 12, 16, 23, 1788; *Pennsylvania Packet*, July 30, 1788. (reference to West's anti-Constitution [4th of July](#) rally)

²¹. Kenneth F. Warren (2008). *Encyclopedia of U.S. Campaigns, Elections, and Electoral Behavior*. SAGE Publications. p. 176.

Anti-federalistët luajtën me kartën e ndjenjave të keqpërdorimit të pushtetit nga organet federative në shumë raste ku duhet veçuar konventa e ratifikimit në Massachusetts. Konventa e Massachusetts-it ishte shumë më e diskutueshme dhe e kontestuar. Pas një debati të gjatë dhe të lodhshëm, u arrit një kompromis i njohur si "kompromisi i Massachusettsit". Masaçusetsi e ratifikoi Kushtetutën me dispozitat e rekomanduara në instrumentin e ratifikimit me atë që Kushtetuta të ndryshohej me një faturë të të drejtave. Federalistët u deklaruan se një ratifikim i kushtëzuar do të ishte i pavlefshëm.

Katër nga pesë shtetet e ardhshme që e ratifikuan Kushtetutën, përfshirë këtu New Hampshire, Virxhinia dhe Nju Jork, parashtruan kërkesat e tyre për ratifikimin e Kushtetutës.

Si rezultat i gjithë asaj, pasi Kushtetuta u bë funksionale, në vitin 1789, Kongresi propozoi një pako prej dymbëdhjetë amendamentesh në shtetet e veçanta. Dhjetë nga këto ndryshime (amandamente)u ratifikuan menjëherë dhe u bënë të njohura si Bill of Rights. Pra, Anti-Federalistët u treguan të pa suksesshëm në tentimin e tyre për të parandaluar miratimin e Kushtetutës. Megjithatë përpjekjet e tyre nuk ishin krejtësisht të kota. Anti-federalistët u njohën kështu si një grup me ndikim midis etërve themelues të Shteteve të Bashkuara.

Me miratimin e Kushtetutës dhe Projektligjin për të Drejtat, lëvizja anti-federaliste u rraskapit. Disa aktivistë u bashkuan me Partinë Anti-Administrimit që e formuan James Madison dhe Thomas Jefferson rreth viteve 1790-91 për të kundërshtuar politikën e Sekretarit të Thesarit Alexander Hamilton, grup i cili së shpejti u transferu në Partia Demokratike-Republikane.²²

²². One or more of the preceding sentences incorporates text from a publication now in the [public domain](#): Chisholm, Hugh, ed. (1911). "*Anti-Federalists*". *Encyclopædia Britannica*. 2 (11th ed.). Cambridge University Press. p. 124.

3. Ratifikimi i Kushtetutës së vitit 1787 dhe lindja e sistemit presidencial të SHBA-ve

Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara është ligji suprem i Shteteve të Bashkuara. Idhtarët e një interpretimi të gjërë të drejtave të njësive federale, pra shteteve, Thomas Jeffersoni, Jons C. Calhoun, Jons Taylor pak më vonë guvernieri George Wallace nga Alabama, por edhe vetë Gjykata Supreme mes viteve 1929-1937 potenconin se Kushtetuta nënkupton një marrëveshje ndërmjet shteteve federale sovrane të cilët i formuan organet qendrore të pushtetit por me kompetenca të kufizuara. Qeveria kombëtare sipas interpretimit të më lartë përmendur paraqet një „agjent,, të shteteve që e përbëjnë SHBA-në.

Idhtarët e këtij lloj interpretimi të Kushtetutës potenconin se organet federative nuk guxojnë të delegojnë kompetenca dhe të përzihen në kompetencat e rezervuara për shtetet e veçanta, gjegjësisht për njësitë federale. Këta qëndrimet e veta i bazonin në përcaktimet e amandamentit të dhjetë të Kushtetutës të SHBA-ve.

Mendime krejtësisht të tjera afirmonin idhtarët e formimit të një shteti të fuqishëm federal, me kompetenca të gjëra të organeve federale, Alexander Hamiltoni, John Marshall, Abraham Lincoln, Theodore Roosevelt, Franklin D. Roosevelt dhe në periudhën më të gjatë kohore Gjykata Supreme.

Ata e hudhnin poshtë konceptin e Kushtetutës si një marrëveshje ndërshtetërore duke potencuar se Kushtetuta është ligj suprem i shtetit i bazuar në vullnetin e popullit.

Andaj ata insistonin që kompetencat e qeverisë qendrore të interpretohen sa më gjërë.

Në rrugën zhvillimore të SHBA-ve, gjithnjë e më shumë gjente vend koncepti i dytë mbi zhvillimin e shtetit.

Kushtetuta, fillimisht e përbërë nga shtatë artikuj (nene), e përcaktonte kuadrin kombëtar të qeverisjes. Tre artikujt e saj të parë përforcojnë doktrinën e ndarjes së pushteteve, ku qeveria federale ndahet në tri degë: legjislativ, i përbërë nga Kongresi dy-dhomësh; ekzekutivi, i përbërë nga Presidenti; dhe gjyqësori, i përbërë nga Gjykata Supreme dhe gjykatat e tjera federale.

Artikujt Katër, Pesë dhe Gjashtë përmbajnë konceptet hyrëse të federalizmit, duke përshkruar të drejtat dhe përgjegjësitë e qeverive shtetërore dhe të shteteve në marrëdhënie me qeverinë federale. Neni 7 përcakton procedurën e përdorur më pas nga trembëdhjetë shtetet për ta ratifikuar atë.

Procedura e sjelljes së Kushtetutës ishte e lodhshme dhe komplekse si në aspektin teknik ashtu dhe në atë përmbajtësorë. Vetëm të përkujtojmë se në ditën e caktuar, më 14 maj 1787, vetëm delegacionet e Virxhinias dhe Pensilvanisë ishin të pranishëm, dhe kështu mbledhja e hapjes së kuvendit u shty për shkak të mungesës së kuorumit.²³ Një kuorum prej shtatë shtetesh u takua dhe diskutimet filluan më 25 maj. Përfundimisht u përfaqësuan dymbëdhjetë shtete; Janë emëruar 74 delegatë, 55 të pranishëm dhe 39 të nënshkruar.²⁴ Delegatët ishin përgjithësisht të bindur se një qeveri qendrore efektive me një gamë më të gjerë të kompetencave të detyrueshme duhet të zëvendësojë Kongresin më të dobët i themeluar nga Nenet e Konfederatës. Thellësia e delegatëve, e njohurive dhe përvojës së tyre në vetëqeverisje ishte e jashtëzakonshme.

Ashtu siç kemi nënvizuar edhe më lartë prej në fillim erdhën në shprehje dy koncepte, dy plane me qëndrime gati gati diametralisht të kundërta. Njëri plan i favorizonte shtetet e mëdha ndërsa plani tjetër shtetet më të vogla.

- Plani Virginias (i njohur gjithashtu si Plani i Shtetit të Madh ose Plani Randolph) propozoi që departamenti legjislativ i qeverisë kombëtare të përbëhet nga një Kongres dy dhomësh, me të dy dhomat e zgjedhura me ndarje sipas popullsisë. Në përgjithësi duke favorizuar shtetet më të populluara.²⁵

²³. Maier, Pauline., *Ratification: The People Debate the Constitution, 1787–1788*. New York: Simon & Schuster, 2010.p. 27

²⁴. "[America's Founding Fathers-Delegates to the Constitutional Convention](#)". *The U.S. National Archives and Records Administration*. Retrieved April 16, 2016.

²⁵. "[Variant Texts of the Virginia Plan, Presented by Edmund Randolph to the Federal Convention](#)". *The Avalon Project at Yale Law School*. Retrieved April 16, 2016.

- Plani New Jersey propozoi që: departamenti legjislativ të jetë një trup njëdhomësh me një votë për shtet. Ky qëndrim reflektonte besimin se shtetet ishin subjekte të pavarura dhe inkuadrohen lirshëm dhe individualisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.²⁶

Për shkak të divergjencave të shprehura, nevoja e një kompromisi bëhej gjithnjë e më e madhe.

Andaj një „Komitet,, në përbërje një delegat nga secili shtet i përfaqësuar u takuan nga 2 deri më 16 korrik,²⁷ për të hartuar një kompromis mbi çështjen e përfaqësimit në legjislaturën federale. Të gjithë ranë dakord për një formë republikane të qeverisjes bazuar në përfaqësimin e njerëzve në shtete. Për legjislaturën, duhej të vendoseshin dy çështje: se si do të shpërndaheshin votat midis shteteve në Kongres, dhe se si duhet të zgjidhenin përfaqësuesit.

Në raportin e vet, tani më të njohur si kompromisi i Connecticut-it (ose "kompromisi i Madh"), komisioni propozoi përfaqësim proporcional për vendet në Dhomën e Përfaqësuesve në bazë të popullsisë dhe përfaqësim të barabartë për secilin shtet në Senat.²⁸

Kompromisi i Madh i dha fund bllokimit midis "patriotëve" dhe "nacionalistëve", duke çuar në kompromise të tjera të shumta në një frymë akomodimi. Kishte interesa seksionesh për t'u balancuar nga Kompromisi i Tre-Pestë; pajtimi në mandatin presidencial, kompetencat dhe mënyra e përzgjedhjes; dhe juridiksionin e gjyqësorit federal.

²⁶. *"The Debates in the Federal Convention of 1787 reported by James Madison : on June 15". The Avalon Project at Yale Law School. Retrieved April 16, 2016.*

²⁷. *"Committee Assignments Chart and Commentary". Ashland, Ohio: TeachingAmericanHistory.org. Retrieved April 16, 2016.*

²⁸. *"Madison Debates July 16". The Avalon Project at Yale Law School. Retrieved March 31, 2014.*

Më 24 korrik, një „Komitet,, në përbërje - John Rutledge (Karolina e Jugut), Edmund Randolph (Virxhinia), Nathaniel Gorham (Massachusetts), Oliver Ellsworth (Connecticut) dhe James Wilson (Pennsylvania) - u zgjodh për të hartuar një kushtetutë të detajuar reflektuese të Rezolutave të miratuara nga konventa deri në atë moment.²⁹ Konventa u tërhoq nga 26 korriku deri më 6 gusht për të pritur raportin e këtij „Komiteti,,. Në përgjithësi, raporti i komitetit ishte konform rezolutave të miratuara nga Konventa, i plotësuar me disa elemente shtesë. Kështu u prezantu një kushtetutë prej njëzet e tre nene plus preambula.³⁰

Nga data 6 gusht deri më 10 shtator, u diskutua raporti i komitetit në fjalë, klauzolë pas klauzole në mënyrë të detajuar. Detajet u ndoqën dhe u bënë kompromise të mëtejshme. Në fund të këtyre diskutimeve, më 8 shtator, një "Komitet i Stilit dhe Marrëveshjes" në përbërje : Alexander Hamilton (New York), William Samuel Johnson (Connecticut), Rufus King (Massachusetts), James Madison (Virginia) dhe Gouverneur Morris (Pennsylvania) - u emërua për të dizajnuar një projekt-kushtetutë përfundimtare nga njëzet e tre artikujt e miratuar. Drafti përfundimtar, i paraqitur në konventë më 12 shtator, përmbante shtatë artikuj, një parathënie dhe një miratim përfundimtar, nga të cilat Morris ishte autori kryesor. Komisioni gjithashtu paraqiti një letër të propozuar për të shoqëruar kushtetutën kur të dorëzohet në Kongres.³¹ Dokumenti përfundimtarë, i marrë nga Jakobi Shallus, u mor të hënën, më 17 shtator, në sesionin përfundimtar të Konventës. Disa nga delegatët u ndien të zhgënjyer nga rezultati, gjegjësisht nga dokumenti final. Andaj, disa delegatë u larguan para ceremonisë, dhe disa të tjerë refuzuan të nënshkruanin. Nga numri i përgjithshëm propozim Kushtetutën e nënshkruan tridhjetë e nëntë delegatë.³²

²⁹. "[*Committees at the Constitutional Convention*](#)". U.S. Constitution Online. Retrieved April 16, 2016.

³⁰. "[*Madison Debates August 6*](#)". The Avalon Project at Yale Law School. Retrieved April 16, 2016.

³¹. "[*Madison Debates September 12*](#)". The Avalon Project at Yale Law School. Retrieved April 16, 2016.

³² Vile, John R. (2005). [*The Constitutional Convention of 1787: A Comprehensive Encyclopedia of America's Founding \(Volume 1: A-M\)*](#). ABC-CLIO. p. 705. [ISBN 1-85109-669-8](#). Retrieved October 21, 2015.

Ratifikimi i Kushtetutës qe një proces i lodhshëm që nuk u bë aty për aty. Njëmbëdhjetë shtete e ratifikuan Kushtetutën më vitin 1787 - 1788, dhe të gjitha trembëdhjetë e kishin bërë këtë deri në vitin 1790. Kongresi i Konfederatës i çertifikoi njëmbëdhjetë shtete për të filluar qeverinë e re, dhe u bëri thirrje shteteve të mbajnë zgjedhje për të filluar operacionin. Më pas u shpërnda më 4 mars 1789, ditën që filloi seanca e parë e Kongresit të Shteteve të Bashkuara.

Xhorxh Uashingtoni dy muaj më vonë u përrua si President.

Nga kjo që u potencua më lartë lindi sistemi presidencial i SHBA-ve. Ky sistem politik ashtu siç do të konstatojmë në vazhdim është në shumë aspekte i veçantë, sui generis. Qëndrueshmëria e Kushtetutës dhe gjith ajo që paraqet një origjinalitet të këtij sistemi politik padyshim është pjesë përbërëse e zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik, social kulturor të shoqërisë amerikane. Jetë gjatshmëria e Kushtetutës është edhe si rjedhojë e ndarjes shumë të përpiktë të pushteteve dhe të gjitha principeve të tjera që sigurojnë një balansim dhe stabilitet të përgjithshëm.

Kësaj duhet shtuar edhe faktin se koncepti liberal i ndërtimit të SHBA-ve lindi në rrethana sociale e historike të cilat dallonin gati se tërësisht nga vëndet tjera. Pavarësimi i trembëdhjetë kolonive në të njejtën kohë nënkuptonte ndërprerje të plotë nga regjimi në Britani dhe nga ndikimi i aristokracisë dhe feudalizmit në kuptimin evropian të fjalës. Pra, shoqëria amerikane në rrugëtimin e vet liberal dhe në zhvillimin e sistemit politik presidencial ishte e çliruar nga kompleksi i një lufte me forcat feudale dhe fazat e saja zhvillimore nuk nënkuptonin asgjësim të forcave të ndonjë regjimi të kaluar.

Zhvillimi shumë dinamik i SHBA-ve kryonte një hapsirë solide për njeriun si individ. Për deri sa në shtetet Evropiane individ gjithnjë e më shumë ishte i detyruar ti drejtohet shtetit që nga ai të siguron përkrahjen në luftën ndaj jo barazisë dhe shtypjeve sociale, në SHBA njeriu si individ ishte pjesë përbërëse e dinamikës shoqërore.



Shtrirja territoriale e Shteteve të Bashkuara, 1790

4. Organizimi I pushtetit – balancimi dhe kontrolli i ndërsjelltë

Për ta kuptuar më drejtë esencën e sistemit politik të SHBA-ve patjetër të thuhet disa fjalë për karakteristikat bazë të sistemeve politike presidenciale. Sistemet presidenciale

përfaqësues më eminent i të cilëve është sistemi politik i SHBA-ve karakterizohen me sa vijon: E para, sistemi presidencial paraqet formë të qeverisjes ku shihet shumë qartë ndarja e pushtetit ligjvënës nga ai ekzekutiv; E dyta, Presidenti i shtetit zgjidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga qytetarët që gëzojnë të drejtën e votës; E treta, Presidenti e drejton qeverinë dhe ai vet i emëron anëtarët e qeverisë; E katërta, mandati i presidentit të shtetit me kushtetutë është i fiksuar; dhe e pesta, personat e emëruar në ekzekutiv në asnjë mënyrë nuk mundet të jenë pjesë e pushtetit ligjvënës.

Shiqur nga ky aspekt, ashtu siç do të konstatohet në kapitullin në vazhdim presidenti i SHBA-ve disponon me një gamë shumë të gjërë të kompetencave. Organizimi i pushtetit në sistemin politik të SHBA-ve para së gjithashë nënkupton një stabilitet të qëndrueshëm të ligjvënësit dhe ekzekutivit me vetë faktin se dy tipet e pushtetit janë të fiksuara në aspektin e kohëzgjatjes së mandatit. Pavarësia e ekzekutivit nga legjislativi me bekimin e kushtetutës ka eliminuar definitivisht formim të qeverive të koalicionit. Nga ana tjetër në situata të caktuara presidenti i shtetit falë autoritetit dhe legjitimitetit mund të paraqes urën e pajtimit të interesave të kundërta që paraqiten kohë pas kohe si rjedhojë e veprimit të partive politike dhe grupeve të ndryshme të interesit. Kjo që u përmend dhe shumë segmente tjera që do të potencohen në vazhdim të këtij punimi organizimit të pushtetit shtetërorë në sistemin politik të SHBA-ve i japin performansa të veçanta që hasen shumë rrallë në sistemet tjera politike.

Në sistemin politik të Shteteve të Bashkuara të Amerikës vërehet shumë qartë organizimi horizontal dhe vertikal i pushtetit politik por edhe principi i ballansit dhe kontrollit të ndërsjellë.

Me organizimin vertikal të pushtetit nënkuptohen raportet e krijuara ndërmjet instancave më të larta dhe më të ulta të organizimit politik të shoqërisë amerikane. Pra është fjala në rastin konkret për raportet e krijuara ndërmjet Federatës dhe njësisë të vetëqeverisjes lokale apo të niveleve më të ulta. Në këtë kuptim disa autorë që kanë një qasje më kritike flasin për një lloj „federalizmi kooperativ,,.

Në këtë rast gjithësesi duhet thënë disa fjali pse kolonitë britanike që e fituan pavarsinë u përcaktuan për një organizim federativë e jo për ndonjë formë tjetër, gjegjësisht cilat janë karakteristikat thelbësore të federalizmit amerikan.

Këtu patjetër qartë të thuhet se federata amerikane u zhvillua nga kolonitë Britanike të cilat dispononin me një lloj pavarsie ndaj shtetit amë dhe insistonin nga njëra anë ta ruajnë atë pavarësi dhe nga ana tjetër ta avansojnë edhe më shumë atë. Gjithashtu duhet përmendur dëshira dhe tendenca e formimit të një shteti të madh e të fuqishëm i cili normal se duke u nisur nga tendencat liri dashëse të popullit amerikan nënkuptonte dhe një ndarje sa më efikase të kompetencave ndërmjet pushtetit qendrorë dhe instancave më të ulta të pushtetit. Dhe e treta, shteti për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm patjetër të mbante llogari për nivelin e zhvillimit ekonomik të regjioneve të caktuara, kulturave të shumta me të cilat ballafaqohet shoqëria amerikane dhe nënkuptohet pozita gjeografike e njësive të veçanta federale.

Në këtë kuptim ashtu siç u sqarua kalimthi më lartë kanë eksistuar dhe ende eksistojnë dallime në interpretim të parimeve të kushtetutës. Pra, eksistojnë tre qasje në interpretimin e të drejtave që Kushtetuta i ka rezervuar për pushtetin qendrorë viza vi pushteteve të instancave më të ulta. Sipas qasjes së parë Kushtetuta qartë shpreh dualizmin e ballansuar me një ndarje të qartë të kompetencave duke aluduar në sovranitetin e shteteve të veçanta. Ashtu siç u tha më lartë ithëtarët e kësaj qasje mbështetjen e kërkojnë në amandamentin e dhjetë të kushtetutës të sjellur më vitin 1791. Në këtë amandament thuhet se kompetencat që me Kushtetutë nuk iu janë dhënë Shteteve të Bashkuara mbeten të rezervuara për shtetet konstituive të SHBA-ve. Kjo qasje mund të provokonte edhe situata të padëgjueshmërisë, (ius nullificationis) e drejta e mosaplikimit të ligjit federal nëqoftëse po i njëjti është i pa pranueshëm për shtetin në fjalë.

Qasja e dytë shkon në drejtim të asaj se falë amandamenteve, drejtës zakonore dhe interpretimit të Kushtetutës nga Gjykata Supreme, Kushtetuta e SHBA-ve dhe sistemi amerikan ia kan arrit qëllimit që t'iu përshtaten ndryshimeve të doemosdoshme shoqërore. Sipas qasjes së tretë, Kushtetuta është shumë e gjërë dhe largëpamëse dhe ofron mundësi të parashihen dhe të pranohen nevojat e kompetencave të zgjëruara të pushtetit qendrorë.

Përndryshe sa i përket anës formale, struktura e pushtetit në njësitë federative është e ngjajshme me atë të pushtetit qendrorë. Tek të gjitha njësitë federative me përjashtim të Nebraskës ekziston një pushtet ligjvënës dy dhomësh i përbërë nga Dhoma e përfaqësuesve dhe Senati. Në krye të çdo shteti qëndron Guvernatori i zgjedhur që ka kompetenca të ngjajshme me presidentin e SHBA-ve por nënkuptohet në nivel të një njësie federale. Pushteti ekzekutivo-administrativ dhe ai gjyqësorë është pak më ndryshe i organizuar nuk është i unifikuar për të gjitha njësitë që e përbëjnë federatën amerikane. E njëjta gjë vlenë edhe për vetëqeverisjen lokale. Për këto çështje në mënyrë më të detajuar do të flitet në kapitullin e katërt të punimit.

Principi bazë i ndarjes horizontale të pushtetit është principi i ndarjes së pushteteve. Në sistemin politik të SHBA-ve në mënyrë shumë më parimore praktikohet forma e ndarjes së pushteteve sipas teorisë së Monteskeut. Kjo ndarje në të njëjtën kohë nënkupton autonomi të pushteteve por edhe kontroll të ndërsjelltë. Kjo sistemin amerikan të vetëqeverisjes e bën elastik, fleksibil dhe shumë të qëndrueshëm.

Pra, në sistemin presidencial të SHBA-ve, mbartësit më të lartë të pushtetit janë Kongresi dy dhomësh, Presidenti dhe Gjykata Supreme. Kushtetuta qartë mundëson që Kongresi dhe Presidenti i shtetit të mbajnë në duarët e tyre pushtetin politik në shtet. Megjithatë, kur bëhet fjalë për pushtetin ligjvënës dhe atë ekzekutiv nenet e kushtetutës që e rregullojnë këtë materie sikurse duket nuk janë plotësisht të qarta në të dyja rastet. Për shembull, neni një i Kushtetutës, kongresit ia beson tërë pushtetin ligjvënës. Kushtetuta gjithashtu ia beson pushtetin ekzekutiv Presidentit të shtetit por në mënyrë taksative nuk e fikson gamën e kompetencave të tija. Sikurse duket përpiluesit e Kushtetutës në një formë pak sa të pështjellur kanë dashtë që presidenti të ketë një hapsirë më të gjërë manevruese, pra kanë dashtë që presidenti të ketë duartë e lira për çështje të caktuara. Në praktikë, presidentët e SHBA-ve shpesh herë e kanë shfrytëzuar mosdefinimin ose më mirë thënë definimin jo edhe aq precis të kompetencave të tyre, normal në favor të shtetit dhe shoqërisë amerikane.

Në sistemin presidencial të SHBA-ve ashtu siç u tha erdhën në shprehje më të plotë idetë e Lokut dhe Monteskeut mbi ndarjen e pushteteve. Përpiluesit e Kushtetutës këta ide

i përqafuan para së gjithashë sepse idea e ndarjes së pushteteve u përgjigjej, pra u shkonte në favor interesave dha aspiratave të tyre. Pra ideja fillestare ishte se koncentrimi i pushtetit mundëson keqpërdorimin e tij. Andaj eliminimi i koncentritimit të pushtetit dhe parandalimi i keqpërdorimit të tij ishte motiv bazë i përpiluesve të Kushtetutës. Pra, përpiluesit e Kushtetutës ishin të prirur nga dy segmente që do të dëshmohen si shumë efikas në rrugën zhvillimore të sistemit politik të SHBA-ve, ndarja e pushteteve dhe ndërtimi i mekanizmave të kontrollit të ndërsjelltë. Kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se në sistemin presidencial të SHBA-ve raportet ndërmjet ligjvënësit, ekzekutivit dhe gjyqësorit janë aq të harmonizuara dhe se gjërat maten me peshojë të farmaceutëve.

Qysh në vitin 1782, Tomas Xhefersoni tërhoqte vëmendjen nga rreziku që mund të vjen nga dhespotizmi i pushtetit kuvendorë me fjalët se 100 dhespot në organin ligjvënës munden të shtypin po aq sa një monark.

Nga ana tjetër, në një letër dërguar një miku të tij më vitin 1820, Xhon Adamsi numëron tetë mekanizma të fuqishëm kundra koncentritimit të pushtetit në cilin qdo institucion qendrorë të jetë. Ai përmend njësitë federale karshi Federatës, kryetarin ndaj Senatit dhe vice versa, ekzekutivin kundra ligjvënësit, gjyqet kundra ekzekutivit dhe ligjvënësit, Senati karshi presidentit dhe gjitha emërimeve dhe kontratave, populli kundrejt legjislaturës përmes zgjedhjeve dhe mandatit dy vjeçar, legjislatura e shteteve kundrejt Senatit përmes mandatit gjashtë vjeçar (atë kohë senatorët zgjidheshin nga legjislaturat e shteteve të veçanta) dhe elektorët kundrejt popullit dhe zgjedhjes së presidentit.³³

³³. Vuçina Vasoviq, Savremene demokratije, Beograd 2006, faqe 172.

KAPITULLI



FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE TË SISTEMIT NË TEORI DHE

PRAKTIKË

Pozita e kongresit në sistemin politik të SHBA-ve

Organizimi i Kongresit- përbërja e dhomave

Karakteristikat themelore të zgjedhjeve të Kongresit të SHBA-ve

Marrëdhënjet e Kongresit me presidentin e SHBA-ve

Presidenca e SHBA-ve

Mënyra e zgjedhjes së presidentit

Pozita dhe kompetencat e presidentit

Gjykatat federale – mënyra e organizimit dhe funksionimit

1. Pozita e kongresit në sistemin politik të SHBA-ve

Kongresi i Shteteve të Bashkuara është legjislatura bicamerale e qeverisë federale të Shteteve të Bashkuara që përbëhet nga dy dhoma: Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve.

Kongresi takohet në kryeqytetin e Shteteve të Bashkuara në Uashington, D.C. Senatorët, dy nga çdo njësi federale dhe përfaqësuesit zgjidhen përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta. Kongresi numron 535 anëtarë që votojnë: 435 përfaqësues dhe 100 senatorë.

Dhoma e Përfaqësuesve ka edhe gjashtë anëtarë pa të drejtë vote që përfaqësojnë Puerto Rikon, Samoa Amerikane, Guam, Ishujt e Marianës Veriore, Ishujt e Virgjër të Shteteve të Bashkuara dhe Uashington, D.C. . Megjithëse nuk mund të votojnë, këta anëtarë marrin pjesë në komitetet e Kongresit dhe kontribojnë në funksionimin e legjislacionit.

Kongresi ashtu siç kemi konstatuar paraqet një rën nga tre shtyllat kryesore të funksionimit të sistemit politik të SHBA-ve. Edhe pse është shtyllë kyçe e funksionimit të sistemit politik, Kongresi në rrugëtimin e tij ka përjetuar ndryshime të dukshme. Ajo që vërehet në përgjithësi të sistemit politike me ndarje të pushteteve ka ndodh edhe në sistemin politik të SHBA-ve. Gjatë historisë zhvillimore edhe në sistemin politik amerikan ka ndodh procesi i avansimit të ekzekutivit që përfaqësohet nga presidenti i shtetit në dëm të pushtetit legjislativ, gjegjësisht kongresit.

Sipas mendimit të etërve të kushtetutës, Kongresi në ndarjen e përgjithshme të kompetencave duhej të luante një rol kreativ, një rol kahëzues, ndryshe thënë duhej të përcaktonte dhe koordinonte drejtimit e përgjithshme të politikave që nënkupton para se gjithash kontrollimin e pushtetit ekzekutiv. Gjatë kohës, Kompetencat e Kongresit do të reduktohen në një mënyrë shumë të qetë dhe të sofistikuar, edhe pse sipas Kushtetutës, Kongresi shqyrton dhe sjell ligjet

dhe miraton buxhetin, presidenti mban llogari që ligjet të aplikohen me një përpikmëri sa më të lartë ndërsa gjykatat kontrollojnë deri në cilin nivel respektohen ligjet dhe Kushtetuta.

Megjithatë, ulja e nivelit të pushtetit të Kongresit, rolit dhe ndikimit të tij në jetën politiko-shoqërore amerikane është si rrjedhojë e fuqizimit të presidencializmit modern në SHBA i cili imponoi futjen e elementeve të reja në raportet e presidentit me Kongresin. Kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se Kongresi e ka humb peshën e vet në sistemin amerikan të qeverisjes. Përkundrazi Kongresi edhe më tutje mbetet qendër e fuqishme e pushtetit politik. Kongresi edhe më tutje mbetet simbol i shprehjes së vullnetit gjithë popullor përmes sjelljes së ligjeve edhe pse iniciativat dalin nga presidenti i shtetit, gjegjësisht nga shefat e resorëve dhe interest private.

Pushteti më i lartë ligjvënës gjatë shekullit të njëzetë nuk tregoi aftësi si në aspektin politik ashtu dhe në atë organizativ tju përshtatet ndryshimeve të reja shoqërore dhe ti shprehë interesat e forcave të reja sociale. Kjo ishte njëra ndër arsyt kryesore të krizës së Kongresit që edhe sot e kësaj dite nuk ka gjetë një rrugë dalje. Fuqia politike, prestigji shoqërorë dhe autoriteti i Kongresit shënojnë edhe më tutje rënje, ndërsa nga ana tjetër vërehet zgjerimi i dominancës së pushtetit ekzekutiv. Megjithatë, patjetër të thuhet shtruar se gjatë historisë së shtetit amerikan, ka pas shumë raste ku Kongresi ka luajtur rolin e faktorit dominant politik në raport me presidentin dhe gjykatën supreme. Pra, gjatë studimit të sistemit politik të SHBA-ve çdo herë duhet të merret parasysh dinamizmi i tij i shprehur.

Anëtarët e Dhomës së Përfaqësuesve zgjidhen me mandate dy vjeçare. Ata e përfaqësojnë popullin respektivisht qytetarët. Rrethet zgjedhore për në Dhomën e Përfaqësuesve ndahen në shtete sipas popullsisë duke i shfrytëzuar gjithmonë rezultatet e regjistrimit të Shteteve të Bashkuara. Normalisht çdo herë mbahet llogari që secili shtet të ketë së paku një përfaqësues në këtë dhomë. Nga ana tjetër secili shtet, pavarësisht nga popullsia apo madhësia, në Senat përfaqësohet me dy senatorë. Aktualisht, kjo dhomë numëron 100 senatorë që përfaqësojnë 50 shtetet. Secili senator zgjidhet në shtetin e vet për një mandat gjashtë vjeçar, me atë që çdo dy vjet zgjedhet rreth një e treta e Senatit.

Për t'u kualifikuar për zgjedhje, kandidati për Dhomën e përfaqësuesve duhet të jetë i moshës së paku 25, ose 30 vjeçarë për Senat. Si kriter tjetër kandidatët për Dhomën e përfaqësuesve

detyrimishtë duhet të jenë shtetas i Shteteve të Bashkuara për shtatë vite ose nëntë vite për anëtarë Senati. E treta patjetër të jenë banor të shtetit që e përfaqësojnë.

Kongresi u krijua nga Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara dhe u takua për herë të parë në vitin 1789, duke zëvendësuar në funksionin legjislativ Kongresin e Konfederatës. Anëtarët e Kongresit janë zakonisht të lidhur me Partinë Republikane ose me Partinë Demokratike dhe rrallë nga një palë e tretë ose si të pavarur.

Neni një i Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara thekson: "I gjithë pushteti legjislativ që parashikohet këtu (mendohet në këtë nen) ushtrohet nga Kongresi i Shteteve të Bashkuara i cili përbëhet nga Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve,,Dhoma e Përfaqësuesve dhe Senati janë partnerë të barabartë në procesin legjislativ, asnjë ligj nuk mund të miratohet pa pëlqimin e të dy dhomave. Megjithatë, Kushtetuta i jep secilës dhomë disa kompetenca unike.

Anëtarët e Senatit përmenden si senatorë; anëtarët e Dhomës së Përfaqësuesve janë referuar si përfaqësues, kongresmenë ose kongresmene.

Lee H. Hamilton thotë se "misioni historik i Kongresit ka qenë ruajtja e lirisë" dhe këmbëngul se Kongresi ishte një "forcë shtytëse në qeverinë amerikane"³⁴ një "institucion jashtëzakonisht elastik". Kongresi është "zemra dhe shpirti i demokracisë sonë" thoshte ai. Sipas kësaj pikëpamje ³⁵ edhe pse ligjvënësit rrallë arrijnë prestigjin e kryetarëve apo gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, "ligjvënësit mbeten fantazma në imagjinatën historike të Amerikës". ³⁶

³⁴. Davidson, Roger H., and Oleszek, Walter, Congress and Its Members, 6th ed. (1997) p.18

³⁵. editorial staff (May 30, 2008). *"Congress and the Dollar"*. New York Sun. Retrieved 2010-09-11. ...Article One, Section Eight of the Constitution. ... the founders of America delegated to the Congress the power to, among other things, "coin money, regulate the value thereof, and of foreign coin, and fix the standard of weights and measures."

³⁶. John V. Sullivan (July 24, 2007). *"How Our Laws Are Made"*. The Library of Congress. Retrieved 2010-09-11. Unlike some other parliamentary bodies, both the Senate and the House of Representatives have equal legislative functions and powers with certain exceptions. For example, the Constitution provides that only the House of Representatives may originate revenue bills. By tradition, the House also originates appropriation bills. As both bodies have equal legislative powers, the designation of one as the upper House and the other as the lower House is not applicable.

Një analist argumenton se Kongresi nuk është vetëm një institucion reaktiv por ka luajtur një rol aktiv në formësimin e politikës qeveritare dhe është jashtëzakonisht i ndjeshëm ndaj presionit publik.³⁷ Disa akademikë amerikan se „Kongresi reflekton në të gjitha forcat tona dhe në të gjitha dobësitë tona„. Kongresi pasqyron originalitetin(veçoritë) tona rajonale, diversitetin tonë etnik, fetar dhe racor, turmën tonë të profesioneve, dhe nuancat tona të opinionit për çdo gjë nga vlera e luftës mbi vlerat e luftës. Kongresi është organi më përfaqësues i qeverisë ... Kongresi në thelb shprehë shumë pikëpamje tona mbi çështjet e mëdha të politikës publike.

—Smith, Roberts, and Wielen

Kongresi po ndryshon vazhdimisht dhe është vazhdimisht në fluks.³⁸ Në kohët e fundit, jugu dhe perëndimi amerikan kanë fituar vende në Dhomë sipas ndryshimeve demografike të regjistruara nga regjistrimi dhe përfshin më shumë pakica dhe gra, edhe pse të dy grupet janë ende të nënpërfaqësuar.³⁹ Ndërsa balancat e pushtetit midis pjesëve të ndryshme të qeverisë vazhdojnë të ndryshojnë, struktura e brendshme e Kongresit. Është e rëndësishme për të kuptuar së bashku ndërveprimet e saj me të ashtuquajturat institucione ndërmjetëse si partitë politike, shoqatat qytetare, grupet e interesit dhe mediat masive.⁴⁰

³⁷KATE ZERNIKE (September 28, 2006). [*"Senate Passes Detainee Bill Sought by Bush"*](#). *The New York Times*. Retrieved 2010-09-11. *The Senate approved legislation this evening governing the interrogation and trials of terror suspects, establishing far-reaching new rules in the definition of who may be held and how they should be treated. ... The legislation sets up rules for the military commissions ...*

³⁸*References about Congressional war declaring power".*

- Dana D. Nelson (October 11, 2008). [*"The 'unitary executive' question"*](#). *Los Angeles Times*. Retrieved 2009-10-04.
- Steve Holland (May 1, 2009). [*"Obama revelling in U.S. power unseen in decades"*](#). *Reuters UK*. Retrieved 2009-09-28.
- [*"The Law: The President's war Powers"*](#). *Time Magazine*. June 1, 1970. Retrieved 2009-09-28.

³⁹[*"The Law: The President's war Powers"*](#). *Time Magazine*. June 1, 1970. Retrieved 2009-09-28.

⁴⁰[*The President's News Conference of June 29, 1950*](#)

Kongresi i Shteteve të Bashkuara u shërben dy qëllimeve të veçanta : përfaqësimt lokal në qeverinë federale të një rrethi, dhe një përfaqësim të gjerë të shtetit në qeverinë federale nga senatorët.

Shumica e anëtarëve të Kongresit kërkojnë rizgjedhje, dhe gjasat e tyre për të fituar zgjedhjet e mëvonshme tejkalojnë 90 %.⁴¹

Të dhënat historike të Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit mbahen në Qendrën për Arkivat Legjislative, e cila është pjesë e Administratës Kombëtare të Arkivave dhe Dokumenteve.⁴²

Kongresi është drejtpërdrejt përgjegjës për qeverisjen e Qarkut të Kolumbisë, selia e tanishme e qeverisë federale.

Kompetencat e Kongresit të Shteteve të Bashkuara zbatohen konform Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara, të përcaktuara me vendime të Gjykatës Supreme, nga përpjekjet e veta dhe nga faktorë të tjerë si ata historik dhe zakonet. Kompetencat e Kongresit që përcaktohen shprehimisht nga Kushtetuta quhen kompetenca të numëruara; të tjerat janë supozuar të ekzistojnë dhe quhen kompetenca të nënkuptuara.

Neni 1 i Kushtetutës përcakton shumicën e kompetencave të Kongresit, të cilat përfshijnë kompetenca të shumta të shprehura në paragrafin 8. Amendamentet kushtetuese, i dhanë Kongresit kompetenca shtesë. Në bazë të Paragrafit 8 të nenit një të Kushtetutës Kongresi ka kompetencat në vijim:

- 1.Të vendosë dhe të mbledhë taksat,taksat doganore,tatimet dhe taksat e brendëshme,të paguajë borxhet dhe të sigurojë mbrojtjen e vendit dhe mirëqenien e përgjithëshme të Shteteve të Bashkuara.
- 2.Të marrë kredi për llogari të Shteteve të Bashkuara;
- 3.Të caktojë rregulla për tregëtinë me vendet e huaja,midis shteteve të ndryshme dhe me fiset indiane;

⁴¹Michael Kinsley (March 15, 1993). [*"The Case for a Big Power Swap"*](#). Time Magazine. Retrieved 2009-09-28.

⁴²[*"Time Essay: where's Congress?"*](#). Time Magazine. May 22, 1972. Retrieved 2009-09-28.

- 4.Të caktojë një regull unik për dhënien e shtetësisë dhe të nxjerrë ligje unike për çështjen e falimentimit në të gjitha Shtetet e Bashkuara;
- 5.Të emetojë monedha, të caktojë vlerën e tyre dhe të valutës së huaj, dhe të përcaktojë standardet e peshës e të gjatësisë;
- 6.Të marrë masa për ndëshkimin e atyre që fallsifikojnë letrat me vlerë dhe monedhat në Shtetet e Bashkuara;
- 7.Të vendosë zyrat postare dhe rrugët postare;
- 8.Të nxisë përparimin e shkencës dhe të artizanatit,duke u siguruar autorëve dhe shpikësve, për një kohë të kufizuar të drejtën ekskluzive për botimet dhe shpikjet e tyre përkatëse;
- 9.Të ngrit gjykata më të ulta se Gjykata e Lartë;
- 10.Të përcaktojë dhe të dënojë pirateritë dhe krimet tjera në ujrat ndërkombëtare si dhe shkeljet e së drejtës ndërkombëtare;
- 11.Të shpallë luftë,të lëshojë Letrat e reprezaljeve dhe të nxjerrë rregulla për trajtimin e rasteve të kapjes së objekteve të kundërshtarit në tokë apo në det;
- 12.Të ngrit dhe të mbajë ushtri;
- 13.Të ngrit dhe të mbajë Flotë ushtarake detare;
- 14.Të përcaktojë rregullat për drejtimin dhe kontrollin e Forcave ushtarake tokësore dhe detare;
- 15.Të marrë masa për thirjen në veprim të Gardës Kombëtare për të zbatuar ligjet e Unionit,për të shtypur kryengritjet dhe prapsuar pushtuesit;
- 16.Të marrë masa për organizimin, armatimin dhe stërvitjen e Milicisë dhe për veprimin e një pjese të saj që mund të përdoret në shërbim të SHBA-ve duke u njohur Shteteve të drejtën për të emëruar oficerët dhe stërvitur Milicinë sipas rregullave të paracaktuara nga Kongresi;
- 17.Të ushtrojë legjislacionin ekskluziv në një distrikt që me pëlqimin e shteteve të veçanta dhe me pranimin e Kongresit bëhet selia e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara dhe të ushtrojë të njëjtat kompetenca për të gjitha territoret e blera me pëlqimin e legjislativit të Shtetit përkatës ku do të ngrihen fortifikimet,depot,arsenalet,kantieret detare dhe ndërtesat tjera të nevojshme;

18. Të nxjerrë të gjitha ligjet e doemosdoshme dhe të përshtatshme për zbatimin e kompetencave të mësipërme dhe të gjitha kompetencave që i janë dhënë Qeverisë së Shteteve të Bashkuara apo departamenteve ose zyrtarëve të veçantë të saj nëpërmjet kësaj Kushtetute.⁴³



Kongresi ka fuqinë e kuletës dhe mund të tatimojë qytetarët, të shpenzojë para dhe të autorizojë shtypjen e monedhës siç është ky projekt-ligj për \$ 100,000.

Kongresi ka autoritet mbi çështjet financiare dhe buxhetore, përmes fuqisë së numëruar për të hedhur dhe mbledhur taksat, detyrimet, taksat dhe akcizat, për të paguar borxhet dhe për të siguruar mbrojtjen e përbashkët dhe mirëqenien e përgjithshme të Shteteve të Bashkuara.

⁴³. "[*The Law: The President's war Powers*](#)". Time Magazine. June 1, 1970. Retrieved 2010-09-11. Did Richard Nixon "usurp" the constitutional powers of Congress when he unilaterally ordered troops into Cambodia? Swarms of lawyers went to Washington last week to join an increasingly intense debate on the issue (see THE NATION). Their most persuasive arguments raised fundamental questions that go far beyond Cambodia and the Indochina war. Many of the antiwar lawyers conceded that proving the Cambodian "attacks" unconstitutional may be difficult.

Amendamenti i Gjashtëmbëdhjetë, i ratifikuar në vitin 1913, zgjeroi fuqinë e tatimit për të përfshirë taksat mbi të ardhurat.⁴⁴ Kushtetuta gjithashtu i jep Kongresit ekskluzivisht fuqinë për fonde të përshtatshme. Kjo fuqi e kuletës është një nga kontrollet primare të Kongresit në degën ekzekutive.⁴⁵ Fuqitë e tjera që i janë dhënë Kongresit përfshijnë autoritetin për të huazuar para në kredi të Shteteve të Bashkuara, rregullojnë tregtinë me kombet e huaja dhe midis shteteve, dhe paratë e monedhës.⁴⁶ Në përgjithësi, të dy dhomat, Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve kanë autoritet të barabartë legjislativ edhe pse vetëm Dhoma mund të krijojë faturat e të ardhurave dhe, sipas traditës, faturat e ndarjes.⁴⁷

⁴⁴ *"THE PROCEEDINGS OF CONGRESS.; SENATE". The New York Times. June 28, 1862. Retrieved 2010-09-11. Mr. SUMNER spoke in favor of the House bills, contending that they were entirely free from all constitutional objections. They were just as constitutional as the Constitution itself. They only form a part of the means for the suppression of the rebellion. The war powers of Congress are clearly derived from the Constitution, and Congress has a perfect right to exercise war powers. He protested earnestly against the absurd and tyrannical doctrine that all war powers were centred in the President, and against any attempt to foist such an unconstitutional doctrine into the Constitution, as showing the effrontery with which ignorance and conceit excused unconstitutional doctrines. He contended, at length, that confiscation and liberation were among the war powers of Congress, and he had more hope from liberation than from confiscation.*

⁴⁵ *David S. Broder (March 18, 2007). "Congress's Oversight Offensive". washington Post. Retrieved 2010-09-11. A Congress under firm Republican control was somnolent when it came to oversight of the executive branch. No Republican committee chairman wanted to turn over rocks in a Republican administration.*

⁴⁶ *Thomas Ferraro (April 25, 2007). "House committee subpoenas Rice on Iraq". Reuters. Retrieved 2010-09-11. Democratic lawmakers on wednesday subpoenaed Secretary of State Condoleezza Rice to testify about a central and later refuted administration justification for the 2003 U.S.-led invasion of Iraq. But the administration said it might fight the subpoena, citing a legal doctrine that can shield a president and his aides from having to answer questions from Congress. "Those matters are covered by executive privilege," said State Department spokesman Sean McCormack, moving toward a possible legal showdown with the Democratic-led Congress.*

⁴⁷ *James Gerstenzang (July 16, 2008). "Bush claims executive privilege in Valerie Plame wilson case". Los Angeles Times. Retrieved 2009-10-04.*

Ashtu siç u tha, Kushtetuta gjithashtu i jep Kongresit një rol të rëndësishëm në mbrojtjen kombëtare, duke përfshirë fuqinë ekskluzive për shpalljen e luftës, për të ngritur dhe mbajtur forcat e armatosura, dhe për të bërë rregulla për ushtrinë. Disa kritikë akuzojnë se dega ekzekutive ka uzurpuar Detyrën e Kongresit për përcaktimin e kushtetutshmërisë për shpalljen e luftës. Ndërsa presidentët historikisht shiquar fillonin gjatë aktiviteteve luftarake të shpallura kërkonin dhe mernin deklarata formale të luftës nga Kongresi.

Të përmendim Luftën e vitit 1812, Luftën Meksiko-Amerikane, Luftën Spanjolle-Amerikane, Luftën e Parë Botërore dhe Luftën e Dytë Botërore.⁴⁸ Megjithatë lëvizja ushtarake e Presidentit Theodore Roosevelt në Panama më 1903 nuk mori pëlqimin e Kongresit. Ka edhe raste tjera. Presidentët kanë filluar luftën pa deklarata të luftës nga Kongresi në rastet në vijim: Trumani e quajti Luftën Koreane një "veprim policor"⁴⁹ ndërsa Lufta e Vietnamit zgjati më shumë se një dekadë pa një deklaratë lufte. Në vitin 1970, Revista Time vuri në dukje se: "Gjithçka është thënë dhe është llogaritur. Presidentët e SHBA kanë urdhëruar trupat në pozitë apo veprim pa një deklaratë formale të kongresit gjithsej 149 herë "para vitit 1970. Në vitin 1993, një shkrimtar vuri në dukje se "fuqia e luftës e Kongresit është bërë dispozita më flagrante në Kushtetutë" dhe se "erozioni i vërtetë (i autoritetit të Kongresit për të shpallur luftë) filloi pas Luftës së Dytë Botërore".⁵⁰

⁴⁸Elizabeth B. Bazan and Jennifer K. Elsea, legislative attorneys (January 5, 2006). ["Presidential Authority to Conduct Warrantless Electronic Surveillance to Gather Foreign Intelligence Information"](#) (PDF). Congressional Research Service. Retrieved 2009-09-28.

⁴⁹Linda P. Campbell and Glen Elsasser (October 20, 1991). ["Supreme Court Slugfests A Tradition"](#). Chicago Tribune. Retrieved 2010-09-11. The Constitution says judges have lifetime appointments "during good behavior" but, like other federal officers, they can be removed from office for "treason, bribery or other high crimes and misdemeanors.... It's entirely in Congress' determination what the limitations of the impeachment clause may be," said John Killian, senior specialist in American constitutional law for the Congressional Research Service.

⁵⁰ Davidson, Roger H., and Oleszek, Walter, Congress and Its Members, 6th ed. (1997) p.19

Kritikët akuzojnë se Presidenti Xhorxh W. Bush në masë të madhe filloi Luftën në Irak me pak debat në Kongres ose konsultim me Kongresin, pavarësisht votimit në Kongres për autorizimin e forcës ushtarake.

Mosmarrëveshje rreth shkallës së kongresit kundrejt pushtetit presidencial lidhur me luftën ka qenë e pranishme periodikisht në të gjithë historinë e kombit amerikan.⁵¹

Kongresi gjithashtu gëzon të drejtën e inicimit të përgjegjësisë ndaj mbartësve të funksioneve më të larta shtetërore përfshirë këtu edhe presidentin e Sheteve të Bashkuara. Këtë çështje më detajisht do ta shqyrtojmë në pjesën për Presidentin e SHBA-ve.



Pra, një fuqi e Kongresit është mbikëqyrja e degëve të tjera të qeverisë. Në fillim të viteve 1970, Senati hetoi aktivitetet e Presidentit Richard Nixon në lidhje me Watergate që qoi në dorëheqjen e presidentit.

Domethënë një nga funksionet më kryesore jo-legjislative të Kongresit është fuqia për të hetuar dhe për të mbikëqyrur degën ekzekutive. Mbikëqyrja e Kongresit zakonisht delegohet në komisione dhe është lehtësuar nga fuqia e thirrjes së Kongresit. Disa kritikë kanë akuzuar se Kongresi në disa raste ka dështuar për të bërë një punë adekuate për mbikëqyrjen e degëve të tjera të qeverisë. Në rastin e Valerie Plame Wilson nganjëherë të njohur si çështja Plame, disa kritikë, përfshirë Përfaqësuesen Henry A. Waxman, akuzojnë se Kongresi nuk po bënte një punë adekuate të mbikëqyrjes në këtë rast.

⁵¹. J. LESLIE KINCAID (January 17, 1916). *"TO MAKE THE MILITIA A NATIONAL FORCE.; The Power of Congress Under the Constitution "for Organizing, Arming, and Disciplining" the State Troops". The New York Times. Retrieved 2010-09-11. From the many articles which have appeared in the public press the general idea seems to prevail that the militia is essentially a State force. To whatever extent this may be true, at the present time, it has resulted from the failure of Congress adequately to provide for the militia as a national force.*

Kritikët e tjerë e bënin përgjegjës Kongresin, për atë se ishte i dobët në detyrat e tij të mbikëqyrjes lidhur me veprimet presidenciale siç ishin përgjimet.⁵²



Megjithatë mbetet fakti se, Kongresi ka fuqinë për të fajësuar zyrtarët duke përfshirë presidentin. Në vitin 1868, komisioni që ushtronte impiçmentin ndihmoi të fajësonte presidentin Andrew Johnson, i cili pothuajse u dënua; Xhonson qëndroi në detyrë.

⁵². Stephen Herrington (February 25, 2010). "[Red State Anxiety and The Constitution](#)". Huffington Post. Retrieved 2010-09-11. The Tenth states, "The powers not delegated to the United States by the Constitution, nor prohibited by it to the States, are reserved to the States respectively, or to the people." It does not say that laws derived under and consistent with the Articles of the Constitution cannot be enacted over and above the original writing or that State's retain a power to overrule federal law. The authority for doing so is based in implied powers and is among the earliest arguments in Constitutional law. Implied powers are derived from the general welfare and necessary and proper clauses.



Një nga shumë kompetencat e Kongresit është të "përcaktojë dhe të ndëshkojë piratët në det të hapur".

Kompetencat e tjera të Kongresit janë dhënë, ose konfirmohen, me amendamente kushtetuese.

Amendamentet e trembëdhjetë (1865), Katërbëdhjetë (1868) dhe e pesëmbëdhjetë (1870) i dhanë Kongresit autoritetin për të miratuar legjislacionin për të zbatuar të drejtat e të gjithë qytetarëve pavarësisht nga raca, përfshirë të drejtën e votës, procesin e duhur dhe mbrojtjen e barabartë sipas ligjit.⁵³

⁵³. "[Timeline](#)". CBS News. 2010. Retrieved 2010-09-11. *McCulloch v. Maryland* states that the Constitution grants implied powers to Congress, enabling it to carry out explicitly defined powers. The decision vastly augments Congress' power to make laws.

Kompetencat e nënkuptuara dhe klauzola e tregtisë

Kongresi gjithashtu ka nënkuptuar pushtet, të cilat dalin nga neni i duhur dhe Klauzola e duhur e Kushtetutës dhe lejojnë Kongresin "Të bëhen të gjitha ligjet që do të jenë të nevojshme dhe të duhura për kryerjen e ekzekutimit të kompetencave të mësipërme, dhe të gjitha kompetencat tjera të vendosura nga kjo Kushtetutë në qeverinë e Shteteve të Bashkuara, ose në ndonjë departament apo nëpunës të tij. " Interpretime të gjera të kësaj klauzole dhe të Klauzolës së Tregtisë, fuqia e numëruar për të rregulluar tregtinë, në vendime të tilla si *McCulloch v Maryland*, kanë zgjeruar në mënyrë efektive fushëveprimin e autoritetit legjislativ të Kongresit përtej asaj të përshkruar në Paragrafin 8.⁵⁴

⁵⁴RANDY E. BARNETT (April 23, 2009). *"The Case for a Federalism Amendment"*. wall Street Journal. Retrieved 2010-09-11. Finally, Section 5 authorizes judges to keep Congress within its limits by examining laws restricting the rightful exercise of liberty to ensure that they are a necessary and proper means to implement an enumerated power. This section also requires that the Constitution be interpreted according to its original meaning at the time of its enactment. But by expanding the powers of Congress to include regulating all interstate activity, the Amendment greatly relieves the political pressure on courts to adopt a strained reading of Congress's enumerated powers. *Monkeys*

2. Organizimi i Kongresit- përbërja e dhomave

Kongresi përbëhet nga 100 senatorë (2 nga secili shtet) dhe 435 anëtarë të Dhomës së Përfaqësuesve, numër që ishte caktuar nga Akti i riemërimit i vitit 1929. Ky akt bëri të njohurë se thjeshtë duke shtuar më shumë vende në Dhomën e Përfaqësuesve, duhej patur parasysh atë se popullsia rritej, dhe se do ta bënte shumë të vështirë. Sot, çdo kongresmen përfaqëson përafërsisht 570,000 qytetarë. Pra, Kushtetuta madhësinë e Dhomës së Përfaqësuesve në mënyrë të drejtëpërdrejt e ndërlidh me numrin e popullsisë së vendit. Në periudhën 1787-1790 numri i përfaqësuesve ka qenë i fiksuar në mënyrë arbitrare në 65 Përfaqësues. Prej vitit 1790 kur u bë regjistrimi i parë i popullsisë së SHBA-ve e deri më sot numri i anëtarëve të Dhomës rillogaritet çdo dhjetë vjet nga Enti Statistikor, respektivisht pas çdo regjistrimi. Numri i anëtarëve të dhomës ka shënuar një rritje permanente. Përrjashtim nga kjo paraqet periudha e viteve 1830-1840 ku është shënua një rënje e numrit të anëtarëve të Dhomës nga 242 në 232.⁵⁵

Sa u përket rrethëve zgjedhore për Kongres, më mirë thënë për Dhomën e Përfaqësuesve patjetër të përmendet se amerikanët janë të njohur për lëvizjen, mobilitetin e tyre, dhe gjatë viteve, shtetet kanë humbur por dhe kanë fituar popullsi, pra disa kanë humbur e disa kanë shtuar numrin e popullatës. Pas çdo regjistrimi federal, ndodh i ashtu quajtur i „proces i ripërpunimit,,. Në vitet e fundit, shtetet në Perëndim dhe Jugperëndim kanë rritur përfaqësimin e tyre në Dhomën e Përfaqësuesve, ndërsa shtetet në verilindje dhe në Midwest kanë humbur vende. Si rezultat i regjistrimit të vitit 2000, për shembull, Arizona fitoi dy përfaqësues ndërsa New York humbi dy.

Linjat e distriktit të Kongresit zakonisht tërhiqen nga legjislaturat e shtetit (edhe pse gjykatat federale ndonjëherë tërheqin rrethë kur planet origjinale humbin një sfidë kushtetuese).

⁵⁵-Etem Aziri,Sistemet Politike,Tetovë 2012,faqe 180-181

Gjykata Supreme vendosi në vitin 1964 se rrethet duhet të kenë pothuajse të njëjtin numër qytetarësh, sepse votimi i një personi në zgjedhje është i njëjtë me atë të tjetrit. Kjo njihet si parimi "një person, një votë". Megjithatë, partia e shumicës shpesh përpiqet të tërheqë kufijtë për të maksimizuar shanset për kandidatët e saj për të fituar zgjedhjet. Në 1812, guvernatori Elbridge Gerry i Massachusetts miratoi një projekt-ligj që krijon një rreth të tillë aq të çuditshm, sa kritikët e tij e quanin atë "manipulues të zgjedhjeve"- një amfibë politike me një dizajn të dëmshëm. Gerrymandering (manipulues të zgjedhjeve) tani i referohet krijimit të çdo rrethi të çuditshëm të formës i projektuar për të zgjedhur një përfaqësues të një partie të caktuar politike ose një grup të caktuar etnik. Në Shaw kundër Reno (1993), Gjykata ishte jashtëzakonisht kritike e rretheve të çuditshme, në formë të tilla si Qarku i Dymbëdhjetë i Kongresit të Karolinës së Veriut, dhe deklaroi se rrethe të tilla mund të kundërshtoheshin nëse raca ishte faktori kryesor në krijimin e tyre. Një vendim i fundit (2001) mbështeste kufijtë e rindërtuar të rrethit të Karolinës së Veriut.

Sa i takon përbërjes racore dhe gjinore të Kongresit patjetër të thuhet se në pjesën më të madhe të historisë së kombit, anëtarët e Kongresit kanë qenë kryesisht meshkuj të bardhë. Duke filluar me lëvizjen e të drejtave civile të viteve 1960, numri i pakicave etnike dhe femrave në Kongres është rritur. I zgjedhur në vitin 2006, Kongresi i 110-të është më i laramishmi në historinë amerikane, siç tregohet në Tabelën 1.

Table 1: Makeup of the 110th Congress, 2007–2009

	Senate	House
Women	16	74
African Americans	1	42
Hispanic Americans	3	27
Asian Americans	2	4

Përfaqësuesi Keith Ellison i Minesotës u bë muslimani i parë i zgjedhur në Kongres edhe në vitin 2006 ka pasur më pak ndryshime në prejardhjen profesionale të përfaqësuesve dhe senatorëve. Shumë ligjvënës janë avokatë ose biznesmenë, ose ata kanë bërë një karrierë të jetës politike. Pasi zgjidhen, anëtarët e Kongresit përfaqësojnë mbështetësit e tyre në mënyra të ndryshme. Disa e konsiderojnë veten delegatë, të detyruar të votojnë interesat e shumicës të njerëzve në rrethet e tyre. Një kongresist ose senator, i cili merr këtë pozicion bën çdo përpjekje për të qëndruar në kontakt me opinionin publik të votuesve përmes pyetësorëve ose sondazheve dhe udhëtimeve të shpeshta në rrethin nga i cili graviton. Të tjerë, duke marrë në konsideratë pikëpamjet e zgjedhësve të tyre, përdorin gjykimin e tyre më të mirë ose ndërgjegjen e tyre gjatë votimit. Presidenti John Quincy Adams, i cili shërbeu dhjetë mandate në Dhomën e Përfaqësuesve pasi u mund në zgjedhjet presidenciale të vitit 1828, është një shembull klasik i një përfaqësuesi të përgjegjshëm.

Anëtarët e Kongresit kanë avantazh mbi sfiduesit që duan t'i zëvendësojnë ata. Anëtarët aktualë janë në detyrë, pra kandidatë për rizgjedhje të cilët tashmë janë në postin e dëshirueshëm. Si të tillë, ata janë emra të njohur për popullin në distrikt apo shtet. Ata mund të përdorin privilegjin e frankimit (postimit pa pages), ose përdorimi i lirë i postës, për të dërguar gazetën informuese për zgjedhësit e tyre, për pikëpamjet e tyre ose për të kërkuar të dhëna. Tradicionalisht, kandidatët kanë qasje më të lehtë në fondet e fushatës dhe vullnetarët për të gjeneruar vota. Nuk është për t'u habitur që 90 për qind e anëtarëve të tanishëm janë rizgjedhur. Megjithatë, situata nuk është statike.

Ligjvënësit kandidojnë për pozicione të tjera, ndërsa vendet e lira krijohen edhe nga vdekja, dalja në pension apo dorëheqja. Megjithëse kufijtë e afateve, duke kufizuar numrin e kandidimeve të njëpasnjëshme që një individ mund të shërbejë, u refuzuan nga Gjykata Supreme, por ideja vazhdon të gëzojë mbështetjen e votuesve të cilët dëshirojnë të shohin konkurrencë më të hapur.

Dhe për fund të përmendim disa fjalë për Udhëheqjen me Dhomën e Përfaqësuesve Kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve është personi i vetëm drejtues dhe tradicionalisht ka qenë zëdhënësi kryesor për partinë e shumicës në Dhomën e Përfaqësuesve. Pra, me Dhomën udhëheq

„spikeri,, i cili është përfaqësues i partisë me më shumë mandate në Dhomë. Pozita është shumë e fuqishme; Kryetari është i treti në radhë në renditjen presidenciale (pas presidentit dhe nënkryetarit). Fuqia e vërtetë e Kryetarit vjen nga kontrollimi i përzgjedhjes së kryetarëve të komisioneve dhe anëtarët e komisioneve.

Udhëheqësi i shumicës paraqet pozitën zyrtare të partisë së vet dhe përpiqet të mbajë anëtarët e partisë besnik ndaj asaj pozite, që nuk është gjithmonë një detyrë e lehtë. Organizimi i brendshëm i Dhomës zakonisht i përshtatet grupimeve partiake. Brenda Kongresit veprojnë organizatat partiake të cilat i mbrojnë intereset e partive politike. Organizata partiake e demokratëve është Kokusi (Caucus), ndërsa e republikanëve Konferenca (Conference). Në krye të organizatave partiake qëndrojnë udhëheqësit partiak (floor leaders), gjegjësisht lideri i shumicës dhe lideri i pakicës të cilët ndihmohen në punën e tyre nga kamxhikët partiak (whips). Qëllimi i organizatave partiake është të përgatisin anëtarët e partisë së vet për mbledhjet e Dhomës. Edhe një herë të potencojmë se kompetenca bazë të Dhomës së Përfaqësuesve janë: Sjellja e ligjeve dhe aprovimi i buxhetit, ngritja e akuzës për funksionarë të lartë shtetërorë për vepra të caktuara, zgjedhja e Presidentit të SHBA-ve në raste kur asnjëri nga kandidatët nuk e ka siguruar numrin e nevojshëm të votive të elektorëve.

Senati si dhomë e Kongresit prej fillimi me bekimin e Kushtetutës ka pas si obligim të siguron barazinë e njësive federale në federatën amerikane. Jo rastësisht çdo shtet është i përfaqësuar me dy senator. Pra numri i përgjithshëm i senatorëve ashtu siç kemi nënvizuar është 100.

Senati ka një strukturë udhëheqëse disi të ndryshme. Zëvendëspresidenti zyrtarisht është drejtues i Senatit. Nënpresidenti rrallë e shfrytëzon të drejtën e votës, voton vetëm nëqoftëse barazojnë votat në Senat për ndonjë çështje të caktuar. Senati emëron edhe një kryetar të përkohshëm për rastet kur Zëvendës presidenti i shtetit nuk është në gjendje të udhëheq me mbledhjet e Senatit. Ky pozicion, presidenti pro tempore është një nder, dhe tradicionalisht i është dhënë senatorit në partinë e shumicës që ka shërbimin më të gjatë të vazhdueshëm. Sepse presidenti pro tempore (i përkohshëm) është një pozitë kryesisht ceremoniale, puna e vërtetë e kryesimit bëhet nga shumë senatorë. Ashtu si në Dhomën e Përfaqësuesit, Senati ka shumicën dhe udhëheqësit e pakicave. Udhëheqësi i shumicës ushtron ndikim të

konsiderueshëm politik. Një nga udhëheqësit e shumicës më të suksesshem ishte Lyndon Johnson, i cili udhëhoqi Senatin nga 1955 në 1961. Fuqia e tij e bindjes ishte legjend.

Pra, ashtu siç përmendëm Senati është simbol i organizimit federativ të SHBA-ve. Ai garanton barazinë ndërshtetërore. Fillimisht idea ka qenë Senati të jetë një lloj filtri që do të pamundësonte, thënë më mirë do ta kufizonte ndikimin e masave të gjëra në proceset e vendimarrjes politike.⁵⁶

Kompetencat e veçanta të Senatit janë shumë të rëndësishme për funksionimin e sistemit politik të SHBA-ve. E para, Senati ka një rol kundrabalansues dhe filtrues Brenda për Brenda strukturave ligjvënëse. E dyta, Senati ka mjaft kompetenca në sferën e marrëdhënieve ndërkombëtare, strategjisë mbrojtëse dhe energjisë. E treta, Senati ka kompetenca të rëndësishme në rrafshin e kontratave ndërkombëtare. E katërta, Senati ka kompetenca të rëndësishme gjyqësore dhe hetuese. Dhe së fundi senati e zgjedh Zëvendës presidentin nëqoftëse asnjëri nga kandidatët nuk i ka siguruar votat e nevojshme të elektorëve.

Puna më e rëndësishme në të dyja dhomat e Kongresit bëhet nëpër komisione, apo komitete. Komitetet zhvillojnë seanca dëgjimore, dhe kryejnë shumë aktivitete praktike. Anëtarësia e Komitetit pasqyron ndarjen e partisë; partia e shumicës ka shumicën e vendeve në çdo komitet, duke përfshirë edhe kryetarin, i cili zakonisht zgjidhet nga vjetërsia (vitet e shërbimit të njëpasnjëshëm në komitet). Anëtarësia në një komitet kyç mund të jetë gjithashtu politikisht e dobishme për një senator ose përfaqësues.

Në vitin 2007, Senati kishte 16 komisione të përhershme dhe Dhoma kishte 20. Dhoma shtoi Komitetin për Sigurinë e Atdheut në përgjigje të ngjarjeve të 11 shtatorit 2001. Në praktikën amerikane janë të njohura edhe komisionet e përkohëshme.

Komisionet e përkohëshme formohen për të shqyrtuar çështje specifike. Ata duhet të rivendosen me çdo Kongres të ri. Qëllimi i komisioneve të përzgjedhura është që të hetojë çështjet që kanë tërhequr vëmendjen e gjerë, siç është emigracioni i paligjshëm ose përdorimi i drogës. Ata nuk propozojnë legjislacion por nxjerrin një raport në përfundim të hetimit të

⁵⁶ Etem Aziri, Sistemet Politike, tetovë 2012, faqe 183

tyre. Nëse një problem bëhet një shqetësim i vazhdueshëm, Kongresi mund të vendosë për të ndryshuar statusin e komitetit .

Edhe pse nuk janë kategori kushtetuese komisionet e dy dhomave luajnë rol shumë të rëndësishëm në funksionimin e Kongresit. Rolin e komisioneve shumë qartë e vlerësoi Vilsoni me konstatimin e tij të mirënjohur se „Kongresi në plenum është Kongres reklamacioni, ndërsa Kongresi në komisione është Kongresi në punë,,⁵⁷

Sot Dhoma e Përfaqësuesve numron 23 komisione apo këshilla të përhershëm dhe përafërsisht 150 nënkomitete. Senati ka 18 këshilla të përhershëm dhe afro 90 nënkomitete. Është vështirë të paramendohet funksionimi i kongresit pa këshillat apo komisionet e përhershme. Këshillat janë të specializuar për sfera të veçanta të jetës shoqërore amerikane si për shembull, marrëdhëniet me jashtë, financa, mbrojtja, politika tatisore, arsimi, bujqësia etj. Sa u takon këshillave të përkohshëm ashtu siç u potencua më lartë kanë rol ndihmës ose parapregaditorë. Këshillat e përkohshëm ashtu siç tregon edhe vetë emërtimi formohen at hoc për kryerjen e një aktiviteti konkret dhe sa përfundon aktiviteti ata e shuajn veprimin e tyre. Në këshillat e kësaj natyre marin pjesë anëtarë të Dhomës dhe senator dhe ata zakonishtë ndihmojnë në harmonizimin e qëndrimeve në lidhje me përgatitjen e ndonjë propozim ligji. Normal se të gjitha këshillat nuk kanë peshë të njëjtë. Si më të rëndësishëm veçohen Këshilli për buxhet, Këshilli për financa dhe Këshilli mbi procedurat. Këshillat dallojnë edhe sa i përket organizimit. Disa janë më pak e disa janë më shumë të centralizuar.

⁵⁷ W.Wilson, Congressional Government, New York, 1956, faqe 82-83

3. Karakteristikat themelore të zgjedhjeve të Kongresit të SHBA-ve

Në fillim duhet qartë të potencohet se as përfaqësuesit e Dhomës e as senatorët nuk mundet në të njëjtën kohë të jenë mbartës të funksioneve ekzekutive, gjegjësishtë anëtarë të kabinetit. Çdo dy vjet, votuesit zgjedhin të gjithë anëtarët e Dhomës dhe një të tretën e Senatit. Megjithëse Kushtetuta përcakton disa rregulla për mënyrën se si duhet të zgjidhen anëtarët e Kongresit, shtetet janë ato që përcaktojnë detajet e zgjedhjeve të tilla, kush mund të votojë, si do të numërohen votat, dhe pamjen e fletëve të votimit. Ekzistojnë tri lloje zgjedhjesh në Kongres: zgjedhjet parësore, zgjedhjet e përgjithshme dhe zgjedhjet e veçanta.

Lloji i Zgjedhjes

Shpjegim

Zgjedhjet Parësore

Konkursi midis kandidatëve brenda një partie për të zgjedhur kandidatin e partisë

Zgjedhjet e përgjithëshme

Konkurs në mes të të gjithë kandidatëve të partisë dhe kandidatëve të pavarur; fituesi bëhet anëtar i Kongresit

Zgjedhjet e veçanta

Konkurs për të zëvendësuar një anëtar të Kongresit që largohet nga pozita në mes të zgjedhjeve të rregullta

Kur flasim për karakteristikat e zgjedhjeve të Kongresit vlenë të thuhet disa fjali edhe për kandidatët dhe fushatën. Parashtrohet pyetja kush garon për Kongres? Kongresi përbëhet nga një grup vetë-përzgjedhës i njerëzve që zgjedhin të konkurrojnë me iniciativë të tyre. Por në princip organizatat e partisë kërkojnë një person të caktuar për të kandiduar. Pra, për tu bërë një

person i interesuar që i plotëson kushtet formale anëtarë i Dhomës ose i Senatit ai fillimishtë duhet ta kalon fazën e nominimit. Nominimi është proces ku partitë politike gjegjësisht funksionerët lokal të partisë propozojnë kandidat të mundëshëm për plotësimin e vendeve të zbrazura në pozita të caktuara ligjëvënëse, ekzekutive ose në gjyqësorë. Ç'është e vërteta për shkak të rolit faktik të partive politike në sistemin amerikan të qeverisjes, shumica e kandidatëve të interesuar për poste në Kongres nuk mbështeten shumë në partitë politike, por në maqineritë zgjedhore që vetë i ndërtojnë me të cilat udhëheqin organizatat ad hoc të cilët i aktivizojnë vet kandidatët.

Anëtarët e organizatave të tilla zgjedhore punojnë vetëm për kandidatin e para përcaktuar, e ndihmojnë atë edhe finaciarishtë dhe nga i njëjti pas fitores eventuale presin edhe kundrashërbime të caktuara. Charles L. Clapp përmend qëndrimin e një kongresmeni i cili thotë: „Po të varej zgjedhja jonë nga organizata partiake, asnjëri prej nesh nuk do të ishte këtu„.⁵⁸ Kjo që u cek bën të qartë se rol kryesor në zgjedhjet për Kongres luajnë grupet lokale të interesit, rrethanat lokale dhe faktorët lokal.

Procesi i nominimit të kandidatëve bëhet përmes zgjedhjeve primare ose në kuvendet e partive të caktuara. Kandidatët për dhomat e Kongresit duhet ti plotësojnë kushtet e më poshtë shënuara.

⁵⁸ Charles L. Clapp, The Congressman: His work as He Sees It, Washington, D.C., 1963, faqe 351

Dhoma e Përfaqësuesve

Senati

Mosha minimale	25 vjet	30 vjet
Gjatësia minimale e shtetësisë	7 vjet	9 vjet
Shtetas	Po	Po

Sa i përket përbërjes së Kongresit mundet të thuhet se sipas Shërbimit të Kërkimit të Kongresit, anëtari më i ri i Kongresit të 108-të ishte Adam Putnam, një përfaqësues republikan nga Florida, 30 vjeç, dhe anëtari më i vjetër ishte Ralph Hall, një përfaqësues republikan nga Teksasi, 81 vjeç.

Në dekadat e fundit, zgjedhjet e kongresit janë bërë shumë të shtrenjta. Në fillim të viteve 2000, fushata fituese mesatare e Dhomës kushtoi afërsisht \$ 750,000, ndërsa një fushatë fituese e Senatit kushtonte rreth 5 milionë dollarë. Paratë vijnë nga burime të ndryshme si p.sh: donatorë individualë, komitete të veprimit politik (PAC) dhe organizata partiake . Ligji federal rregullon donacionet, duke kufizuar se sa një individ dhe një PAC mund të dhurojë në një cikël zgjedhor. Në vitin 2002, Kongresi miratoi Aktin për Reformën e Fushatës. Për amerikanët votimi është ndër përgjegjësitë më themelore vendore dhe mundësi e rëndësishme qytetare. Pa zgjedhje të lira dhe të hapura, Demokracia amerikane nuk do të ekzistonte. Ruajtja dhe përmirësimi i sistemit të zgjedhjeve kërkon jo vetëm dokumentimin e rezultateve të zgjedhjeve, por edhe të kuptuarit e përbërjes së elektoratit të Amerikës, si në mënyren historike ashtu edhe të tashmen.

Dhe për fund dy tre fjali për punimet e Kongresit. Në bazë të Kushtetutës së SHBA-ve , Kongresi duhet të takohet së paku një herë në vit. Në nenin një Paragrafi 4. (alineja dy e kushtetutës në mënyrë taksative thuhet se,,Kongresi mbledhet të paktën një herë në vit dhe kjo mbledhje

zhvillohet të hënën e parë të dhjetorit) në qoftëse nuk caktohet me ligj një ditë tjetër,,. Pra, është e mundëshme që shefi i shumicës dhe shefi i pakicës në marrëveshje me udhëheqësit e dy dhomave munden ti thërrasin anëtarët e Kongresit edhe para datës së paraparë me nenin gjegjës së Kushtetutës. Nga ana tjetër edhe Presidenti i SHBA-ve ka të drejtë ta fton Kongresin në mbledhje speciale në rastet kur një gjë të tillë e kërkojnë apo e imponojnë rethanat.⁵⁹ Të thuhet edhe ajo se Kongresi pranon sipas disa statistikave më shumë se 25 000 propozim ligje, por numri i projekt ligjeve që e marrin bekimin e Kongresit dhe shëndrrohen në ligje vështirë ta mbrin shifrën 1000.⁶⁰ Në bazë të Kushtetutës, Presidenti i Shteteve të Bashkuara, ose sekretarët shtetërorë nuk kanë të drejtë në kuptimin formal të propozojnë ligje, por në shumicën e rasteve shumica e propozim ligjeve origjinon nga Presidenti, gjegjësisht nga ekzekutivi. Shpesh herë pas propozim ligjeve qëndrojnë organizatat e interesave privatë të cilët me të gjitha mjetet në dispozicion insistojnë ti realizojnë interesat e tyre ekonomike përmes sjelljeve të ligjeve.

Propozim ligjet ashtu siç kemi potencuar, fillimishtë përcjellen te komisioni gjegjës (këshilli gjegjës) dhe ai preliminarisht debaton për propozimin duke u njohtuar fillimisht me përbërjen. Pastaj komisioni vendos a do ta pranon propozim ligjin ose jo. Në qoftë se propozim ligji nuk pranohet nga komisioni gjegjës ai as që meret në konsideratë më tutje. Në qoftë se komisioni e pranon propozim ligjin i njëjti në vazhdim kalon përmes një procedure shumë komplekse para se të dalë para dhomave të Kongresit.

Propozim ligjet e rëndësishme që pranohen nga komisionet më pastaj për të njëjtat organizohet debat i detajuar nëpër nënkomisionet. Në debat ftohen propozuesit, anëtarë të Kongresit,

⁵⁹ Don Radler, How Congress Works, New York, 1976, faqe 17

⁶⁰ Don Radler, vepra e cituar, faqe 43

përfaqësues të departamenteve ekzekutive, anëtarë të grupeve private të interesit, ekspertë dhe përfaqësues të interesit publik.⁶¹

Propozim

Propozim ligji që i kalon procedurat në Dhomën e Përfaqësuesve përcjellet në Senat. Në senat e bën po të njëjtin rrugëtim me atë që veprimet procedurale në Senat janë më të thjeshta krahasuar me Dhomën e Përfaqësuesve. Senati është trup më i ngushtë dhe nuk ekzistojnë rregulla të veçanta procedurale si në Dhomën e Përfaqësuesve.

Propozim ligji duhet të aprovohet në të dyja dhomat me po të njëjtin tekst. Në qoftëse dhomat nuk dakordohen rreth tekstit të propozim ligjit formohet një këshill i përbashkët për tejkalimin e situatës së krijuar.

Për tu shëndrruar një propozim ligj në ligj patjetër duhet të nënshkruhet nga Presidenti i SHBA-ve. Në qoftë se presidenti nuk e firmos atëherë propozimi kthehet në Kongres për ryshqirtim. Në atë rast vetoja e Presidentit ka karakter suspensiv. Në SHBA praktikohet që presidenti ti tregon arsyet e mos firmosjes së propozimit. Kjo ju ndihmon anëtarëve të Kongresit më lehtë të fokusohen në eliminimin e jo qëndrueshmërisë së propozim ligjit, dhe ti bëjnë ndryshimet e nevojshme. Por ekziston mundësia Kongresi me 2/3 e votave ta çbën veton e Presidentit. Në atë rast propozim ligji shndërohet në ligj edhe pa bekimin e Presidentit. Raste të këtilla janë shumë të ralla në praktikën e SHBA-ve.⁶²

⁶¹Don Radler,vepra e cituar,faqe 46

⁶²Më vitin 1947,Trumani e përdori veton kundër ligjit të Taft-Hartleyjevit,por vetoja e tij u mbivotua me 2/3 e votive në të dyja dhomat e Kongresit

4. Marrëdhënjet e Kongresit me presidentin e SHBA-ve

Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk paraqesin një demokraci të plotë parlamentare e as që janë shtet nën ndikimin e plotë të degës së ekzekutivit. Kushtetuta thjesht ju jep autorizim presidentit dhe Kongresit të udhëheqin me shtetin. Marrëdhëniet ndërmjet presidentit dhe Kongresit në shoqërinë bashkëkohore amerikane bazohen në raportet e gërshetuara dhe mvarshmërisë së ndërsjelltë të pushtetit ekzekutiv dhe pushtetit ligjvënës. Edhe pse ashtu siç kemi thënë sistemi amerikan i qeverisjes në mënyrë më të plotë e shpreh ndarjen e pushteteve, funksionimi i tij në përditshmëri, pra në praktikë është i pa mundëshëm pa një veprim të koordinuar të presidentit dhe Kongresit. Kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se ata veprojnë gjithnjë në harmoni. Përkundrazi kundërshtimet shpesh janë shumë të shprehura.

Shkaqet bazike të mosmarrëveshjeve gjenerojnë nga qëndrimet divergjente të shprehjes së qëndrimeve politike dhe sociale. Kundërthëniet zakonisht ashtu siç do të konstatojmë më poshtë tejkalohe pas bisedimeve shpesh herë të mundishme dhe harmonizimit të qëndrimeve. Gjatë leximit dhe interpretimit juridiko-politik të Kushtetutës krijohet përshtypja se presidenti nuk është i kufizuar në kompetencat e tij gjë që nuk mundet të thuhet për Kongresin kompetencat e të cilit janë taksativisht të numëruara. Pra vet analistët amerikanë pohojnë se presidenti shumë kompetenca që nuk janë taksativisht të definuara me Kushtetutë i ka përvetësuar. (është e vërteta që autorët e Kushtetutës së SHBA-ve nuk kanë pas gadishmëri që presidenti të shëndrrohet në person dominant në krijimin e politikave nacionale).

Megjithatë, me zhvillimin e presidencës moderne, ekzekutivi dhe presidenti shëndrrohen në qendër të iniciativave dhe vendimeve që tradicionalisht i kanë takuar Kongresit. Një gjë e tillë erdhi në shprehje në shekullin 20 përmes presidentëve të fuqishëm si Theodore Roosevelt dhe Woodrow Wilson të cilët shpesh u sugjeronin anëtarëve të Kongresit propozim ligje të caktuara dhe angazhoheshin për miratimin e tyre.

Me ardhjen në krye të presidencës të Franklin Roosveltit marrja e iniciativës ligjvënëse në duar të presidentit u bë dukuri e përhershme dhe këta veprime do të vazhdojnë në kontinuitet. Gjatë 100 ditëve të qeverisjes ai propozoi ndërsa kongresi miratoi një numër të madh të masave

ligjore që ndërlidhenin me tejkalimin e krizës. Me administratën e Trumanit më vitin 1945 ndodhën ndryshime të rëndësishme në relacionin president Kongres. Praktika presidenciale e propozimit të ligjeve Kongresit u institucionalizua.

Ndërmarrja e iniciativës ligjore nga presidenca do të zhvillohet gradualishtë më shumë në bazë të drejtës zakonore se sa në baza ligjore. Shumë president e shtuan ndikimin e tyre ndaj Kongresit falë të së drejtës kushtetuese që i mundëson presidentit që kohë pas kohe ta njofton Kongresin për gjendjen e Unionit dhe të nxjer para Kongresit masat që ai mendon se për atë moment janë të nevojshme dhe të doemosdoshme. Porosia e presidentit për gjendjen e unionit me kalimin e kohës u shëndrrua në vegël shumë efikase të ndikimit të presidentit në Kongres. Një moment tjetër që shkon në favor të presidentit është ai se anëtarët e Kongresit edhe pse kanë të drejtën e iniciativave ligjore ata nuk disponojnë me një plan alternativ financiar, andaj programi ligjvënës i presidentit bëhet i një rëndësie të veçantë jo vetëm për funksionimin e Kongresit por edhe për funksionimin e administratës shumë milionshe dhe mbarvatjen e aktiviteteve të përditshme.

Kongresi mund të kalojë ose jo autorizime të mundshme presidenciale, dhe kjo është një shenjë e një marrëdhënieje politikisht pozitive kur Kongresi e bën këtë pa shumë problem. Megjithatë mundet të ndodh (si në vitet e fundit) përbërja e Kongresit të jetë në kundërshtim me qëndrimin politik të presidentit. Kohabitimi nuk është i pa njohur për praktikat amerikane. Klintoni si një demokrat punoi me një Kongres i cili dominohej nga republikanët gjatë dy mandateve të tija si President. Presidenti Bush është dashur të punojë me një Senat që dominohej nga një shumicë republikane, por pasi J. Jeffards ndryshoi nga republikan në të Pavarur, kjo nuk ishte më kështu.

Kongresi gjithashtu duhet të konfirmojë dhe mbështesë kandidatët e presidentit për Gjykatën Supreme dhe zyrën e tij ekzekutive. Presidenti duhet të ketë një marrëdhënie pozitive me Kongresin, sepse Kongresi duhet të aprovon shumë kërkesa të tija dhe emrime. Funksionaliteti i presidencës nuk guxon të jetë peng i shumicës në Kongres. Pra për logjikën amerikane funksionaliteti i shtetit dhe perspektivat e tija janë në radhë të parë.

Asnjë president nuk mund të shmangë angazhimet politike me Kongresin (përveç nëse ai nuk ka iniciativa legislative, një gjë e tillë që ka pak gjasa!). Në kohërat më të reja, ligjet më të rëndësishme janë ratifikuar nga Kongresi pas shumë debateve jashta hapsirave të Dhomës dhe të Senatit. Ligjet e Reformës së Madhe të Lyndon Johnson u miratuan, por vetëm pas shumë "kthesave" dhe debateve formale dhe jo formale.

Niksoni, i cili kishte një marrëdhënie më pak pozitive me Kongresin, i duhej të kërkonte mbështetjen nga Kongresi për SALT 1 dhe për zgjerimin e buxhetit për paratë e shpenzuara për Luftën e Vietnamit.

Që nga 11 shtatori 2001, Presidenti Bush ka pasur një komunikim relativisht të lirë me Kongresin, i cili duhej të mbështeste atë për nevojat që i impononte situata në vend. Nëse qëndrimet e Kongresi binin ndesh me opinionin publik, nëse pengohej presidenti në përpjekjen e tij kundër terrorizmit, atëher publiku do të ndërtonte kritere të veçanta në zgjedhjet e radhës për Kongres. Shumë gjëra kanë ndryshu në raportet e ndërsjellta, Presidencia –Kongres që në nëntor të vitit 2002, një vit pas sulmeve terroriste.

Në thelb Kongresi dhe presidenti kanë atë që është, para së gjithash një politikë e bisedimeve nëse një projekt-ligj i caktuar është potencialisht i diskutueshëm. Presidenti do të bëjë një deklaratë relativisht të paqartë, Anëtarët e zyrës së tij ekzekutive pastaj do të fillojnë të vënë detaje , dhe kontakti me Kongresin mund të bëhet në këtë pikë për të përcaktuar nëse disa çështje do të shkaktojnë probleme apo jo. Kjo është bërë në mënyrë diskrete dhe pa publicitet. Kur propozimi përfundimtar arrin në Kongres për debat dhe ratifikim, ai duhet të kalojë me lehtësi relative sa të jetë e mundur, dhe pika e ndezjes duhet të ishte trajtuar në këtë kohë. Nëse, megjithatë, disa çështje janë vënë në një projekt-ligj dhe Kongresi nuk i mbështet ato, këtu është momenti ku (dhoma e pasme) e mer vendin për të marrë miratimin e projektligjit, por kuptohet në mënyrë që t'i pëlqejë të gjithëve.

Në sistemin politik të ShBA-ve, ekziston një përpjekje për të punuar së bashku, në mënyrë që vendi që pretendon të jetë drita udhëheqëse e demokracisë, të ketë një strukturë politike që i përshtatet këtij qëllimi. Kontestet publike midis presidentit dhe Kongresit janë të rralla. Shembulli më i qartë i kësaj në vitet e fundit ishin problemet e Clintonit me Kongresin mbi atë

që quhet "afëra Lewinsky". Por nga ky skandal Presidenti nuk u pa si një gënjeshtar dhe kurorëshkelës. Bile edhe vetë demokratët në Kongres u treguan gjithashtu të ndarë për çështjen.

Nuk ishte aspak e papritur për shumë njerëz që marrëdhëniet mes Presidentit dhe Kongresit të stabilizohen me njëfarë shpejtësie më të madhe pasi të dy humbën besueshmërinë me publikun amerikan.

Kushtetuta i jep presidentit kompetenca të përcaktuara qartë në marrëdhëniet e tij me Kongresin, dhe ai luan një rol kyç në fillim dhe në përfundim të procesit legjislativ.

Për dy vitet e para të presidencës së tij, Clintoni nuk ka përdorur fuqinë e vetos presidenciale, por të dyja Dhomat kishin një shumicë demokratike. Megjithatë, kur Kongresi u dominua nga republikanët, ai e përdori veton. Në vitin 1996, ai vuri veton ndaj buxhetit të vitit fiskal të republikanëve që kërkonte zvogëlimin e shpenzimeve në sferën e mirëqenies, arsimit dhe programeve mjedisore.

Neni II, paragrafi 3, thotë se presidenti mund ti rekomandojë masa Kongresit. Rekomandon atë që ai e gjykonë të nevojshmen dhe të dobishmen. Kjo fuqi e të rekomanduarit është baza për udhëheqjen presidenciale të Kongresit në të dyja aspektet, atë strategjike dhe taktike, pasi ajo i mundëson presidentit për të zgjedhur midis opsioneve dhe për të vendosur mbi rendin e prioriteteve.

Presidenti mund të shprehë publikisht dhe privatisht pikëpamjet e tij edhe pse Kongresi nuk është i obliguar t'i mbështesë ato. Në këtë kuptim, Kushtetuta ka paraparë të vihet në veprim ajo që presidenti ka të drejtën ta shprehë si pikëpamje, ndërsa të zgjedhurit e popullit kanë të drejtën e refuzimit. Megjithëse Kongresi ka të drejtë të refuzojë rekomandimet presidenciale, ai rrallë e bën këtë. Logjika e sistemit amerikan bën të qartë se esenca është të dy pjesët e qeverisë të veprojnë në interes të qytetarëve e jo të vihen njëri kundër tjetrit.

Sot, të punësuarit në stafin presidencial janë caktuar nga presidenti thjesht që ti zhvillojnë dhe kultivojnë marrëdhënien e Presidentit me Kongresin. Këta njerëz në thelb kanë katër detyra kryesore:

1) Marrin përgjegjësi brenda Shtëpisë së Bardhë për të gjitha pyetjet rreth taktikave dhe strategjisë. Këta persona i tregojnë presidentit kur është më e dobishme të ndërmer ndonjë

veprim , dmth. ata i shprehin aftësitë e tyre si ekspert në kohën e duhur; ata e zgjedhin momentin dhe kohën kur duhet të rekomandojnë diçka; kur do të ishte më mirë të rekomandohej një person për një pozicion të caktuar etj.

2) Ata kultivojnë marrëdhënie me ata që dihet se nuk pajtohen me rekomandimet, në një përpjekje për të marginalizuar kundërshtarët. Ata gjithashtu bëjnë çmos për të bërë atë që aleatët e tyre politikë duan që ata të bëjnë.

3) Bashkërendojnë punën lobuese të të gjithë administratës, duke siguruar që ata të përparojnë në prioritetet e presidentit. Kjo është një detyrë shumë e vështirë sepse administrata është aq e madhe në nivelin ekzekutiv dhe është gjithashtu e vështirë, sepse individët ndjekin shpesh interesat e tyre. Është gjithashtu një detyrë e rëndësishme sepse individët brenda administratës mund të bëjnë dëm të madh për një president, kur ata hyjnë në axhendën e tyre individuale.

4) Kërkojnë të gjejnë pikëpamjet e mbështetësve dhe mbështetësve potencialë në të dyja dhomat e Kongresit, dhe ata i kthejnë këto pikëpamje përsëri presidentit, kështu që problemet me mbështetjen mund të identifikohen përpara se një rekomandim të bëhet publik etj. Në këtë kuptim këta, pra "stafi i marrëdhënieve të Kongresit" përfaqësojnë pikëpamjet e presidentit në Kongres dhe ata gjithashtu i kthejnë atij pikëpamjet dhe qëndrimet e Kongresit.

Presidentët e suksesshëm duhet të zotëronin aftësinë për të bindur. Kushtetuta ndau degët ekzekutive dhe legjislative të qeverisë dhe prandaj presidenti nuk ka pushtet mbi Kongresin. Prandaj ai duhet të negociojë dhe të bëjë marrëveshje. Askush në stafin presidencial nuk është anëtar i legjislaturës - as nuk janë në ndonjë nga emërimet e tij politike brenda burokracisë federale. Kongresi as nuk duhet të përgjigjet fizikisht ndaj ndonjë rekomandimi presidencial pasi ata mund të pretendojnë se nuk ekziston. Prandaj, një president duhet të mbështetet në zhvillimin e marrëdhënieve të mira me Kongresin, taktikat e mira, fuqitë e mira bindëse dhe bisedimet për të fituar mbështetje.

Arsyeja për këtë qëndron në ndarjen e Kushtetuese të legjislativit dhe ekzekutivit. Pra bëhet fjalë për dy organe të ndara, edhe se në mediat e botës presidenti i SHBA-ve referohet si "njeriu më i fuqishëm në botë", kjo nuk është domosdoshmërisht ashtu në një nivel politik në Amerikë. Një president republikan me një Kongres të dominuar nga demokratët, përballat me besnikërinë e tyre partiake dhe e kundërta.

Madje edhe një president demokrat me një Kongres të dominuar nga demokratët nuk mund të garantojë mbështetjen e tyre, përkrahjen e tyre pasi që ata janë në thelb përfaqësues rajonalë që qëndrojnë pas votave të atyre që ata përfaqësojnë.

Në Shtetet e Bashkuara, një guvernator shërben si shef ekzekutiv dhe komandant i përgjithshëm në secilën nga pesëdhjetë shtetet dhe në pesë territoret e përherëshme. Si të tillë, guvernatorët janë përgjegjës për zbatimin e ligjeve të shtetit dhe mbikëqyrjen e funksionimit të degës së ekzekutivit të shtetit. Si udhëheqës shtetërorë, guvernatorët përparojnë dhe ndjekin politika dhe programe të reja dhe të rishikuara duke përdorur mjete të ndryshme, mes tyre urdhra ekzekutivë, buxhetet ekzekutive, propozimet legislative dhe veton. Guvernatorët kryejnë përgjegjësitë dhe objektivat e tyre të drejtimit dhe udhëheqjes me mbështetjen dhe ndihmën e drejtuesve të departamenteve dhe agjencive, shumë prej të cilëve janë të autorizuar. Shumica e guvernatorëve kanë autoritetin të emërojnë edhe gjyqtarë të gjykatës shtetëror, në shumicën e rasteve nga një listë e emrave të paraqitur nga një komision i emëruar.⁸⁶

Të gjitha vendet përveç pesë shteteve (Arizona, Maine, New Hampshire, Oregon dhe Wyoming) kanë një guvernator zëvendës (togër). Zëvendës guvernatori arrin te zyra e guvernatorit (kompetencat dhe detyrat, por jo zyra, në Massachusetts dhe në Virxhinia Perëndimore), nëse lirohet nga largimi nga detyra, vdekja ose dorëheqja e guvernatorit të mëparshëm.

Zëvendës guvernatorët shërbejnë gjithashtu edhe si guvernatorë shtetërorë jozyrtarë në rast se guvernatorët në detyrë nuk janë në gjendje të përmbushin detyrat e tyre dhe shpesh shërbejnë si drejtues të dhomave të larta të legjislativave të shtetit. Por në raste të tilla ata nuk mund të marrin pjesë në debate politike dhe nuk kanë asnjë votë kur këto dhoma nuk janë të barabarta.

Guvernatori kryeson degën ekzekutive të qeverisë në çdo shtet ose territor dhe, varësisht nga juridiksioni individual, mund të ketë kontroll të konsiderueshëm mbi buxhetimin e qeverisë, fuqinë e emërimit të shumë zyrtarëve (duke përfshirë shumë gjyqtarë) dhe një rol të konsiderueshëm në legjislacion. Guvernatori mund të ketë gjithashtu role të tjera, të tilla si ajo

⁸⁶."Governors' Powers and Authority". *Nga.org*. Washington, D.C.: [National Governors Association](#). 2011.

e kryekomandantit të Gardës Kombëtare të shtetit (kur nuk federalizohet) dhe i forcës mbrojtëse respektive të shtetit (e cila nuk është subjekt i federalizimit). Në shumë shtete dhe territore guvernatori ka gjithashtu fuqi të pjesshme ose absolute për të zhvendosur ose falur një dënim penal. Të gjithë qeveritarët e SH.B.A.-së u shërbejnë kushteve katërvjeçare përveç atyre në New Hampshire dhe Vermont, të cilët i shërbejnë mandateve dyvjeçare.

Në të gjitha shtetet, guvernatori zgjidhet drejtpërdrejtë dhe në shumicën e rasteve ka fuqi praktike të konsiderueshme, ndonëse kjo mund të moderohet nga legjislativi shtetëror dhe në disa raste nga zyrtarë të tjerë ekzekutivë të zgjedhur.

Në Alabama, Indiana, Kentaki dhe Tennessee, vetoja e guvernatorit mund të anashkalohet me një shumicë të thjeshtë votash, duke e bërë atë praktikisht të padobishme. Ndërsa në Arkansas, një veto e guvernatorit mund të anashkalohet vetëm me shumicë absolute. Guvernatori i Karolinës së Veriut nuk kishte fuqi të vetos deri në një referendum të vitit 1996. Në 47 nga 50 shtetet, sa herë që ka një boshllëk të njërit prej vendeve të Senatit të Shtetit të SHBA, guvernatori i atij shteti e ka fuqinë të caktojë dikë për të mbushur vendin e lirë derisa të mbahet një zgjedhje e veçantë; ndërsa guvernatorët e Oregonit, Alaskes dhe Wisconsin nuk e kanë këtë fuqi.⁸⁷

Guvernatorët e shteteve gjithashtu mund të kryejnë rolet ceremoniale, siç janë përshëndetjet e personaliteteve, dhënien e dekoratave shtetërore, dhënien e shpalljeve simbolike ose pjesëmarrjen në panairin shtetëror. Guvernatori mund të ketë gjithashtu edhe një vendbanim zyrtar.

Në një renditje të fuqisë së guvernatorit në të 50 shtetet, teoricieni politik i Universitetit të Karolinës së Veriut Thad Beyle bën dallimin mes "fuqive personale" të guvernatorëve, të cilët janë faktorë që ndryshojnë nga personi në person, sezoni në sezon - dhe "kompetenca institucionale" që janë vendosur me ligj.

⁸⁷. [*"CRS Report for Congress" \(PDF\)*](#). Senate.gov. January 22, 2003. Retrieved 4 October 2017.

Nëse një guvernator ka kontrolle të forta buxhetore, autoritetin e emërimit dhe kompetencat e vetos, atëherë këto janë shembuj të kompetencave institucionale.⁸⁸

Pra të rrumbullakojmë. Si menaxherë shtetërorë, guvernatorët janë përgjegjës për zbatimin e ligjeve shtetërore dhe mbikëqyrjen e funksionimit të degës së ekzekutivit shtetëror. Si udhëheqës shtetërorë, guvernatorët përparojnë dhe ndjekin politika dhe programe të reja dhe të rishikuara duke përdorur mjete të ndryshme, mes tyre urdhrat ekzekutivë, buxhetet ekzekutive, propozimet legjislative dhe veton. Guvernatorët kryejnë përgjegjësitë dhe objektivat e tyre të drejtimit dhe udhëheqjes me mbështetjen dhe ndihmën e drejtuesve të departamenteve dhe agjencive. Shumica e guvernatorëve kanë autoritetin të emërojnë edhe gjyqtarë të gjykatës shtetërore, në shumicën e rasteve nga një listë e emrave të paraqitur nga një komision emërimesh.

Edhe pse guvernatorët kanë shumë rol dhe përgjegjësi të përbashkëta, fusha e pushtetit guvernatorial ndryshon nga shteti në shtet në përputhje me kushtetutat, legjislacionin dhe traditën shtetërore dhe guvernatorët shpesh renditen nga historianët politikë dhe vëzhgues të tjerë të politikës shtetërore sipas numrit dhe shtrirjes së kompetencave të tyre.

Kandidatët që garojnë për pozitën e guvernatorit duhet të përmbushin disa kushte formale. Mosha 35 vjeçare, vendqëndrimi në po të njëjtin shtet 7 vjet etj. Ashtu siç potencuam zgjidhen me mandat katër vjeçar. Përjashtim bëjnë New Hampshire dhe Vermonti.

Guvernatorët luajnë dy role të rëndësishme në lidhje me legjislaturat e shtetit. Së pari, ata mund të jenë të autorizuar të thërrasin sesione të posaçme legjislative, me kusht që në shumicën e rasteve qëllimi dhe rendi i ditës për seancat të vendosen paraprakisht. Së dyti, guvernatorët koordinojnë dhe punojnë me legjislaturat e shtetit në:

⁸⁸Swanson, Stevenson (September 2, 2001). *"Governors' powers ranked"*. [Chicago Tribune](#). Retrieved November 4, 2014.

miratimi i buxheteve të shtetit dhe ndarjeve buxhetore;
miratimi i legjislacionit shtetëror;
konfirmimin e emërimeve ekzekutive dhe gjyqësore; dhe
mbikëqyrjen legislative të funksioneve të degës ekzekutive.

Sa i takon miratimit të buxheteve të Shtetit dhe ndarjeve buxhetore, guvernatorët zhvillojnë dhe dorëzojnë buxhetet vjetore ose dyvjeçare për rishikimin dhe miratimin nga legjislativi.

Guvernatorët shpesh përdorin gjendjen e mesazheve të Shtetit për të përshkruar platformat e tyre legislative dhe shumë guvernatorë përgatisin propozime legislative specifike për t'u futur në emër të tyre. Përveç kësaj, departamentet dhe agjencitë shtetërore mund të ndjekin iniciativa legislative me miratimin e qeverisë.

Zyrtarët e degës ekzekutive shpesh thirren për të dëshmuar për propozimet legislative, dhe guvernatorët dhe udhëheqësit e degëve të tjera të ekzekutivit do të kërkojnë të mobilizojnë opinionin publik dhe grupet e interesit në favor ose kundërshtim ndaj propozimeve specifike legislative. Guvernatorët mund të përdorin rolin e tyre si liderë partiakë për të inkurajuar mbështetjen për nismat legislative dhe së bashku me drejtuesit e departamenteve dhe stafit mund të kërkojnë të ndikojnë në ecurinë e legjislacionit nëpërmjet takimeve të rregullta me ligjvënësit dhe zyrtarët ligjvënës.

Guvernatorët bashkëveprojnë me legjislaturën e tyre për të ndihmuar që prioritetet, qëllimet dhe arritjet e tyre të paraqiten në mënyrë të saktë dhe të pranohen pozitivisht gjatë seancave mbikëqyrëse dhe aktiviteteve të tjera legislative që adresojnë dhe vlerësojnë zbatimin e degës ekzekutive të programeve dhe shërbimeve të mandatuara me ligj.

Shumica e guvernatorëve kanë autoritet të gjerë për të emëruar zyrtarë, për të shërbyer në pozitat e degëve të ekzekutivit shtetëror, shumë prej të cilëve do të përfshihen në komitetin këshillues të guvernatorit, i njohur si "kabineti". Guvernatorët mund të fuqizohen gjithashtu për të bërë emërime për gjyqet e shtetit. Shpesh, këto emërime u nënshtrohen konfirmimit nga një ose dy dhoma të legjislaturës së shtetit.

Ndërsa shpesh herë, procesi i konfirmimit në lidhje me emërimet e degës ekzekutive mund të përdoret nga legjislatura për të zgjeruar ndikimin e tyre mbi guvernatorët dhe politikën e tyre.

Prandaj, shumë guvernatorë konsultohen me ligjvënësit kryesorë para se të bëjnë nominime formale.

Bordet dhe Komisionet luajn rol shumë të rëndësishëm në funksionimin e ekzekutivit të shteteve të veçanta. Roli i tyre ndryshonë në mënyrë të konsiderueshme nga shteti në shtet. Në disa shtete, bordet e emëruara kanë përgjegjësinë kryesore për programet dhe agjensitë individuale dhe janë përgjegjës për përzgjedhjen e drejtuesve të departamenteve dhe agjensive. Kjo vlenë veçanërisht për fushën e arsimit, por bordet ende mbajnë përgjegjësi për një gamë të gjerë programesh të tjera në fusha të tilla si puna, transporti dhe shëndeti dhe shërbimet njerëzore. Në shumë shtete anëtarët e këtyre bordeve emërohen ose caktohen nga guvernatori. Dhe në shumë prej këtyre rasteve, anëtarët e bordit i nënshtrohen konfirmimit nga një ose dy dhoma të legjislaturës.

Bordet mund të kenë rol rregullator ose këshillues. Në shumicën e shteteve, bordet mbikëqyrin licencimin dhe rregullimin e shumë profesioneve dhe zonave të biznesit. Në disa shtete ata këshillojnë guvernatorin në fushat me rëndësi të tilla si mjedisi dhe zhvillimi ekonomik.

Konsolidimi i bordeve dhe komisioneve është një fokus i përbashkët i efikasitetit të qeverisë dhe iniciativave të riorganizimit të qeverisë, ato ende luajnë një rol të rëndësishëm në qeverinë e shtetit, duke ofruar mundësi për të adresuar shqetësimet e interesave të veçanta dhe për të shpërblyer mbështetësit politikë.

Vlenë të thuhet edhe ajo se një numër i madh shtetesh sigurojnë përzgjedhjen e pavarur të pozicioneve të caktuara ekzekutive. Më të rëndësishmet në mesin e këtyre pozicioneve janë zëvendës guvernatori, sekretari i shtetit, avokati i përgjithshëm dhe arkëtari. Pozita e zëvendës guvernatorit ekziston në shumicën dërrmuese të shteteve.

Pozicionet e sekretarit të shtetit, prokurorit të përgjithshëm dhe arkëtarit janë të gjitha subjekt i zgjedhjeve nga populli.

Guvernatorët në përgjithësi kanë autoritet të kufizuar në emërimin e kontrolluesve shtetërorë dhe drejtuesve të departamenteve para dhe pas revizionit. Fuqitë e emërimit të guvernatorëve janë gjithashtu të kufizuara në lidhje me krerët e arsimit shtetëror dhe agjensitë e arsimit të

lartë. Kreu i departamentit të arsimit zgjidhet në mënyrë të pavarur në të gjithë vendin në 14 shtete dhe emërohet - pavarësisht nga miratimi i qeverisë - nga një bord apo kreu i agjensive në 20 shtete dhe dy territore. Në shumicën e shteteve dhe territoreve, kreu i arsimit të lartë emërohet nga një bord i pavarur i miratuar nga qeveria.

Një numër shtetesh parashikojnë gjithashtu zgjedhjen në mbarë vendin të një apo më shumë drejtuesve të departamenteve të tjera, në mesin e tyre rregullatorët e shërbimeve publike dhe drejtuesit e departamenteve të bujqësisë, të punës dhe të burimeve natyrore.

Kabinetet shtetërore, të cilat shërbejnë si këshilla këshilldhënëse për guvernatorët e vendit, në përgjithësi përbëhen nga zyrtarë të emëruar nga guvernatori për të udhëhequr departamentet shtetërore dhe agjensitë, dhe në disa raste staf të nivelit të lartë në zyrën e drejtpërdrejtë të guvernatorit. Në shumicën e shteteve, kabineti përmbush dy funksione: këshillon guvernatorin për zhvillimin e politikës, dhe shërben si një mjet për guvernatorin ose stafin e lartë për të përcjellë prioritetet për të emëruarit në pushtet dhe për të adresuar çështjet apo shqetësimet ndërgjyqësore. Në një numër shtetesh, guvernatorët kanë krijuar nën-kabinete për të bashkuar agjensitë për të trajtuar çështje të tilla si nevojat e fëmijëve.

Guvernatorët përdorin urdhra ekzekutivë, (disa prej të cilave janë subjekt i rishikimit legjislativ në disa shtete) për një sërë qëllimesh. Ata shkaktojnë kompetenca emergjente gjatë fatkeqësive natyrore, krizave të energjisë dhe situatave të tjera që kërkojnë vëmendje të menjëhershme. Si shef ekzekutiv, guvernatorët janë përgjegjës për sigurimin e shtetit të tyre të përgatitur në mënyrë adekuate për emergjencat dhe fatkeqësitë e të gjitha llojeve dhe madhësive. Shumica e emergjencave dhe fatkeqësive trajtohen në nivel lokal dhe disa kërkojnë një deklaratë presidenciale të fatkeqësive ose tërheqin vëmendjen e medias në mbarë botën. Megjithatë guvernatorët duhet të jenë shumë të përgatitur për ngjarjet e përditëshme, tornadot, përmytjet, ndërprerjet e energjisë, zjarret industriale dhe derdhjet e materialeve të rrezikshme . Gjatë një emergjence, guvernatori gjithashtu luan rol kyç në komunikimin me publikun , duke ofruar këshilla dhe udhëzime dhe mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike.

Ligjet shtetërore për menaxhimin e emergjencave zakonisht përcaktojnë se si guvernatori mund të deklarojë dhe të përfundojë gjendjen e jashtëzakonshme. Në disa raste, përgjigja e

nevojshme për një fatkeqësi është përtej kapacitetit të qeverive shtetërore dhe lokale. Një shtet mund të kërkojë nga Presidenti që të deklarojë një katastrofë të madhe. Deklarimi i një katastrofe të madhe shkakton një shumëllojshmëri të programeve federale në varësi të fushës së fatkeqësisë dhe llojit të humbjeve të përjetuara.⁸⁹

3. Organizimi i gjyqësorit

Në Shtetet e Bashkuara, një gjykatë shtetërore ka juridiksion mbi mosmarrëveshjet me ndonjë lidhje me një shtet të SHBA, në krahasim me qeverinë federale. Gjykatat shtetërore merren me shumicën dërrmuese të rasteve civile dhe penale në Shtetet e Bashkuara.

Në përgjithësi, gjykatat shtetërore janë gjykata të zakonshme, dhe zbatojnë ligjet dhe procedurat e tyre përkatëse shtetërore për të vendosur rastet. Ato organizohen në bazë dhe zbatojnë ligjin në përputhje me kushtetutën e shtetit, statutet e shtetit dhe vendimet e detyrueshme të gjykatave në hierarkinë e tyre shtetërore. Aty ku është e aplikueshme, ata gjithashtu zbatojnë ligjet federale. Në përgjithësi, një zyrtar i vetëm gjyqësor, zakonisht i quajtur gjyqtar, ushtron juridiksionin origjinal duke kryesuar veprimet penale ose civile të kontestuara, të cilat arrijnë kulmin në gjykime. Vendimet e gjykatave më të ulëta mund të rishikohen nga një kolegji i një gjykate shtetërore të apelit (e njohur si "gjykatë e apelit" në tri shtete).

⁸⁹ <https://www.nga.org/cms/management/powers-and-authority>

Në përgjithësi, ekziston një gjykatë supreme e shtetit që mbikëqyr sistemin gjyqësor. Në çështjet që përfshijnë çështjet e ligjit federal, vendimi përfundimtar i një gjykate supreme të shtetit (përfshirë refuzimet për të dëgjuar ankesat përfundimtare) mund të apelohej në Gjykatën Supreme të Shteteve të Bashkuara (e cila gjithashtu ka diskrecionin për të mos pranuar t'i dëgjojë).

Territori jashtë çdo shteti në Shtetet e Bashkuara, siç është Distrikti i Kolumbisë ose Samoa Amerikane, shpesh ka një sistem gjyqësor të vendosur sipas ligjit federal apo territorial që zëvendëson një sistem gjyqësor shtetëror dhe dallon nga sistemi i zakonshëm federal gjyqësor. Gjykatat e shtetit zakonisht gjenden në një gjykatë në selinë e qarkut. Edhe kur gjykatat shtetërore përfshijnë më shumë se një qark në një distrikt gjyqësor, nuk është e pazakontë që gjykata e shtetit të mbajë sesione të rregullta në çdo vend qarku në juridiksionin e tij dhe të funksionojë nga pikëpamja e palëve kontestuese sikur të ishte një gjykatë me bazë qarku.

Nëse njëri prej palëve ndërgjyqësore është i pakënaqur me vendimin e gjykatës më të ulët, çështja mund të kalon në apel. Zakonisht, një gjykatë e ndërmjetme e apelit, nëse ka një të tillë në atë shtet, shpesh thirret në gjykatën e apelit të shtetit, do të shqyrtojë vendimin e gjykatës. Nëse ende është e pakënaqur, pala mund të apelojë në gjykatën më të lartë të apelit në shtet, e cila zakonisht quhet gjykata supreme e shtetit dhe zakonisht gjendet në ose afër kryeqytetit të shtetit. Gjykatat e apelit në Shtetet e Bashkuara, ndryshe nga homologët e tyre të së drejtës civile, në përgjithësi nuk janë të lejuar të korrigjojnë gabimet në lidhje me faktet e rastit në ankesë, vetëm gabimet e ligjit ose gjetjet e fakteve pa mbështetje në procesverbalin e gjykatës gjyqësore.

Shumë shtete kanë gjykata me juridiksion të kufizuar (juridiksioni inferior). Ankesat nga gjykatat me juridiksion të kufizuar shpesh dërgohen në gjykata shtetërore të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe jo në një gjykatë apeli.

Qytetet më të mëdha shpesh kanë gjykata të qytetit (të njohur edhe si gjykata komunale) të cilat dëgjojnë shkeljet e trafikut dhe shkeljet e dekreteve të qytetit. Këto gjykata gjithashtu kanë juridiksione më të gjëra si gjykata të juridiksionit inferior dhe mund të përballojnë pretendimet e vogla civile dhe kundërvajtjet. Ekzistojnë, ose më mirë thënë veprojnë edhe gjykata të tjera me juridiksion të kufizuar.

Të gjitha këto gjykata dallohen nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm (të njohur edhe si "juridiksion i lartë"), të cilat janë lloji i paragjyimit të gjykatës që mund të dëgjojë çdo rast që nuk kërkohet të dëgjohej së pari në një gjykatë me juridiksion të kufizuar. Në mënyrë tipike, veprat penale trajtohen në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, ndërsa kundërvajtjet dhe veprat e tjera më të vogla trajtohen në gjykatat e juridiksionit inferior. Ndryshe nga shumica e gjykatave evropiane (në të drejtën e zakonshme dhe në ato të së drejtës civile), gjykatat amerikane të shtetit zakonisht nuk kanë një gjykatë të veçantë që merret me krime të rënda; juridiksioni qëndron në gjykatën që trajton të gjitha rastet e tjera të krimit në një qark të caktuar. Por shumë gjykata shtetërore që merren me çështje penale kanë ndarje të veçanta ose gjyqtarë të caktuar për të trajtuar lloje të caktuara të krimeve të tilla si gjykata e drogës, nganjëherë e njohur edhe si një "gjykatë për zgjidhjen e problemeve".

Disa shtete si Kalifornia kanë bashkuar të gjitha gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe inferior për ta bërë procesin gjyqësor më efikas.⁹⁰ Në sisteme të tilla gjyqësore, ende ekzistojnë departamente me juridiksion të kufizuar brenda gjykatave gjyqësore dhe shpesh këto departamente zënë pikërisht të njëjtat mjedise që dikur kishin pushtuar si gjykata të pavarura me juridiksion të kufizuar.⁹¹ Megjithatë, si ndarje administrative thjeshtë, departamentet mund të riorganizohen sipas gjykimit të secilit gjyqtarë kryesues të gjykatës gjyqësore në përgjigje të ndryshimit të numrit të çështjeve.⁹²

Ndryshe nga gjykatat federale, ku gjykatësit janë kandidatë të propozuar nga presidenti dhe të konfirmuar nga Senati i SH.B.A.-së që shërbejnë me mandat të përjetshëm, shumica dërrmuese e shteteve kanë disa gjyqtarë të zgjedhur dhe metodat e emërimit për gjyqtarët e emëruar ndryshojnë shumë. Gjyqtarët e gjykatës shtetërore zakonisht janë avokatë të shquar të cilët kanë pasur një përfshirje në politikë, por ka edhe përjashtime.

⁹⁰ "[Government Code Section 424](#)". State of California Legislative Council. Retrieved July 25, 2014.

⁹¹ Bureau, U.S. Census. "[American FactFinder – Results](#)". [factfinder.census.gov](#). Retrieved October 24, 2017.

⁹² Analysis, US Department of Commerce, BEA, Bureau of Economic. "[Bureau of Economic Analysis](#)". [ëëë.bea.gov](#). Retrieved 2018-03-13.

Gjykatësit e gjykatave shtetërore zakonisht paguhen më pak, kanë shtabet më të vogla dhe merren me ngarkesa më të mëdha se homologët e tyre në gjyqësinë federale.

Të rumbullakojmë. Gjykatat e shteteve, ashtu sikur gjykatat federale, gëzojnë autoritetin për të rishqyrtuar legjislacionin nëse është në pajtim me Kushtetutën apo jo. Por, në bazë të konceptit të kontrolleve dhe ballansimeve, gjykatat nuk janë tërësisht të pavarura nga pjesa tjetër e sistemit politik. Për dallim nga gjykatësit federal, gjykatësit e gjykatave shtetërore zakonisht zgjidhen periodikisht, por edhe ata i nënshtrohen përgjegjësisë (paditjes) për sjellje jo të mira. Në shumicën e shteteve gjyqtarët e gjykatave shtetërore nuk emërohen, por zgjidhen me anë të votimeve, sikurse përfaqësuesit e dy degëve tjera të qeverisjes. Pra, sa i përket gjyqësorit edhe në nivel të shteteve ekziston hierarkia në kuptimin e rangimit të gjykatave. Ashtu siç u potencua ato gjyqe në princip gjykojnë lëndë që kanë të bëjnë me ligjvënien lokale, të drejtat e njeriut dhe të tjera, pra lëndë që nuk janë në kompetenca të gjyqësisë federale.

Në princip gjyqet e shteteve kanë një shtrirje më të gjërë se gjyqet federale. Në të gjitha rastet ku në mënyrë taksative nuk janë të autorizuar gjyqet federale, kompetentë janë gjyqet e shteteve.

Ashtu siç u nënvizua, në kuptimin hierarkik ekziston tres hkallshmëria e organizimit të gjyqësorit në nivel të shteteve, edhe pse shumë çka varet nga kushtetutat e shteteve. Nivelin më të ulët e bëjnë Jusstices of Peace (Gjykatësit e paqës). Tre gjykatës gjykojnë si individë. Ata kanë kompetenca të kufizuara në sferën e kundërvajtjeve, në veprat më të vogla penale dhe seancat civile. Ata gjithashtu kryejnë hetuesin paraprake në shumicën e rasteve penale, ata bëjnë kurorëzimet etj.

General Trial Courts (Gjykatat me kompetenca të përgjithëshme) janë kompetent për shumicën e rasteve civile dhe penale, si istancë e parë dhe si istancë ankimi e Jusstices of Peace. Dhe për fund, çdo shtet ka nga një gjykatë të lartë ose gjykatë apelacioni. Këta gjykata janë kompetentë për ankimet e instancave më të ulta gjyqësore në nivel të shteteve. Të theksojmë edhe atë se përafërsisht në një të tretën e shteteve veprojnë edhe një instancë e gjyqeve që gjendet ndërmjet gjyqeve të kompetencave të përgjithshme dhe gjyqeve të larta apo të apelacionit.

4. Organizimi i pushtetit lokal

Qeveritë komunale - ato që përkufizohen si qytete, rrethe, qyteza (përveç Alaskës), fshatra dhe qyteza - përgjithësisht janë të organizuara rreth një qendre popullsie dhe në shumicën e rasteve korrespondojnë me përcaktimet gjeografike të përdorura nga Byroja e Regjistrimit të Shteteve të Bashkuara për raportimin e strehimit dhe statistikat e popullsisë. Komunat ndryshojnë shumë në madhësi, nga miliona banorë të qytetit të Nju Jorkut dhe Los Anxhelosit tek 287 njerëz që jetojnë në Jenkins të Minesotës.

Komunat në përgjithësi marrin përgjegjësi për parqet dhe shërbimet rekreative, policinë dhe departamentet e zjarrit, shërbimet e strehimit, shërbimet emergjente mjekësore, gjykatat komunale, shërbimet e transportit (duke përfshirë transportin publik), dhe punët publike (rrugë, kanalizime, heqjen e borës, shenjat dhe kështu me radhë).⁹³

Amendamenti i Dhjetë i Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara e bën qeverinë lokale një çështje të shtetit dhe jo të ligjit federal, me raste të veçanta për territoret dhe rrethin e Kolumbisë. Si rezultat, shtetet kanë adoptuar një shumëllojshmëri të gjerë të sistemeve të qeverisjes lokale. Zyra e Regjistrimit të Shteteve të Bashkuara kryen regjistrimin e qeverive çdo pesë vjet për të përpiluar statistika për organizimin e qeverisë, punësimin publik dhe financat e qeverisë. Kategoritë e qeverisjes vendore të themeluara në këtë Regjistrim të Qeverive janë një bazë e përshtatshme për të kuptuar qeverisjen lokale në Shtetet e Bashkuara. Kategoritë janë si vijon :

⁹³<https://www.whitehouse.gov/about-the-white-house/state-local-government/>

1. Qeveritë e Qarkut
2. Qeveritë e qytetit ose të qytetit
3. Qeveritë komunale
4. Qeveritë lokale me qëllim të veçantë

Qeveritë e qarkut janë organizuar qeveri lokale të autorizuar në kushtetutat dhe statutet e shtetit. Qarqet dhe ekuivalentët e qarkut formojnë ndarjen administrative të nivelit të parë të shteteve.

Të gjitha shtetet janë të ndara në qarqe ose ekuivalente të qarkut për qëllime administrative, megjithëse jo të gjitha qarqet ose ekuivalentët e qarkut kanë një qeveri të organizuar të qarkut. Qeveria e qarkut është eliminuar në të gjithë Konektikatin dhe Rhode Island, si dhe në pjesë të Massachusetts. Borxhi i paorganizuar në Alaskë gjithashtu nuk funksionon nën një qeveri të nivelit të qarkut. Përveç kësaj, një numër qytetesh të pavarura dhe qarqe të konsoliduara të qytetit veprojnë nën qeveritë komunale që i shërbejnë funksioneve të qytetit dhe të qarkut.

Në zonat ku mungon një qeveri e qarkut, shërbimet ofrohen nga qytete të nivelit më të ulët ose nga komunat, ose nga shteti.

Qeveritë e qytetit ose vendbanimeve organizohen nga autoritetet lokale të autorizuar në kushtetutat shtetërore dhe statutet e 20 shteteve verilindore dhe mesdhetare, të krijuara për të siguruar qeverinë e përgjithshme për një zonë të caktuar, përgjithësisht bazuar në nëndarjen gjeografike të një qarku. Në varësi të ligjit të shtetit dhe rrethanave lokale, një vendbanim mund ose nuk mund të përfshihet dhe shkalla e autoritetit mbi shërbimet e qeverisjes vendore mund të ndryshojë shumë.

Qytetet në gjashtë shtetet e New England dhe komunat në New Jersey dhe Pensilvani janë përfshirë në këtë kategori nga Byroja e Regjistrimit, pavarësisht faktit se ata janë korporata ligjërish komunale, pasi struktura e tyre nuk ka lidhje të nevojshme me përqëndrimin e popullsisë, është tipike për komunat diku tjetër në Shtetet e Bashkuara. Në veçanti, qytetet në Nju Angli kanë fuqi shumë më të madhe se shumica e fshatrave në vende të tjera dhe shpesh funksionojnë si ligjërish ekuivalente me qytetet, zakonisht ushtrojnë rangun e plotë të pushteteve që ndahen midis qarqeve, fshatrave dhe qyteteve të shteteve të tjera. Një dimension shtesë që dallon qeveritë vendore nga komunat është rrethanat historike që rrethojnë formimin e tyre. Për shembull, qytete në New England janë përkufizuar edhe nga një traditë e qeverisjes vendore e kryesuar nga mbledhjet e qytetit - kuvendet të hapura për të gjithë votuesit për të shprehur mendimet e tyre mbi politikën publike.

Termi "qytet" përdoret gjithashtu për një nivel lokal të qeverisjes në Nju Jork dhe Wisconsin. Termat "qytet" dhe "vendbanim" përdoren në mënyrë të ndërsjellë në Minesota.

Qeveritë komunale janë organizuar qeveri lokale të autorizuar në kushtetutat dhe statutet shtetërore, të krijuara për të siguruar qeverinë e përgjithëshme për një zonë të përcaktuar, që përgjithësisht i korrespondon një qendre popullsie më shumë sesa një nga një sërë zonash në të cilat një bashkësi është e ndarë. Kategoria përfshin ato qeveri të përcaktuara si qytete, qyteza (përveç Alaskës), qytete (përveç Minesotës dhe Wisconsin), dhe fshatrat. Ky koncept korrespondon përafërsisht me "vendet e inkorporuara" që njihen në raportimin e regjistrimit të popullsisë dhe statistikave të strehimit, edhe pse Byroja e Regjistrimit përjashton qytetet e Anglisë nga statistikave të tyre për këtë kategori dhe numri i qeverive komunale përjashton vendet që janë jo aktive nga qeveria .

Komunat shkojnë në madhësi nga shumë të vogla (p.sh., fshati Monowi, Nebraska, me vetëm 1 banor), në atë shumë të madh (p.sh. në qytetin e Nju Jorkut, me rreth 8.5 milion njerëz) dhe kjo reflektohet në rangun e llojet e qeverive komunale që ekzistojnë në fusha të ndryshme.

Në shumicën e shteteve, qeveritë e qarkut dhe komunave ekzistojnë krah për krah. Megjithatë ka përjashtime për këtë. Në disa shtete, një qytet, ose duke u ndarë nga qarku ose qarqe ose duke u bashkuar me një ose më shumë qarqe, bëhet i pavarur nga çdo qeveri e qarkut funksionues veçmas dhe funksionon si si një qark dhe si një qytet. Në varësi të shtetit, një qytet

i tillë njihet si ose si një qytet i pavarur ose një qark i konsoliduar i qytetit. Një juridiksion i tillë përbën një ekuivalent të qarkut dhe është analog me një autoritet unitar në vendet e tjera. Në Connecticut, Rhode Island dhe në pjesë të Masaçusetsit, qarqet ekzistojnë vetëm për të përcaktuar kufijtë për funksione të tilla të nivelit shtetëror si rrethet e parkut ose zyrat gjyqësore (Massachusetts).

Qeveritë komunale zakonisht ndahen administrativisht në disa departamente, varësisht nga madhësia e qytetit.

Qeveritë lokale kanë qëllime të veçanta. Për shembull zonat shkollore janë organizuar nga njësitë vendore që ofrojnë arsim fillor dhe të mesëm publik, të cilët sipas ligjit të shtetit kanë autonomi të mjaftueshme administrative dhe fiskale për t'u kualifikuar si qeveri të ndara. Kategoria përjashton sistemet shkollore publike të varura të qarkut, komunave, vendbanimeve ose qeverive të shtetit (p.sh., ndarjet shkollore).

Rrethet e veçanta janë të gjitha entitete lokale të organizuara përveç katër kategorive të listuara më sipër, të autorizuar nga ligji shtetëror për të ofruar funksione të përcaktuara siç janë përcaktuar në statutin e qarkut ose në dokument tjetër themelues dhe me autonomi të mjaftueshme administrative dhe fiskale për t'u kualifikuar si qeveri të veçanta të njohur nga një sërë titujsh, duke përfshirë rrethet, autoritetet, bordet, komisionet, etj, siç përcaktohet në legjislacionin shtetëror. Një qark i veçantë mund të shërbejë në fusha të shteteve të shumëfishta nëse themelohet nga një marveshje ndërshtetërore. Rrethet e veçanta janë gjerësisht të njohura, kanë gëzuar "rritje fenomenale" dhe "pothuajse janë trefishuar në numër" nga viti 1957 deri në 2007.⁹⁴

Të rrumbullakojmë. Vetqeverisja lokale në SHBA ka një traditë të lashtë dhe gjithëpërfshirëse. Rrënjët e saj i gjejmë në organizimin e kolonive britanike në kontinentin amerikan. Ata nga shteti amë sollën shumë praktika të dobishme. Sot siç konstatojmë, çdo njësi federale disponon me një vetqeverisje lokale të avansuar. Normal se ndërmjet shteteve të veçanta shihen qartë elementet e përbashkëta dhe ata të veçantat në kuptimin e organizimit të vetqeverisjes lokale. Gjithashtu ekzistojnë dallime evidente ndërmjet vetqeverisjes lokale në qytete dhe fshatra.

⁹⁴https://en.wikipedia.org/wiki/Local_government_in_the_United_States

Në përgjithësi shiquar vetëqeverisja lokale është dy shkallëshe. Dallojmë komunat dhe rrethet. Normal se është e pamundëshme të krahasohet vetëqeverisja lokale e Nju Jorkut, çikagos dhe Dallasit me atë të Okllohamës dhe Ajovës.

Në qytetet e mëdha mbisundon sistemi i menaxherëve të qytetit si ekspertë të shkolluar për punët e vetqeverisjes lokale. Ata disponojnë shumë kompetenca, sidoemos në sferën e mbrojtjes së ambientit jetësorë, rregullimit të komunikacionit, infrastrukturës etj.

Në përgjithësi kur e analizojmë vetqeverisjen lokale në SHBA, na bien në sy aktivitetet e mëposhtme: shëndeti publik, arsimi, mbrojtja sociale, ndërtimi i banesave dhe lagjeve sociale, llogarimbajtja për më të moshuarit dhe të retarduarit etj. Me fjalë tjera vetqeverisja lokale në princip i mbulon sferat që e tangojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë qytetarin e rëndomtë dhe kanë benifite shiquar nga prizmi i politikave tatimore.

KAPITULLI V

V ROLI DHE VENDI I PARTIVE POLITIKE DHE GRUPEVE TË

INTERESIT NË SISTEMIN POLITIK TË SHBA- VE

Origjina dhe konstituimi i partive politike

Karakteristikat themelore të partive politike

Kontributi i partive politike në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dy partiak

Koncepti dhe vendi i grupeve të interesit në sistemin politik të SHBA- ve

Raportet ndërmjet grupeve të interesit dhe partive politike

1. Origjina dhe konstituimi i partive politike

Edhe pse partitë politike sot paraqesin një fenomen global, rruga zhvillimore e tyre dallon prej kontinenti në kontinent dhe prej shteti në shtet. SHBA-të dhe partitë e tyre politike dallojnë në shumëçka nga partitë politike që lindën dhe u zhvilluan në kontinentin e vjetër.

Edhe pse partitë politike në SHBA janë në formën e tyre embrionale po aq të vjetra sa edhe vetë shteti amerikan, ata nuk janë kategori kushtetuese. Etërit e Kushtetutës së SHBA-ve tregojnë shumë rezerva ndaj partive politike dhe veprimit të tyre shoqërorë. Ata mendonin se partitë politike provokojnë ndarje në shoqëri. Ata mendonin se partitë politike duke u lëshuar në luftën për pushtet do ta lënin anësh atë që e llogarisnin imperativ kryesorë për një shtet në lindje e sipër, pra mendonin se partitë politike nuk do të angazhoheshin mjaftueshëm për atë që quhet interes i përgjithshëm e që për atë periudhë kohore kishte rëndësi parësore për zhvillimin dhe perspektivat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Etërit Themelues të Amerikës donin që çdo qytetar të votonte vetë për çdo kanddiat, pra sipas bindjeve vetanake, pa ndërhyrjen e grupeve të organizuara politike. Sikurse shihet Etërit Themelues në rastin konkret shprehnin një dozë utopizmi duke menduar se qytetarët amerikan do ta ndjekin këtë logjikë që në princip është parimore dhe shumë domethënëse. Megjithatë zhvillimi i shoqërisë amerikane lëvizi në një drejtim që ishte i pa shmangëshëm, kushtet dhe rrethanat e krijuara imponuan gradualisht formimin e partive politike që u shëndrruan në bartëse të aktiviteteve politike dhe politikbërjes ashtu si ndodhte edhe në kontinentin e Evropës.

Edhe përpos faktit se në pjesën më të madhe të historisë amerikane në skenën politike kanë dominuar dy parti politike, duhet thënë se në territorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kanë vepruar më shumë parti. Për momentin janë aktive me dhjetëra parti politike. Vetëm një numër shumë i vogël i tyre është shtrirë në tërë teritorin e vendit. Pos kësaj duhet theksuar fakti që në historinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë të shënuara edhe

dhjetëra parti politike që kanë vepruar në periudha të ndryshme kohore por që asnjëherë nuk kanë arritur ndonjë autoritet të veçantë në sistemin politik amerikan.⁹⁵ Në periudhën para ratifikimit të Kushtetutës, bëhej një kampanjë e zjarrtë ndërmjet atyre që angazhoheshin për rregullimin federativ të shtetit dhe atyre që mendonin se SHBA-të duhej të mbeteshin një Konfederatë me një kushtetutë më të avansuar. Pra zhvillohenin pikëpamje të ndryshme në lidhje me kahjet që duhej të merrte shteti i ri. Në kontekst të kësaj që u tha në skenën politike u paraqitën dy grupacione me pikëpamje të kundërta që përpiqeshin të fitonin mbështetje për çështjen e tyre. Fjala është për pasuesit e Aleksandër Hamiltonit që identifikoheshin si federalist, dhe pasuesit e Tomas Xhefersonit që identifikoheshin si antifederalist, përkatësisht si demokratë-republikanë. Federalistët e përkrahnin kushtetutën e re, ndërsa antifederalistët e kundërshtonin ratifikimin e saj. Hamiltoni qysh në fazën e sjelljes së Kushtetutës paraqitej si përkrahës i centralizmit manufaktural dhe një qeverie të fuqishme. Ai dallohej me qëndrimet e tij për një lidhje sa më të fortë ndërmjet njësive federale duke i mbrojtur interesat tregëtare, bankiere dhe anie ndërtimtarisë. Nga ana tjetër Xhefersoni parapëlqente një republikë agrare të decentralizuar, në të cilën qeveria federale do të kishte pushtet të kufizuar. Edhe pse federalistët dhe antifederalistët konsiderohen si parti më të vjetra politike amerikane, ata në fakt paraqesin formën embrionale të organizimit partiak. Që të dy grupacionet politike u formuan në vitin 1789 dhe me interesat e veçanta që i proklamonin i vunë bazat e sistemit të ardhshëm dypartiak të Shteteve të Bashkuara. Megjithatë grupet në fjalë më tepër kishin karakteristika të grupeve të interesit se sa të partive politike.

Duke përshkruar ambientin politik të SHBA-ve të asaj kohe, Alexis de Tocqueville, shkrimtar francez në veprën e tij të njohur „Demokracia në Amerikë,, do të konstatojë se

⁹⁵ Etem Aziri, Sistemet politike, Tetovë 2012, faqe 214

ndarja e Amerikanëve në federalistë dhe antifederalistë është diçka krejt e natyrshme sepse ekzistojnë dy mendime që janë të vjetra sa bota të cilat në mënyrë permanente janë ballafaquar në forma të ndryshme dhe me emra të ndryshëm në të gjitha shoqëritë e lira, njëra tenton kufizimin ndërsa tjetra zgjerimin e pakufijshëm të pushtetit të popullit.⁹⁶

Si do qoftë, vlen të konstatohet se periudha 1775-1828, konflikti ndërmjet Hamilltonit dhe Xhefersonit, ndërmjet federalistëve dhe antifederalistëve nuk kishte një bazë të qëndrueshme ideologjike-programore. Pra në princip është fjala për një konflikt të karakterit ekonomik, meqë shprehej si konflikt i manufakturës gjegjësisht industrisë dhe bujqësisë komerciale. E përbashkët mes dy tendencave, pra në mes federalistëve dhe antifederalistëve ishte idea e përparimit dhe pavarësisë së SHBA-ve. Kur flasim për paraqitjen e partive politike në SHBA patjetër të meren parasysh edhe kushtet dhe rethanat e posaçme në të cilat zhvillohej ky shtet. Këtu para se gjithash aludojmë në tokat e lira në drejtim të perëndimit të cilat deri në vitin 1896 mundenin të zптоheshin dhe të përpunohenin pa kurfar problemi. Kësaj duhet shtuar edhe resurset natyrorë, xehet dhe resurset energjetik. Të gjitha këta së bashku ndikonin në amortizimin e konflikteve të brendëshme në radhët e shtresave të pa kënaqura.

Kjo që u tha sa më lartë duhet plotësuar edhe me disa informacione shtesë për këtë periudhë të zhvillimit të SHBA-ve. Si e para, në këtë periudhë kohore, pra 1775-1828, dallimet në interesa të grupeve shoqërore dhe shtresave shoqërore ende nuk ishin qartë të shprehura dhe nuk kërkonin apo synonin një formë institucionale. Klasa sunduese që nënkuptonte borgjezinë tregtare në Veri dhe plantazherët e pasur të Jugut angazhohej mbi të gjitha për forcimin e aparatit të pushtetit shtetërorë. Pra klasa sunduese në këtë fazë ende nuk kishte një koncept të qartë ideorë e as një program të caktuar që do ti tubonte rreth saj idhtarët nga masat e gjëra popullore. Dhe më në fund, një arsye e fuqishme për mos ekzistimin e partive politike në kuptimin e sotëm për periudhën në fjalë paraqet edhe e drejta e kufizuar e votës.

⁹⁶Alexis de Tosqueville, Democracy in America, New York, 1956, faqe 88

Me zgjerimin e drejtës së votës u krijuan rrethanat e mirëfillta për zhvillim të sistemit partiak në SHBA. Pra, në bazë të kësaj që u tha më lartë mundemi të konkludojmë se fillet e partive politike në SHBA duhet kërkuar në asociacionet jo të forta të interesave të tregëtarëve, bankierëve, anie ndërtuesve, plantazherëve, spekulantëve të llojllojshëm dhe grupacioneve tjera të cilët duke u stimuluar nga interesat e përbashkëta në kontinuitet formonin lidhje politike të cilat u shndëruan me kalimin e kohës në organizata të mirëfillta politike, gjegjësisht në parti politike. Në periudhën kohore 1816-1824 edhe më tutje në formimin e partive politike shikohej si diçka e rrezikshme për perspektiva të qëndrueshme zhvillimore të SHBA-ve. Themeluesi i partisë bashkëkohore Demokratike, Andrej Xhekson në një letër dërguar Monrosë në vitin 1816 thoshte se çdo përcaktim partiak dhe zhvillimi i sistemit partiak duhet lënë anash, duke bërë të qartë se është koha definitivisht të çrrënjoset fryma partiake.⁹⁷ Federalistët dominuan skenën politike amerikane në periudhën 1789-1801 dhe mbetën në skenën politike deri në çerekun e parë të shekullit XIX. Ky grupacion (parti) përbëhej kryesisht nga afaristët e pasur të kohës, tregtarët dhe fermerët konservativ si dhe pronarët e mëdhenj të tokave. Pra, partia kishte shumë karakteristika të një partie aristokratike. Partia federaliste angazhohej për një pushtet të fuqishëm ekzekutiv. Në vitin 1792 u formua Partia Demokratike-Republikane. Partinë e formuan Tomas Xhefersoni dhe James Madison. Kjo parti politike në një masë, i proklamonte parimet antifederaliste dhe në fazat e para të veprimit të saj, kryesisht paraqitej si opONENTE e Partisë Federaliste e cila haptazi si strukturë e favorizonte pjesën e pasur të shoqërisë amerikane të asaj kohe. Kur flitet për Partinë Federaliste dhe Partinë Demokratike Republikane në Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet theksuar se në një mënyrë që të dyja paraqesin degëzime të po të njëjtit trung. Në fakt Partia Federaliste, u themelua siç u theksua më lartë nga Hamiltoni, kurse partia Demokratike Republikane nga Xhefersoni.

⁹⁷. James Parton, The Life of Andrew Jackson, voll.3, New York, 1960, faqe 362

Që të dy ishin funksionarë të lartë, dhe bashkëpunëtorë të presidentit të parë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Xhorxh Uashington i cili në dy mandatet e veta presidenciale as që deshti të dëgjojë për partitë politike si grupacione me interesa të veçanta. Hamiltoni gjatë presidencës së Uashingtonit ishte sekretar i thesarit, kurse Xhefersoni sekretar shtetëror. Si arsye kryesore e ndarjes së këtyre dy strukturave potencohen qëndrimet e kundërta të Hamiltonit dhe Xhefersonit lidhur me mënyrën e organizimit të pushtetit në SHBA. Përderisa, Hamiltoni angazhohej për një pushtet të fuqishëm qendror, Xhefersoni ishte i mendimit se bartës të vërtetë të sovranitetit duhet të jenë qytetarët të ndarë në shtete individuale.

Zgjedhjet e para presidenciale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në një sistem të pastër dypartiak u zhvilluan në vitin 1796 në ç'rast federalisti John Adams u zgjodh për President, ndërsa republikani Tomas Xheferson u zgjodh Zëvendëspresident.

Mosmarrëveshjet e para më serioze mes federalistëve dhe republikanëve erdhën në shprehje dy vite më vonë, kur Kongresi i dominuar nga federalistët miratoi Ligjin mbi të Huajt. Sipas ligjit në fjalë zgjatej kohëqëndrimi i të huajve që synonin marrjen e nënshtetësisë amerikane, ndërsa Presidentit i jepej e drejta që të urdhërojë ekstradimin e çdo të huaji që konsideronte se paraqet kërcënim për interesin amerikan. Nga ana tjetër Ligji i Sedicionit parashihte dënim me para ose me burgim për të gjithë ata që publikonin deklarata të rrejshme për presidentin, qeverinë dhe kongresin.

Në zgjedhjet e rradhës, të vitit 1800 Tomas Xhefersoni i fitoi zgjedhjet presidenciale, kjo fitore shënoi fillimin e mbarimit të Partisë Federaliste. Zgjedhjet e fundit presidenciale në të cilat kjo parti mori pjesë, ishin ato të vitit 1816 në ç'rast kryetar u zgjodh James Monroe nga rradhët e Partisë Republikane.

Definitivisht federalistët u zhdukën nga skena politike e SHBA-ve në vitin 1828 dhe u zëvendësuan nga Vigët, të cilët e kundërshtonin zgjedhjen e Endru Xheksonit. Vigët garuan në skenën politike amerikane deri më vitin 1850 me partinë demokratike e cila u formua në vitin 1800 si pasardhëse e partisë Demokratiko-Republikane. Vigët si parti politike gjatë veprimit të tyre dy herë e morën presidencën. Viti 1850 që i kobshëm për Vigët. Në këtë vit u aktualizua çështja e skllavërisë e cila shkaktoi një përçarje të thellë në radhët e Vigëve. Kjo përçarje e cila

kishte të bëj me lejimin ose moslejimin e skllavërisë në territoret e reja të vendit në Perëndim, i lëkundti fuqishëm radhët e Vigëve, lëkundje kjo që gradualisht çoi deri në shpërbërjen e tyre. Partia e Vigëve u zëvendësua në vitin 1854 nga Partia Republikane. Partia Republikane e cila sa i takon skllavërisë kishte qëndrim të prerë, se skllavëria duhej ç'rrënjësuar nga të gjitha territoret e Shteteve të Bashkuara, gjashtë vjet më vonë me zgjedhjen e Abraham Linkolnit për President e mori presidencën si partia më e re në vend. Qëndrimi i Partisë Republikane dhe vetë Presidentit Abraham Linkoln ndaj skllavërisë solli deri te lufta qytetare ndërmjet Veriut dhe Jugut dhe fitores definitive të progresives ndaj konservatores.

Partia Demokratike konsiderohet si kultivuese e ideve të Medisonit, Xhefersonit dhe Xheksonit që ishte njëri ndër kundërshtarët më të zëshëm të formimit të partive politike në truallin amerikan, ndërsa Partia Republikane llogaritet kultivuese e ideve të Hamiltonit dhe Linkolnit.

Prej gjysmës së shekullit XIX u etablua dypartizmi mjaft stabil në sistemin politik të Shteteve të Bashkuara. Partia Demokratike që është partia më e vjetër në botën perëndimore, tradicionalisht qëndron në të majtë të Partisë Republikane. Megjithatë, kjo parti nuk është majtiste në kuptimin e partive socialiste, socialdemokrate ose laburiste që veprojnë në shumë vende të botës bashkëkohore. Partia Republikane është parti e krahut të djathtë dhe si e tillë është më konservatore se Partia Demokratike. Njohësit e mirë të partive politike amerikane thonë se të dy partitë kanë krahun liberal dhe konservator dhe se për shumë çështje krahët e njëjtë të dy partive në qëndrime janë shumë më të afërt se dy krahët e po të njëjtës parti.

Prej gjysmës së shekullit XIX e deri më sot, pushtetin shtetëror me ndërrime të kohëpaskohshme e ushtrojnë dy partitë e lartpërmendura. Deri më sot asnjëra nga "partitë e treta" as prej së largu nuk ia ka arritur qëllimit që tua rezikojë pozitën monopoliste të ndërtuar decenie me radhë.

2. KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË PARTIVE POLITIKE

Partitë politike të SHBA-ve, Partia Demokratike dhe Partia Republikane të cilat gati dy shekuj qeverisin me SHBA-të, dallojnë në shumë çka nga partitë politike që veprojnë në pjesët tjera të globit. Ata dallojnë në rradhë të parë për nga struktura organizative por gjithashtu dallimet janë evidente edhe sa i takon mënyrës së funksionimit në praktikë.

Partitë në SHBA paraqesin organizata labile pa ndonjë organizim të shprehur hierarkik dhe pa ndonjë disiplinë të brendëshme. Pra mungon organizimi strukturorë që e hasim te partitë politike në Evropë. Mungojnë statutet mirë të definuar dhe relacionet e organizatave partiake, prej nivelit lokal e deri te ajo që quhet udhëheqje qendrore. Mungesa e një organizimi të fuqishëm partiak gjegjësishtë kohezioni i zbetë brendapartiak në nivel nacional, gjegjësishtë në nivel të federatës, mungesa e statuteve të shkruara, anëtarësia jo mirë e definuar , mungesa e një aktiviteti permanent në parti, mospërfillja e komponentit teoriko-ideologjik, dhënja përparësi prioriteteve shumë konkrete, partitë në SHBA i bëjnë të dallohen nga partitë në vëndet tjera.

Kjo që u tha duhet kuptuar si pasojë e gërshetimit të më tepër faktorëve siç janë faktori historik, etnik, ekonomik, social, politik, gjeografik, religjioz, kulturorë, ideologjik etj, të cilët në mënyra të ndryshme ndikuan në rrjedhat zhvillimore të jetës partiake dhe determinuan ndërtimin e strukturave të caktuara dhe formave specifike të veprimit të partive politike në SHBA.

Gjatë analizimit të qëndrimeve të autorëve amerikan në lidhje me paraqitjen dhe veprimin e partive politike bie në sy injorimi apo mos përmëndja e aspektit klasorë në përkufizimin e partive politike. Kjo duhet kuptuar si një tendencë permanente e injorimit të klasave shoqërore dhe luftave klasore. Kjo është tipike për autorët borgjez në përgjithësi e sidomos për autorët amerikan të cilët në mënyrë të sofistikuar çdo herë i janë larguar faktorit klasorë. Nga ana tjetër ata shumë bindshëm potencojnë faktin se partitë politike ndikojnë në

avansimin e demokracisë brenda SHBA-ve. Në kushtet e përvojave amerikane, partinë politike e përbëjnë një grup individësh të cilët synojnë kontrollin e qeverisë përmes proceseve zgjedhore, me qëllim që më pastaj ti imponojnë interesat e tyre.⁹⁸ Kur bisedohet për definimet e partive politike në SHBA patjetër të thuhet se ekziston një laramani në qëndrimet e autorëve amerikan si gjithë andej në botë kur bëhet fjalë për kufizimin e partive politike. Megjithatë shumica e tyre janë dakord se partitë politike në kuptim të ngushtë të fjalës nuk qëndrojnë në dimensionin e të përgjithshmes dhe se ata gjithnjë e më shumë veprojnë në interes të tyre, gjegjësishtë grupacionit më të ngushtë që synon marrjen e pushtetit dhe pjesëmarrjes në politikbërje. Në fakt autorët amerikan si karakteristika të përgjithshme i përmendin qëllimet e partive politike, do të thotë veprimin e partive në drejtim të marrjes së pushtetit politik për realizimin e pikë synimeve të grupit. Te partitë politike në SHBA shumë më qartë vërehet roli i tyre i një lidhjeje të shtetit me shoqërinë, forcave shoqëro-politike me aparatit shtetërorë të pushtetit. Pra, nga kjo që u tha bëhet i qartë roli ndërmjetsues i partive politike në SHBA, në ç'rast tendenca e tyre për marrjen, ruajtjen dhe ushtrimin e pushtetit politik i tejkalon këto korniza në momentin kur partitë politike shëndrrohen në ndërmjetësuese ndërmjet shtetit dhe shoqërisë, ndërmjet individit dhe veprimit politik. Të rrumbullakojmë. Edhe në SHBA, sikurse edhe gjithë andej në botë karakteristikë bazë e partive politike mbetet lufta për pushtet, që shprehet përmes marrjes së pushtetit politik. Por duhet thënë qartë se karakteristikë po aq e rëndësishme është edhe roli i tyre ndërmjetësues që nënkupton logjikën funksionale të ekzistimit të partive politike atje. Ndryshe thënë partitë politike në SHBA nuk paraqesin qëllim në vete. Garat për marrjen e pushtetit politik në të njëjtën kohë sipas logjikës amerikane paraqesin edhe gara të progresit shoqërorë në një kontekst më të gjërë.

Një segment tjetër ku dallojnë partitë politike të SHBA-ve nga partitë europiane është strukturimi organizativ i tyre si dhe orientimet programore.

⁹⁸ Hugh A. Bone, American Politics and the Party System, New York, 1955, Faqe 273.

Në fakt programi i partisë paraqet kornizën bazë të orientimit politik dhe aktivitetet bazike të veprimit të partisë brenda sistemit politik të një shteti. Programi i mbërthen qëndrimet kryesore të partisë në lidhje me politikën e brendëshme dhe politikën e jashtme të shtetit që ajo duhet ti jetësojë me marrjen e pushtetit. Megjithatë partitë politike të SHBA-ve karakterizohen me programe jo mirë të përcaktuara dhe shpesh herë shumë të paqarta dhe pa një orientim të kthjellët ideologjik dhe teorik.

Mospërcaktimet mirë të definuara dhe laramania programore janë si rrjedhojë e strukturës së përzier të partive politike. Të dy partitë dominante e kanë krahun e tyre përparimtarë dhe konservatorë dhe jo rastësishtë qëndrimet e tyre në aspektin ekonomik, social dhe politik janë të llojllojshëm. Përmes platformave partiake insistohet të harmonizohen interesat divergjente.

Këto dobësi në veprimin e partive politike i kanë vërejtë dhe i kanë identifikuar vetë teoricienët amerikanë që i hulumtojnë partitë politike. Ata tërheqin vërejtjen për mungesën e programeve të mirëfillta si një e metë serioze, gjegjësishtë bëjnë të qartë diskrepancën ndërmjet asaj që përshkruhet në programet e partive dhe premtimet dhënë elektoratit nga njëra anë si dhe veprimin praktik të partive sidoemos pasi ta marrin presidencën. E gjithë kjo që u tha ka ndikuar që elitat partiake tu kushtojnë më shumë rëndësi dispozitave programore.

Elementi i dytë konstituiv i partive politike në përgjithësi është struktura organizative. Organizimi strukturorë i partive politike në SHBA i ka rrënjët në klubet e njohura si „caucus„ dhe „komiteteve për korespondencë„ të cilët vepronin qysh në periudhën para revolucionit dhe shërbenin si qendra debative mbi politikbërjen dhe çështjeve tjera të rëndësishme për jetën e qytetarëve të regjioneve të caktuara, për sjellje të vendimeve si dhe nominimin e zgjedhje të nënpunësve të qytetit. Me zgjerimin e drejtës së votës u imponua nevoja për zgjerim të vend votimeve të cilat me kalimin e kohës u shëndrruan në njësi bazë të organizatave partiake. Pra organizimi i partive politike në SHBA sipas prejardhjes është „lokale„ ndërsa sipas përbërjes „e decentralizuar„.

Sruktura formale e partive politike, kompetencat dhe funksionimi i organeve të tyre si gjithëkund në botë rregullohet me ligjet e veçanta të shteteve, megjithatë në jetën reale politike

të këtij shteti, rol dominant në formimin e partive politike luajnë punëtorët profesional të partive, specialistët e politikës, të cilët vetë amerikanët i kanë emëruar si „maqineri politike,, të cilat si profesion të tyre e kanë luftën për pushtet politik, më qartë thënë shitjen dhe blerjen e votave. Punëtorët politik partiak rol tepër të rëndësishëm luajnë sidoemos në qytetet e mëdha ku maqineritë partiake kanë një ndikim shumë të madh ku shihet qartë lidhja e tyre me interesat ekonomik të mbartësve të kapitalit të madh. Për nga struktura e tyre organizatat partiake janë mjaftë të decentralizuara. Piramidën e tyre organizative e përbëjnë njësitë organizative në nivel shtetërorë dhe lokal me një lidhje shumë të dobët. Kështu që këto forma organizative dallojnë prej shteti në shtet si në aspektin e formatimit ashtu dhe në aspektin e funksionimit në praktikë. Dallimet në ligjet zgjedhore të njësive federative favorizuan formimin e organizatave autonome partiake.

Organizimi partiak i partive politike në SHBA nuk e favorizon elementin hierarkik të funksionimit. Pra organizatat më të ulta nuk iu nënshtrohen vendimeve të organizatave më të larta partiake. Në këtë aspekt para së gjithashë mund të flasim për një bashkëpunim ndërmjet organeve të ulta dhe organeve të larta partiake. E gjithë kjo në një farë mënyre i favorizon lokalizmat. Partitë politike të SHBA-ve nuk munden të trajtohen si diçka sui generis, por patjetër të identifikohen veprimet e tyre që dallojnë dukshëm krahasuar me veprimin e partive politike në kontinentin e Evropës. Për shembull, republikanët dhe demokratët janë të organizuar dhe veprojnë si parti të mirëfillta, respektivisht si parti politike në kuptimin evropian të fjalës vetëm ditën e zgjedhjeve. Por në periudhat mes zgjedhjeve këto grupe ose pjesa më e madhe e tyre reagojnë ndaj problemeve publike në forma shumë karakteristike. Partitë amerikane nuk kanë anëtarësi të rregullt në kuptimin evropian të fjalës, nuk mbajnë kongrese zgjedhore dhe ashtu siç u potencua më lartë nuk lodhen shumë me përpilimin e programeve të qëndrueshme politike. Në partitë politike amerikane kandidatët dhe të zgjedhurit kanë lidhje më të forta me zonën elektorale sesa me vetë partinë dhe organet e saj. Gjithashtu, partitë politike në SHBA, veten e kanë shpallur si parti pa ideologji që nuk guxojmë ta marrim pa rezerva të caktuara. Ata më shumë parapëlqejnë të identifikohen si organizata pragmatike që bëjnë koalicione për realizimin e interesave të ndryshme. Megjithatë, pa marrë parasysh dallimet që janë rezultat i rrethanave konkrete në të cilat u paraqitën dhe veprojnë partitë amerikane, ata në vija të

trasha i kryejnë të njëjtat funksione që i kryejnë partitë në vendet e zhvilluara të botës perëndimore. Edhe pse e proklamojnë karakterin mbi-ideologjik, partitë e Shteteve të Bashkuara, drejtëpërdrejt ose tërthorazi janë në shërbim dhe mbrojtje të rendit liberal përkatësisht neoliberal dhe raportin e forcave brenda atij rendi shoqëror. Ata me veprimin dhe prezencën e tyre në një mënyrë e ngushtojnë hapësirën e paraqitjes së tipeve tjera të partive, sidomos partive rigjide autoritare që me veprimin e tyre do të kishin ndikuar në "çregullime eventuale" të sistemit ekzistues.⁹⁹ Partitë në SHBA një rol tepër të rëndësishëm luajnë gjatë rekrutimit të kandidatëve për pozicionet e liderve. Partitë janë ata që mbajnë llogari që kandidatët e mundshëm t'i plotësojnë të gjitha kriteriumet që i preferon votuesi amerikan, dhe si të atillë të kenë gjasa sa më të mëdha për të korrë fitore. Detyrë bazë e partive në këtë drejtim është të zgjedhin kandidatë dhe t'a organizojnë promovimin e tyre para publikut, përkatësisht para votuesve. Promovimi nuk nënkupton vetëm prezentimin e kandidatëve por edhe krijimin e një klime që garanton fitore eventuale. Pra, partitë marrin një obligim shumë të rëndë mbi supet e veta. Ata duhet me çdo kusht trupit votues t'ia imponojnë logjikën e politikës së tyre e jo të kundërtën, ata tu përshtaten kërkesave dhe preferencave të zgjedhësve. E gjithë kjo duhet bërë në një formë skajshmërisht të sofistikuar që të krijohet përshtypje se partitë janë ata të cilat me çdo kusht i realizojnë kërkesat dhe preokupimet e qytetarëve në bazë të normave dhe standardeve të demokracisë amerikane. Nëqoftëse, nuk ia arrijnë këtij qëllimi, atëherë partia dështon në zgjedhje.¹⁰⁰

Një funksion tjetër me rëndësi të veçantë shoqëror i partive politike të Shteteve të Bashkuara është roli i tyre socializues-edukativ. Partitë politike me qëllim të promovimit të synimeve të veta veç tjerash publikojnë numër të madh publikimesh përmes të cilave e

⁹⁹ Etem Aziri, Partitë politike zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore, Tetovë 2015, faqe 82

¹⁰⁰ Etem Aziri, Partitë politike, Zgjedhjet dhe Sistemet zgjedhore, Tetovë 2015, faqe 82

informojnë opinionin me qëllimet e tyre dhe problemet shoqërore që parashiher të trajtohen dhe zgjidhen brenda një periudhe të caktuar kohore. Në atë mënyrë partitë politike i informojnë qytetarët për problemet e caktuara dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre.¹⁰¹

Gjithësesi sa i takon rolit të partive në sistemin politik të SHBA-ve duhet përmendur edhe prezencën e tyre brenda institucioneve të sistemit e në veçanti brenda organit ligjvënës. Pastaj duhet përmendur rolin e partisë që gjendet në opozitë, në kuptimin e ndjekjes së gabimeve dhe dështimeve të partisë së pozitës, bashkimit e grupacioneve të njerëzve të profileve të ndryshme në një tërësi dhe ndikim integrativ mbi ata etj.

3. KONTRIBUTI I PARTIVE POLITIKE NË NDËRTIMIN E NJË SISTEMI TË QËNDRUESHËM DY PARTIAK

Të gjitha analizat flasin qartë se SHBA-të kanë sistem tipik dy partiak. Demokratët dhe republikanët e ushtrojnë pushtetin shtetërorë shumë decenie me gjasa që kjo gjendje mos të ndryshojë edhe në të ardhmen. Të dy partitë dominante llogariten parti të rendit ekzistues, sepse që të dyja i kultivojnë vlerat liberale gjegjësishtë neoliberalë në ndërtimin e shtetit. Sa i takon trupit votues që i përkrah mund të identifikohet pa ndonjë vështirësi të madhe se kujt province i takon. Identifikimi i votuesve si demokrat ose si republikan nuk është çështje edhe aq e vështirë, përpos faktit që është përmendë se votuesit amerikan janë shumë pragmatik dhe atyre më shumë ju intereson çfarë ofron kandidati konkret, krahasuar me ngjyrat partiake që ai i promovon.

Ashtu siç është nënvizua në këtë punim, zakonisht, Partinë Republikane e mbështesin, të pasurit, biznesmenët, tehnokracia e lartë, më të moshuarit, banorët e viseve rurale dhe

¹⁰¹. Etem Aziri, Partitë politike, Zgjedhjet dhe Sistemet zgjedhore, Tetovë 2015, faqe 83

qyteteve të madhësisë së mesme si dhe pasardhësit e ardhacakëve nga Evropa veriore dhe perëndimore. Partia Demokratike ka një mbështetje më të madhe nga shtresat e ulta dhe të mesme, të varfërit, punëtorët, pjesa më e madhe e intelektualëve, të rinjtë, banorët e qyteteve të mëdha, përfaqësuesve të grupeve të vogla etnike, pasardhësve të emigrantëve nga Evropa Jug-lindore, katolikëve, zezakëve dhe hebreitëve.¹⁰²

Qëllimet programore të Partisë Konservatore mund të sublimohen në disa çështje; theksimi më i shprehur i kompetitivitetit ekonomik dhe iniciativa më të shprehura individuale, shteti minimal, tatime më të ulta, buxhet i ballansuar dhe krasitje e shpenzimeve sociale, sistem i fuqishëm mbrojtjeje dhe përkrahje e trupave amerikane si në Evropë ashtu dhe në pjesët tjera të globit, mbrojtje e institucioneve të vjetra, kundërshtim ndaj reformave dhe forcim i pozicioneve të SHBA-ve gjithandej në botë. Nga ana tjetër qëllimet e Partisë Demokratike janë: theksimi më i shprehur i drejtës konsumuese dhe drejtës së punës, roli më aktiv i shtetit, më shumë të drejta dhe ndarje më e drejtë e të ardhurave, shtimi i fondeve federale për mbrojtje shëndetësore, sigurim social dhe arsimim, përmirësimi i pozitës të grupeve dhe shtresave të varfëra si dhe apelet e shpeshta për ndryshime. Megjithatë, kur flasim për synimet programore të partive politike të Shteteve të Bashkuara çdo herë duhet pasur parasysh mentaliteti i qytetarit të SHBA-ve, i cili në të njëjtën kohë rezonon edhe si liberal edhe si konservator. Ajzenhauer në një rast u shpreh: "Unë jam konzervator sa u takon çështjeve ekonomike, por liberal kur janë në pyetje të drejtat e njeriut". Analizat e bëra në nivel të Shteteve të Bashkuara ofrojnë shumë argumente se partitë politike amerikane sot janë më pak të popullarizuara se në të kaluarën. Megjithatë, nuk mund të mohohet kontributi i tyre në stabilitetin e qeverisjes së vendit. Sistemi politik i Shteteve të Bashkuara është njëri ndër sistemet politike më stabile në botë. Edhe pse në parim amerikanët janë të kënaqur me atë që ofron sistemi amerikan i qeverisjes, herë pas here një numër i konsiderueshëm votuesish u jep përkrahje partive të treta.¹⁰³

¹⁰². Etem Aziri, Partitë politike Zgjedhjet dhe Sistemet zgjedhore, Tetovë 2015, faqe 84.

¹⁰³. Etem Aziri, Sistemet Politike, Tetovë 2012, faqe 222

Megjithatë, kur flasim për dy partizmin amerikan duhet veçuar edhe dobësitë të cilat janë evidente. Disa autorë amerikan potencojnë faktin se ky dypartizëm që identifikohet me partinë Demokratike dhe partinë Republikane të cilat ushtrojnë një monopol në politikbërje në SHBA, gjatë decenieve janë shëndrruar në një „preh,, të biznesit të madh, kështu shumë votues të pa fuqishëm dhe të dëshpruar, pa një alternativë shtesë janë përcaktuar për mospjesëmarrje aktive në zgjedhje.¹⁰⁴

Disa analiza çojnë edhe në përfundime tjera. Kështu që lihet mundësia të mendohet se nga një herë vetë partive politike dominante iu konvenon mosparticipimi masiv i qytetarëve në zgjedhje. Disa hulumtues amerikanë konstatojnë se arsyet kryesore për mos dalje në zgjedhje më tepër ndërlidhen me kontekstin politik në një kuptim të gjërë të fjalës se sa me atë institucional. Miliona qytetarë amerikan nuk paraqiten në vend votime sepse mendojnë se nuk ja vlen njeri të shqetësohet për zgjedhjet. Ata ditën e zgjedhjeve nuk lëvizin prej shtëpive të tyre jo për shkak të humbjes së interesit për zgjedhjet por për shkak se „sistemi,, nuk reflekton interesat e tyre të vërtetë. Ata si gjithandej në botë mendojnë se politikanët nuk i mbajnë premtimet dhënë elektoratit. Pra nëse meret parasyshë e lartë përmendura, mund lirisht të konstatojmë se edhe sistemi dy partiak në SHBA ka dobësitë e veta. Si pikë tjetër e dobët e sistemit partiak amerikan mund lirisht të llogaritet edhe pamundësimi i partive më të vogla të paraqesin konkurrencë në garat zgjedhore në SHBA. Në SHBA, partitë e vogla që tentojnë të paraqesin njëloj alternative ndaj partive dominante paraqiten kohë pas kohe. Ata së paku deri më sot nuk kanë shënuar ndonjë sukses, sidomos partitë e proviencës socialiste dhe komuniste. Megjithatë, vetë fakti i paraqitjes së kohëpaskohëshme të tyre ka një domethënie të caktuar për jetën politike të Shteteve të Bashkuara.

Partitë e vogla shpesh herë paraqesin grupacione politike të cilat ndahen nga dy partitë dominante si grupacione të pakënaqura nga politika momentale e njëres ose tjetres parti.

¹⁰⁴Walter Dean Burnham, Critical Elections and the Mainsprings of American Politics, New York 1970.

Partitë e vogla e kanë shumë të vështirë të mbijetojnë, sepse ashtu si u tha partitë kryesore shpesh adaptojnë platforma të miratuara gjërësisht në popull dhe kësisoji fitojnë shumicën e votuesve. Nuk duhet harruar fakti se dy të tretat e amerikanëve identifikohen si republikan ose demokrat, ndërsa të tjerët janë partiakisht të papërcaktuar ose u takojnë partive të treta.¹⁰⁵

Partia e tretë më e suksesshme vitet e fundit ka qenë Partia Reformatore e Ros Perotit. Peroti si kandidat për president në zgjedhjet e vitit 1992 fitoi 19% të votave popullore, ndërsa kandidati i saj, Xhesi Ventura në vitin 1998 u zgjodh guvernator i shtetit Minesota. Partia Reformatore kishte përkrahjen e centristëve, ithtarëve të dëshpëruar republikan dhe demokrat, fraksionit të djathtë Fulani-Njumen i njohur si marksist-leninist. Partitë e vogla sikurse tregon statistika zyrtare rezultate pak më të mira shënojnë në zgjedhjet e niveleve më të ulta, zgjedhjet shtetërore dhe lokale.

Duke u nisur nga kjo që u tha për partitë e vogla, parashtrohet pyetja e mossuksesit të tyre në zgjedhje e sidomos mossuksesit të partive të proviencës punëtore. Me siguri shkaqet e arsytet janë të shumta.

Për shembull në mossuksesin e partive të proviencës punëtore kanë ndikuar më shumë faktorë por gjithsesi katër-pesë janë më të rëndësishëm. Në shoqërinë e zhvilluar amerikane nuk ekziston një polarizim dhe konfrontim i shprehur social-klasor që do të nxiste lindjen e ndonjë organizate revolucionare. Mobiliteti relativisht i lartë vertikal dhe horizontal, ofron mundësi për përparim pa marrë parasysh prejardhjen shtresore. Sigurimi i të drejtave për të gjithë e pamundëson nevojën për kërkimin e të drejtave të veçanta dhe krijimin e grupeve politike që do ta mundësonin një gjë të tillë.¹⁰⁶

¹⁰⁵. Etem Aziri, Partitë politike Zgjedhjet dhe Sistemet zgjedhore, Tetovë 2015, faqe 86

¹⁰⁶. Etem Aziri, Partitë polike zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore, Tetovë 2015, faqe 87

Megjithatë, mosperspektiva e partive të vogla në përgjithësi kushtëzohet edhe nga shumë faktor të tjerë. Në radhë të parë duhet përmendur aspektin material. Është pothuajse e pamundshme që ndonjëra nga partitë e treta të tubojë para aq sa kanë në disponim partitë kryesore. E dyta, është ndikimi i sistemit zgjedhor të zonave elektorale. Sipas këtij sistemi partisë politike i nevojitet të ketë një votë më tepër nga partitë kundërshtare. E treta, shumica e shteteve kanë ligje me të cilat partive kryesore u mundësohet hyrja e drejtëpërdrejtë në fletëvotime, kurse partive të vogla për ta bërë këtë u kërkohet një numër i madh nënshkrimesh. E katërta është fshehtësi publike se demokratët dhe republikanët, edhe për kundër dallimeve të tyre në organet legjislative të shteteve, çdoherë janë të interesuar për ndarjen e pushtetit në mes tyre, pa e ndarë atë me partnerë të tjerë. E pesta, mediat e shkruara dhe elektronike po ashtu u kushtojnë më shumë vëmendje partive kryesore sesa partive të treta. E gjashta, një numër i konsiderueshëm votuesish, edhe pse fillimisht anojnë nga të pavarurit dhe kandidatët e partive të treta, në zgjedhje votojnë për kandidatët e partive kryesore. Dhe si e fundit kandidatët e partive të treta pësojnë edhe nga paragjykimet e elektoratit se ata " nuk mund të fitojnë" .¹⁰⁷

Partitë politike të Shteteve të Bashkuara janë në masë të madhe organizata të decentralizuara. Ata në fakt më shumë paraqesin lidhje labile të partive të shteteve të veçanta sesa një organizim të vetëm të fuqishëm politik. Ky është edhe një dallim shumë domethënës ndërmjet partive politike Evropiane dhe partive politike në SHBA. Kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se partitë politike në SHBA janë parti pa një organizim politik. Në fakt organizimi i partive politike në SHBA është refleksion i zhvillimit të sistemit politik dhe demokracisë amerikane në përgjithësi.

¹⁰⁷ Zenun Halili, Politika dhe qeverisja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë 2006, faqe 158-159

Edhe në SHBA të dy partitë kryesore i kanë strukturat e tyre në nivel, kombëtar, shtetëror dhe lokal. Duhet veçuar se të gjitha instancat e organizimit të partive kanë trupa dhe organe partiake me kompetenca të caktuara, por mbi të gjitha dhe burime vetanake financiare që mundëson suksese të dy partive kryesore në zgjedhje por dhe në funksionimin e tyre në përgjithësi.

Organet më të larta partiake janë Konventat nacionale, organe glomaze me nga disa mijëra delegatë të zgjedhur nga organizatat partiake të shteteve të veçanta. Konventat tubohen çdo të katërtin vit, para zgjedhjeve kryesore presidenciale. Konventa është organi partiak që e sjell programin dhe platformën e partisë dhe cakton kandidatët e partisë për president dhe zëvendëspresident dy funksione kyç në funksionimin e sistemit politik të SHBA - ve. Konventat përveç që sjellin programet e partive zgjedhin edhe Komitetet nacionale.

Konventat Kombëtare, veç tjerash paraqesin një rast të mirë për tubimin dhe takimin e aktivistëve më të devotshëm të partive nga të gjitha anët e Shteteve të Bashkuara. Pra Konventat partiake janë një rast i mirë që të njoftohen aktivistë dhe funksionarë shtetërorë e partiak me njëri tjetrin, ti ndajnë përvojat e tyre politike aq sa kanë mundësi si dhe të diskutojnë me njëri tjetrin për politikën që duhet ti trasojë partia e tyre në të ardhmen.

Organ me një rëndësi shumë të madhe për funksionimin e partive politike tek partitë në SHBA paraqesin edhe Komitetet Nacionale. Demokratët e formuan Komitetin e tyre nacional në vitin 1848 dhe quhet Komiteti Kombëtar Demokratik (Democratic National Committee- DNC), kurse republikanët e formuan komitetin e tyre kombëtar në vitin 1856 dhe quhet, Komiteti Kombëtar Republikan (Republican National Committee-RNC).

Komitetet Kombëtare udhëheqin me partinë në mes dy Konventave. Në të marrin pjesë nga dy përfaqësues të shteteve të veçanta. Përfaqësimi me nga dy përfaqësues reflekton barazinë ndërmjet organizatave partiake të shteteve të veçanta. Në një farë lloji mënyre është kopjuar parimi që praktikohet me zgjedhjet për Senat si njëra nga dhomat e Kongresit. Qëllimi parësor i komiteteve është organizimi i Konventës Kombëtare dhe kordinimi i aktiviteteve gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet presidenciale. Zyrtari më i lartë, përkatësisht zyrtari kryesor i Komitetit Kombëtar është kryesuesi apo shefi i Komitetit Kombëtar.

Përpos organizimit të partive në nivel kombëtar të SHBA-ve, dy partitë dominante i kanë të shtrira strukturat e tyre partiake në pesëdhjetë shtetet e Unionit përfshirë këtu edhe Distriktin e Kollumbisë. Pra demokratët dhe republikanët në aspektin strukturorë-organizativ janë prezentë në tërë teritorin e shtetit.

Edhe në nivel të shteteve ekzistojnë konventat dhe komitetet qëndrore, ndërsa në nivel të qarqeve veprojnë komitetet e qarqeve. Në nivelet më të ulta veprojnë organizatat rajonale (wards) dhe organizatat partiake lokale (precinct). Organizatat lokale tubojnë deri në njëmijë anëtarë. Disa organizata lokale e formojnë organizatën rajonale. Dy nivelet më të ulta e përbëjnë bazën më të gjërë partiake. Ata në parim veprojnë në baza vullnetare, nuk kanë nevojë për personel dhe seli të përhershme dhe nuk manevrojnë me shuma të mëdha të parave.¹⁰⁸

Kur flitet për bazën e gjërë partiake aludohet në anëtarësinë e partive politike të Shteteve të Bashkuara. Anëtarësia partiake ashtu siç është theksuar në këtë tekst dallon nga anëtarësia partiake që e hasim në shtetet tjera në botë. Në kuptimin e partive amerikane anëtarë partie llogariten votuesit që kanë shprehur dëshirë të votojnë për partinë e caktuar në zgjedhjet e mbyllura primare partiake. Me fjalë tjera statusin e anëtarit të partisë e kanë gjithë qytetarët me të drejtë vote të cilët para zgjedhjeve primare regjistrohen në listat zgjedhore ose deklarojnë me një deklaratë të veçantë për gadishmërinë e tyre t'i bashkangjiten partisë së caktuar politike. Domethënë në zgjedhjet e mbyllura primare, kërkohet nga votuesit që para zgjedhjeve të regjistrohen në listat zgjedhore të partisë së caktuar ose të deklarojnë se do të fitojnë për kandidatët e saj, përkatësisht se do ta mbështesin politikën partiake.¹⁰⁹

^{108.} Etem Aziri, Partitë politike, Zgjedhjet dhe Sistemet zgjedhore, Tetovë 2015, faqe 89

^{109.} Etem Aziri, Sistemet Politike, Tetovë 2012, faqe 228

4. Koncepti dhe vendi i grupeve të interesit në sistemin politik të SHBA-ve

Në pjesën ku folëm për për rolin shoqërorë të partive politike në SHBA, vumë në dije se qëllimi i ekzistimit dhe funksionimit të tyre para së gjithash është marrja e pushtetit politik, ushtrimi dhe ndikimi në pushtet, respektivisht, ndarja dhe ushtrimi i pushtetit politik. Megjithatë, duhet sqaruar se partitë politike nuk janë të vetmet grupe shoqërore të organizuara që e kanë për qëllim pushtetin politik, pa marrë parasyshë a angazhohen për marrjen dhe ushtrimin e pushtetit shtetërorë ose për të ushtruar ndikim mbi atë. Pra, ekzistojnë edhe grupe tjera shoqërore që ushtrojnë ndikim në sfera të caktuara të jetës shoqërore, e sidomos në sferën politike. Ato janë në radhë të parë grupet e interesit. Shpeshherë në praktikën politike vjen deri te gërshetimi i interesave ndërmjet partive politike dhe grupeve të interesit që vetvetiu shtron nevojën e një elaborimi teorik të gjithë asaj që është e përbashkët për partitë politike dhe grupet e interesit, por normalisht edhe asaj që është e veçantë ose, thënë më mirë të sqarohet fushëveprimi i partive politike dhe i grupeve të interesit aq sa është e mundshme. Qysh në fillim dua të kostatoj se në aspektin teorik është shumë më lehtë të bëhet një përkufizim i veprimit të partive politike dhe grupeve të interesit, ndërsa gjatë veprimit praktik është vështirë të vihet një kufi i qartë i veprimit të tyre. Kjo vlenë për të gjitha shoqëritë demokratike përfshirë edhe shoqërinë amerikane.

Megjithatë duhet thënë prerazi se në sistemin politik të SHBA-ve janë ndërtuar disa raporte ndërmjet partive politike dhe grupeve të interesit të cilat dallojnë nga vendet tjera të botës. Të gjitha studimet flasin qartë se në sistemin politik amerikan, grupet e interesit kanë një hapësirë më të gjërë manevruese. Kjo i përshkruhet faktit se partitë politike në SHBA kanë një strukturë organizative më fleksibile krahasuar me partitë politike evropiane. Hapësira manevruese që nuk mbulohet, ose nuk mbulohet aq sa duhet nga partitë politike paraqet sferë të një ndikimi shumë të shprehur të grupeve të interesit.

Andaj për t'i kuptuar më mirë relacionet ndërmjet partive politike dhe grupeve të interesit në sistemin politik të SHBA-ve nuk është edhe aq lehtë sidoemos për hulumtuesit që nuk jetojnë dhe nuk veprojnë në këtë shtet. Si do qoftë ekzistojnë edhe disa karakteristika të përgjithshme,

karakteristika dalluese për funksionimin e partive politike dhe grupeve të interesit gjithandej në botë.

Pjesa më e madhe e hulumtuesve të partive politike dhe grupeve të interesit janë të mendimit se dallimi kryesor midis tyre qëndron në atë se qëllimi kryesor i partive politike për të cilin ato fuqishëm luftojnë, është marrja e pushtetit politik nën kontrollin e tyre. Përkundrazi, grupet e interesit së paku derisa veprojnë si të atilla, nuk janë të interesuara, respektivisht ato nuk angazhohen në drejtim të marrjes dhe ushtrimit të pushtetit shtetëror, por vetëm dëshirojnë të ushtrojnë ndikim në pushtetin politik ose në organet e caktuara shtetërore. Partitë politike edhe formalisht bëjnë emërimin e kandidatëve për funksionet politike, që më vonë, pas fitores eventuale, nëpërmjet tyre të mund ta ushtrojnë ndikimin e vet në qeveri dhe në institucionet tjera shtetërore. Prandaj partitë politike gjatë zgjedhjeve janë të mobilizuara dhe angazhohen të sigurojnë fitore për kandidatët e vet. Përkundrazi, grupet e interesit asnjëherë para zgjedhësve nuk dalin me kandidatë, por në praktikë shpeshherë personat që bëhen bartës të funksioneve politike janë ngushtë të lidhur me ndonjë grup interesi, që në këtë ose atë mënyrë e ka ndihmuar fitoren e kandidatit bartës të funksionit të caktuar. Kjo ndodh kështu sidomos nëse merret parasysh fakti se grupet e interesit nuk janë dhe nuk mund të jenë indiferente gjatë procesit zgjedhor. Përkundrazi, në qoftë se nisemi nga ajo se ato formohen me të vetmin qëllim që të ushtrojnë ndikim në pushtetin politik, është e logjikshme që gjatë zgjedhjeve ta ndihmojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë fitoren e kandidatit, që sipas analizave të grupit të interesit do të jetë më i përshtatshëm për bashkëpunimin eventual të mëtejshëm.¹¹⁰

Edhe pse grupet e interesit nuk e kanë për qëllim marrjen dhe ushtrimin e pushtetit politik, ato megjithatë janë element konstituiv i politikës, respektivisht sistemit politik, sepse politika e

¹¹⁰ Etem Aziri, Partitë politike Zgjedhjet dhe Sistemet zgjedhore, Tetovë 2015, faqe 203

qeverisë nuk është asgjë tjetër veçse “rezultantë” e veprimit të interesave të ndryshme dhe grupeve të interesit. Do të kishte qenë gabim të thuhet, ashtu siç thonë disa autorë se partitë politike i prezantojnë “interesat e përgjithshme shoqërore” ose “interesin e përgjithshëm kombëtar”, ndërsa grupet e interesit “interesat e ngushta të veçanta” etj. Grupet e interesit medoemos duhet të mbajnë llogari për interesat e përgjithshme, për interesat e sistemit politik, në qoftë se dëshirojnë të realizojnë disa qëllime dhe kërkesa të veta.

Përndryshe, grupet e interesit llogariten si zbulim i shkencës politike amerikane të shekullit njëzet, prej kur edhe janë bërë objekt hulumtimi i sociologjisë dhe politologjisë. Studimi sistemor i grupeve të interesit fillon me Artur Bentlin (Arthur F Bently) dhe veprën e tij “Procesi i Qeverisjes” (The process of Government) të botuar në vitin 1908. Prej dhjetëvjeçarit të tretë të shekullit njëzet me hulumtimin e grupeve të interesit të frymëzuar nga vetë Bentli, fillojnë të merren edhe shumë autorë tjerë në SHBA dhe shtetet e Evropës Perëndimore siç janë: Petar Edegardi, Pendellton Hering, David Truman, Earl Lathan, Herman Zengler, Mancur Olson e shumë të tjerë. Sot është thuajse e pamundur, sidomos në sociologjinë dhe politologjinë amerikane, të gjendet ndonjë autor që e nënvlerëson ose e shpërfill rolin dhe rëndësinë e grupeve të interesit. Grupet e interesit nuk e kanë po të njëjtën peshë dhe po të njëjtën hapësirë veprimi në të gjitha sistemet politike. Fushëveprimi i tyre është i kushtëzuar prej shumë faktorëve dhe rrethanave konkrete. Ashtu siç konstatuam, vetë struktura organizative e partive në SHBA dhe veprimi politik i tyre, sidomos jashtë institucionit të Kongresit dhe organeve më të larta shtetërore krijon një hapësirë të gjerë për veprimin e grupeve të interesit që nuk mund të ndodhë në shtetet e Evropës Perëndimore. Kjo assesi nuk do të thotë se në sistemet tjera politike grupet e interesit nuk gjejnë hapësirë manovruese, aq më shumë në qoftë se e marrim parasysh faktin se numri i grupeve të interesit të cilat sot veprojnë në sistemet e ndryshme politike është shumë i madh, ndërsa aspekti organizativ dhe qëllimet që synojnë t’i realizojnë janë të llojllojshme.¹¹²

¹¹² Etem Aziri, Partitë politike Zgjedhjet dhe Sistemet zgjedhore, Tetovë 2015, faqe 205

Edhe pse grupet e interesit në mënyrë sistematike studiohen prej fillimit të shekullit njëzet e këtej, ato janë të vjetra aq sa është i vjetër mendimi njerëzor për politikën dhe shoqërinë. Autorët amerikanë thonë se ato u paraqitën në truallin amerikan me lindjen e SHBA-ve, ndërsa autorët tjerë paraqitjen e grupeve të interesit e lidhin me ndarjen e shoqërisë në klasa dhe formimin e shtetit. Megjithatë, duhet të përmendet se gjatë zhvillimit të shoqërive moderne, teoritë për grupet e interesit kanë përjetuar evoluim i cili njëlloj si teoritë mbi partitë politike ka shkuar nga theksimi i anëve negative të grupeve të interesit drejt afirmimit të asaj që është pozitive te ato. Kështu, një kategori e teoricienëve mbrojnë qëndrimin se motivet dhe aktiviteti i grupeve të interesit janë të dëmshëm për sistemin në tërësi nga shkakut se ato, duke u angazhuar për interesa të veçanta e jo për ato të përgjithshme, krijojnë distanca dhe e bëjnë të pakapshme politikën për vullnetin e popullit, pra, krijojnë situata që vullneti i masave të mos gjejë shprehje në politikë. Kështu, kjo kategori e autorëve e përmend veprimin e grupeve të interesit jashtë sferës formale të veprimit, me ç'rast shpeshherë nëpërmjet kërcënimeve ia arrijnë qëllimit t'i detyrojnë organet shtetërore të marrin vendime në dobi të grupit të interesit, përmendin se ndryshe nga partitë politike grupet e interesit nuk mbajnë përgjegjësi për vendimet që merren nën ndikimin e tyre dhe se qytetarët asnjëherë nuk kanë mundësi të deklarohen në lidhje me veprimin e grupeve të interesit. Grupi tjetër i autorëve thotë se grupet e interesit janë të domosdoshme dhe të dobishme, sepse me ndihmën e tyre interesat dhe mendimet e ndryshme në shoqëri transformohen në të ashtuquajturën “politikë reprezentative”. Kësisoj mendojnë sidomos studiuesit e grupeve të interesit në SHBA. Kohëve të fundit me të madhe mbrohet qëndrimi se grupet e interesit formohen me qëllim të plotësimit të zbrazëtirave që paraqiten brenda sistemeve politike. Në këtë kontekst theksohet se grupet e interesit i artikullojnë interesat e ndryshme shoqëror, sidomos ato interesa që nuk i artikullojnë partitë politike; e bëjnë informimin e plotë të opinionit publik për kërkesat dhe problemet me të cilat ballafaqohen përkrahësit dhe anëtarët e grupit, me faktin se grupet e interesit paraqesin lidhjen ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë në periudhën e zgjedhjeve parlamentare.¹¹³

¹¹³Vlladimir Goati, *Politika Sociologjia*, Beograd 1984, faqe 121-122.

Që në fillim duhet konstatuar se të gjitha vendimet politike, por dhe vendime të tjera domethënëse për funksionimin e mëtutjeshëm të sistemit politik të SHBA-ve janë mjaft komplekse dhe zhvillohen në varshmëri nga rrethanat shoqërore. Në proceset vendimmarrëse zakonishtë gërshetohen faktorët institucional dhe ata personal. Në fakt vendimet përfundimtare në princip janë si rrjedhojë e strukturave të gërshetuara: maqinerisë institucionale të pushtetit, partive politike dhe grupeve të ndryshme të interesit.¹¹⁴ Meqë partitë politike jashtë institucioneve të Kongresit dhe Presidencës kanë relativisht pak ndikim në formësimin e politikave, hapësirën e krijuar e plotësojnë grupet e interesit me strukturat e tyre komplekse.

Ashtu siç përmendëm grupet e interesit janë të vjetra aq sa është edhe mendimi mbi shoqërinë, por si faktor i rëndësishëm i së vërtetës shoqërore dhe politike bëhen me paraqitjen e shtetit si institucion mbi institucionet, e sidomos me zhvillimin e shteteve moderne. Konkretisht sa u përket SHBA-ve paraqitja e grupeve të interesit ndërlidhet me formimin e shtetit amerikan. Në shoqërinë amerikane grupet e interesit luanin një rol të rëndësishëm edhe para paraqitjes së partive politike. Për hirë të së vërtetës duhet potencuar faktin se dy partitë dominante në SHBA, Partia Republikane dhe Partia Demokratike lindën si rrjedhojë e konflikteve ndërmjet grupeve të interesit që u paraqitën menjëherë pas mbajtjes së Kuvendit kushtetues. Është fjala për federalistët dhe anti federalistët si dy grupacione me ambicie të qarta politike.

Teoritë e para mbi grupet e interesit në shoqërinë amerikane u paraqitën pas shpalljes së pavarësisë të 13 kolonive britanike në kontinentin amerikan dhe gjatë luftës politike për sjelljen e kushtetutës së re dhe lidhen me emrin e Xhejms Medisonit (James Madison), njërit nga autorët kryesorë të pamfleteve të federalistit (The Federalist Papers) të shkruara si ndihmesë ratifikimit të Kushtetutës.

¹¹⁴. M.J.C.Vile, politics in dhe U.S.A. ,Londër,1976, faqe 123

Patjetër të thuhet edhe ajo se edhe në sistemin politik të SHBA-ve grupet e interesit kanë rrugëtuar një rrugë të gjatë duke insistuar në përshtatshmëri të kushteve bashkëkohore. Andaj duhet kuptuar drejtë ndrrimi i qëndrimeve ndaj grupeve të interesit, sidoemos nga mesi i shekullit të 20 kur filluan të zhvillohen debate të gjëra për rolin dhe metodat e veprimit të grupeve të interesit në shoqërinë bashkëkohore amerikane.

Në teorinë politike amerikane është mjaft i gjërë botëkuptimi se Medisoni është ndër të parët që konstatoi dhe potencoi lidhjen që eksistonte në mes grupeve të interesit dhe politikës amerikane. Ai në The Federalist Papers të vitit 1788 debatonte për rëndësinë e grupeve të interesit në politikë dhe shoqëri. Medison grupet e interesit i pagëzoi si fraksione dhe nuk kishte qëndrim pozitiv ndaj tyre. Ai vlersonte se fraksionet, gjegjësisht grupet e interesit veprojnë kundra të drejtave të bashkësive tjera si tërësi. Në fakt Medisoni i trajtonte si të rrezikshme dhe të dëmshme për rendin shoqërorë në përgjithësi, i trajtonte si vetjake dhe në kundërshtim me nevojat objektive të shoqërisë. Medisoni afirmonte idenë se ideve të një fraksioni do ti kundërvihet një fraksion tjetër. Ai në fakt angazhohej për ndërprerjen e veprimit të fraksioneve. Idetë e tij ndërtuan konceptin politik të njohur si the checks and balances, kufizimit dhe ballansimit, koncept i cili siguroi aspektin e tij formalo-juridik në strukturën e qeverisë amerikane. Të sqarojmë edhe atë se me qeveri në kuptimin amerikan të fjalës nënkuptohet tërësia e komponuar nga trupi ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësorë. Reth vitit 1840 disa qëndrime të Medisonit në lidhje me veprimin e grupeve të interesit në shoqërinë amerikane do ti avansojë Jons c.Calhoun. Ai duke e studiuar qeverinë amerikane e zhvilloi teorinë e „konkurrencës së shumicës,, (concurrent majority theory) sipas së cilës secila grup me relevancë mundet të vë veto (të ashtuquajtur veto negative) ndaj masave të caktuara politike nëse vlerëson se masat e tilla e kercënojnë. Për dallim nga Medisoni mendonte se grupet e interesit e bëjnë shoqërinë më vitale për të gjithë kombin.

Ashtu siç përmendëm sa më lartë studimi i mirëfilltë i grupeve të interesit në SHBA do të pasojë pas publikimit të veprës The Proces of Government të autorit Arthur F.Bentley. Bentley në veprën në fjalë nuk debaton vetëm për ndikimin e grupeve të interesit në politikë, por tërë politikën amerikane e sqaron përmes veprimit të grupeve politike. Në analizat e tij Bentley tenton të

zbulojë atë që ndodh prapa strukturave legale, koncepcioneve dhe institucioneve juridike. Në faktë ai tenton të prezanton përbërjen e vërtetë të politikës shquar si proces në të cilën ndeshen dhe luftojnë interesa heterogjene shoqërore. Megjithatë patjetër të thuhet edhe ajo se Bentli nuk i analizon grupet e interesit nga një aspekt më të gjërë, si ata ushtrojnë ndikim në jetën sociale në përgjithësi. Ai fokusohet vetëm në proceset politike dhe në grupet politike. Sistemin politik e trajton si proces politik në të cilin ballafaqohen dhe kundërshtohen grupe të ndryshme me interesa partikulare. Sipas Artur Bentlit qeveria dhe politika janë rezultat i interakcioneve të grupeve të interesit brenda qeverisë dhe jashta saj ndërsa shoqëria nuk është asgjë tjetër përveç se një kompleks i grupeve që e përbëjnë atë. Një qasje e këtillë e studimit të fenomeneve politike paraqiste risi por edhe një realitet të ri të shprehur përmes një filozofie më ndryshe. Shekulli i 20 nënkuptonte shumë ndryshime në shoqërinë amerikane. Shtetet e Bashkuara bënë një lëvizje shumë revolucionare në zhvillimin e tyre. Ata kaluan prej një shteti bujqësor patriarkal të ish kolonive britanike në kontinentin amerikan në një shtet industrialisht të zhvilluar me tendencë të shëndrrimit në një superfuqi politike, ekonomike e ushtarake. Në rrethana të atilla ndryshoi roli dhe koncepti i shtetit. Shteti në vend që vetëm ta ruante rendin ekzistues juridik, mori edhe shumë funksione plotësuese në kuptimin e integritetit të ekonomisë me lëmit tjera të jetës shoqërore. Në shkencën mbi politikën u braktis detyrimshtë qasja legalo institucionale e të studiuarit të fenomeneve politike dhe gjithnjë e më shumë vëmendje do ti kushtohet hulumtimit të aktiviteteve njerëzore dhe forcave të njëmendëta të proceseve politike, forcave që i lëvizin proceset politike.

Një kontribut jashtëzakonisht të madh për teorinë moderne të grupeve të interesit ka dhënë edhe profesori David Truman në veprën *The Governmental Process* (proceset e qeverisjes) të botuar më vitin 1951. Në pjesën hyrëse të librit Trumani potencon rolin politik të grupeve të interesit, funksionin e tyre dhe mënyrën si ata e shfrytëzojnë pushtetin, me qëllim të kuptohet mirëfillazi natyra e proceseve politike.¹¹⁵

¹¹⁵.David B.Truman,*The Governmental Process, Political Interests and Public Opinion*, New York,1962, faqe VII.

Tezë bazike e Trumanit është se çdo shoqëri është e përbërë nga grupet, gjegjësisht se çdo shoqëri paraqet një mozaik të grupeve me specializime të ndryshme. Truman nënvizon se në momentin kur grupi paraqet kërkesa në institucionet e sistemit shndërohet nga grup interesi në grup politik interesi.

Pas daljes në opinion të veprës së Trumanit, mes viteve 1950-1960 një grup shkencëtarësh do të orvaten ti nxjerin në pah anët pozitive të veprimit të grupeve të interesit në sistemin politik të SHBA-ve. Anët pozitive të grupeve të interesit i potencojnë tre autorë: Lazarsfeld, Berelson dhe McPhee të cilët merreshin në princip me sjelljet e votuesve amerikan gjatë procesit zgjedhor. Ata afirmojnë idenë se participimi politik i zgjedhësve që bëhet me ndërmjetësim të grupeve të interesit kontribon në stabilitetin dhe kontinuitetin e sistemit politik. Nga ana tjetër Gabriel Almond dhe Sidney Verba potencojnë rolin pozitiv të grupeve të interesit në ndërtimin e kulturës politike demokratike. Anëtari i organizuar krahasuar me anëtarët e paorganizuar në grupe interesi sipas autorëve në fjalë e llogarisin veten më të aftë, janë më pjesëmarrës në jetën politike dhe mbajnë më shumë llogari për politikën.

Kur flasim për grupet e interesit në sistemin politik të SHBA-ve në asnjë mënyrë nuk mundemi të mos themi disa fjalë për veprën *The Power Elite* (Elita e Pushtetit) të sociologut me famë botërore C.Wright Mills. Mills në mënyrë shumë piktoreske sqaron veprimin e elitave të ngushta të individëve mes të cilëve ka një lidhshmëri të madhe në aspektin e prejardhjes së tyre sociale dhe arsimimit. Në fakt Mills sqaron dominancën e atyre elitave në jetën ekonomike, politike dhe ushtarake të SHBA-ve. Rëndësia e veçantë e veprës së Millsit qëndron në kritikën që ia bëri ai „teorisë së ekuilibrit“, dhe ndikimit të saj në shoqëri. Sipas teorisë së ekuilibrit shteti paraqet një farë mekanizmi automatik në të cilin ndikon ekuilibrimi i interesave konkurrues. Ballansimi në sferën politike realizohet automatikisht, përmes ballansimit dhe pajtueshmërisë të preokupimeve dhe interesave. Idetë e ballansimit automatik i kanë rrënjët në konceptet ekonomiko-politike të shekullit të 18-të sipas së cilave tregu është sovran dhe ekonomia e tregëtarëve të imtë nuk ka nevojë për kurfarë qendre autoritative. Mills erdhi në konstatim se po të eksistojë një ballansim i ndikimit në shoqëri, atëherë asnjë grupacion nuk do të kishte fuqi që vullnetin e tij të imponon të tjerëve. Pra, ballansimi i forcave do të kishte

nënkuptua barazi të forcave. Megjithatë Millsi konstaton se diçka e atillë nuk ndodh në sistemin politik të SHBA-ve. Grupet sunduese shpesh herë janë të prirura që një gjendje ta shpallin si të drejtë në kuptimin e ballansimit të pushtetit ku ekziston një harmonizim i interesave sepse ju konvenon dominanca e tyre të mbetet e përhershme dhe e pa shqetësuar.¹¹⁶ Millsi vlerëson se shoqëria bashkëkohore amerikane në deceniet e fundit të shekullit 20 ka një organizim të atillë politik në të cilin ballansimi i ndarjes së pushteteve është çrregulluar duke marrë primatin ekzekutivi falë mekanizmave që i ka në dispozicion. Epërsia e ekzekutivit vërehet sidoemos gjatë sjelljes së vendimeve të mëdha politike. Sipas tij fuqia e ligjvënësit është lëshuar në një mesatare, çka do të thotë se është dobësuar ndikimi i politikanëve profesional, sepse sfera kryesore e veprimit të politikanëve partiak është organi ligjvënës.¹¹⁷ Mills gjithashtu mendon se në periudhën në fjalë ndikimi i klasës së mesme që dikur ishte faktorë i rëndësishëm politik është dobësuar dukshëm dhe kjo klasë në fakt është bërë e varur në aspektin politik dhe ekonomik nga korporatat e mëdha. E njëjta gjë sipas Millsit vlen edhe për shtresën e farmerëve. Farmerët e organizuar gjatë kohë paraqisnin grupacion të fuqishëm që kishte ndikim të madh politik. Në periudhën në fjalë ndikimi i tyre vjen në shprehje sidoemos kur janë në pyetje vendimet e mëdha politike me karakter nacional dhe ndërkombëtarë. E njëjta gjë ndodhë edhe me sindikatat e punëtorëve të cilat sipas Millsit gjithashtu varen nga sistemi shtetërorë.

Në shoqërinë amerikane qëndrim kritik ndaj grupeve të interesit kishte edhe hulumtuesi mjaft i afirmuar i grupeve të interesit Robert Paull Wollf. Ai tërhoqte vërejtjen se politika e grupeve të interesit e kufizon interesin e përgjithëshëm, pra interesin nacional e shëndrron në interes personal të klasave të larta. Theodore Lowi bënte të qartë se qeveria nga njëra anë në vazhdimësi e zgjeron rolin e saj në shoqëri ndërsa nga ana tjetër në të njëjtën kohë braktis pushtetin në dobi të grupeve private.

¹¹⁶Wright C.Mills, The Power Elite, New York, 1959, faqe 321

¹¹⁷Vepra e cituar faqe 336

E gjithë kjo ka si pasojë humbjen e legjitimitetit dhe mosuksese në politikë si dhe paraqitjen e korrupsionit në qeverinë moderne demokratike.¹¹⁸ Nga kjo që u tha bëhet e qartë se hulumtuesit e grupeve të interesit në SHBA nuk kanë qëndrim unik në lidhje me rëndësinë dhe rolin e grupeve të interesit në sistemin politik të SHBA-ve por dhe të shoqërisë amerikane në përgjithësi. Disa mbrojnë qëndrimin se motivet dhe aktiviteti i grupeve të interesit janë të dëmshëm për sistemin politik në përgjithësi sepse ata duke i shprehur interesat e veçanta e jo interesat e përgjithëshme e distancojnë politikën nga vullneti i popullit. Të tjerët thonë se grupet e interesit janë të domosdoshme dhe të dobishme sepse përmes tyre interesat e ndryshme në shoqëri transferohen në të ashtuquajturën politikë reprezentative. Prej paraqitjes të konceptioneve të para mbi grupet e interesit e deri më sot, grupet e interesit në SHBA kanë përjetuar një zhvillim të madh të përcjellur me ndryshime të mëdha. Rreth vitit 1970 u paraqitën edhe grupe të atilla të cilat gjithmonë e më shumë angazhoheshin për të ashtuquajturin „interes publik,, të cilat tentojnë të prezantohen si prezantuese të shoqërisë në tërësi duke i anashkaluar interesat materiale dhe interesat e veçanta. Si grupe të tilla janë: Consumer Groups, Environmental Groups, Common Cause, Ralph Naders Public Citizen etj. Kur janë në pyetje grupet e interesit në sistemin politik të SHBA-ve duhet potencuar se shpesh herë në opinion parashtrohej pyetja dhe debatohej për atë mos është vallë pak i mbi theksuar vendi i grupeve të interesit brenda sistemit politik dhe cili duhet të jetë kuptimi dhe funksioni i tyre. Në këtë kuptim potencohen disa arsyeshmëri pro ekzistimit dhe rolit të grupeve të interesit në sistemin politik të vendit. E para, sistemi amerikan i qeverisjes është intencionalishtë dhe realishtë multigruporë dhe nuk duhet të habisë numri i madh dhe aktiviteti i grupeve të interesit. E dyta, numri i madh i qendrave të vendosjes dhe qasja e lirë ndaj qendrave në fjalë në mënyrë stimulative ndikon në formimin e shumë grupeve dhe aktivitetin e tyre. E treta, karakteri labil dhe fluid i partive politike. Ata nuk mund ti kënaqin nevojat e grupacioneve të shumëta shoqërore përmes një artikulimi të mirëfilltë politik përmes një pjesëmarrjeje në proceset e vendimarrjes politike.

¹¹⁸Theodore Lowi, The End of Liberalism, New York, 1969, faqe 287

Si e katërta, duhet të meret parasyshë struktura difuzive ligjvënëse dhe ekzekutive me një numër të madh të organeve të specializuara të krijuara enkas për rregullimin e çështjeve parciale të cilat janë me rëndësi të veçantë për grupe të caktuara. Pra, këtu duhet të merret parasysh fakti se puna e organeve në fjalë, sidoemos këshillave dhe komisioneve mundëson kontakte të shpeshta dhe ndikim aktiv të grupeve të interesit në punën e tyre. Dhe e pesta, funksionet e shumëta zgjedhore, gjegjësishtë vendvotimet janë stimulues për një veprim mjaftë aktiv të grupeve të interesit. Shiquar në përgjithësi shumë autorë potencojnë faktin se një sistem i këtillë është demokratik dhe efikas në rregullimin e shoqërisë në të cilën nuk ekzistojnë konflikte të ashpërta. Në shoqërinë amerikane pa dyshim themelet e polarizimit dhe bashkëpunimit tolloviden dhe ndryshojnë andaj linjat e ndasive nuk janë fikse dhe të përherëshme. Personat me status të ndryshëm social munden ti takojnë po të njëjtës parti, sikurse edhe ata që u takojnë partive të ndryshme mund ti takojnë po të njëjtës grupë religjioze ose po të njëjtës grupë interesi, në ç’rast kryqëzohen linjat e ndasive dhe ëmbëlsohet fuqia ndarëse dhe polarizimi.¹¹⁹ Kjo që u tha, pa marrë parasyshë sa qëndron përsëri nuk mjafton për të dhënë një arsyeshmëri të plotë për ekzistimin dhe veprimin e grupeve të interesit në shoqërinë amerikane.

Hulumtimet e kohëve të fundit të cilat janë në kuptimin cilësorë shumë më të plota flasin në drejtim të asaj se pluralizmi i interesave grimore me rrjetin e vetë lobistikë nuk është prodhim stihik dhe i pa planifikuar i zhvillimit demokratik amerikan dhe shpirtit demokratik të Amerikanëve, por pjesa më e madhe e tij paraqet kornizë mirë të kalkuluar dhe të planifikuar që mundëson vazhdim jetësinë e strukturës ekzistuese dominante. Pra është fjala për një fenomen sui generis, për një instrumentarium të ndërlikuar dhe subtil i cili është i aftë nga njëra anë ta ec përpara zhvillimin shoqërorë ekonomik ndërsa nga ana tjetër i përshtatshëm që përmes tij forcat shoqërore sunduese, para së gjithashë qarqet e fuqishme ekonomike të sigurojnë kontrollin ndaj pushtetit politik dhe proceseve të vendimarrjes politike.

¹¹⁹R.Dahl, Pluralist Democracy in the United States, Chicago,1967, faqe 338-339

Dominimi i qarqeve të caktuara dhe interesave parcialesh përmes këtij mekanizmi të interesit grupor është aq e dukshme sa që ka filluar tju pengon jo vetëm kërkesave të përgjithëshme demokratike dhe interesave të shtresave të ulta, të cilat nuk kanë ndonjë ndikim të veçantë në politikat grupore, por edhe pjesëve të aparatit shtetërorë të cilët mendojnë se me një veprim të atillë të grupeve të interesit rrezikohet jo vetëm interesi i përgjithëshëm shoqërorë por edhe interesi global ose interesi integral i qarqeve sunduese.

Sikurse duket dinamika e këtillë e interesave grupore nuk ofron mundësi të njëjta për të gjitha grupet ose për të gjitha shtresat. Kjo formë e veprimit të grupeve në qoftë se nuk paraqet formë të dominimit të shtresave me më shumë pushtet, shtresave më të fuqishme, atëherë paraqet formë të jetës politike që është nën kontrollin e atyre shtresave apo grupeve. Në një sistem të atillë një pjesë e madhe e popullatës është e çkyçur nga participimi efektiv në proceset politike.¹²⁰ Pra, nga kjo që u tha bëhet e qartë se veprimi i grupeve të interesit në sistemin politik të SHBA-ve paraqet është mjaft kompleks, por edhe funksional. Është vështirë të supozohet si do të ishte dukur sistemi amerikan i qeverisjes pa grupet e interesit.

Grupet e interesit në SHBA kanë udhëheqësi dhe lider formal. Udhëheqësia rregullisht e informon anëtarësinë e vetë për punën e grupit në mbledhje ose përmes formave tjera siç janë, pamfletat e grupit posta telefonike dhe telefoni. Lideri i grupit vepron me sistemin e një zëdhënësi të grupit duke tentuar çdo herë të bën përshtypje sa më të mirë në media në lidhje me aktivitetin e grupit që e përfaqëson. Liderët zakonisht angazhojnë njerëz shumë të aftë për të kontaktuar me qendrat e pushtetit politik, planifikojnë taktikë grupore, bëjnë strategjinë e grupit, tubojnë të mira materiale për nevojat e organizatës etj etj. Aktiviteti i grupeve të interesit në SHBA është pjesërisht i rregulluar me ligj. Ligji mbi lobim i vitit 1946 qartë thotë se çdo lobist patjetër të regjistrohet te nënpunësi i caktuar në Dhomën e Përfaqësuesve dhe sekretari i Senatit. Megjithatë mënyra e veprimit të grupeve të interesit edhe më tutje duhet rregulluar me norma më të qarta juridike sepse në praktikën e veprimit të grupeve të interesit paraqiten shumë zbrazëtira.

¹²⁰ G. McConnell, Private Power and American Democracy faqe 34

5. Raportet ndërmjet grupeve të interesit dhe partive politike

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është krijuar përshtypje se të gjitha vendimet në ekzekutiv, pushtetin ligjvënës ose gjyqësi (pa marrë parasysh punës së këshillave dhe organeve tjera të institucioneve në fjalë) janë si rezultat i veprimit të grupeve dhe konflikteve të interesave të tyre. Në vazhdim të punimit do të mundohemi të sqarojmë pse mbretëron një bindje e këtillë. Për ta kuptuar më mirë fenomenin e veprimit të grupeve të interesit patjetër të nisemi nga ajo se çka në fakt duhet të kuptojmë me grupet e interesit, çfarë janë ata?! Grupet e interesit paraqesin grupim të individëve të lidhur mes veti me interes të njejtë ose të ngjajshëm që tentojnë ta realizojnë. Përderi sa ata bashkërishtë veprojnë në sferën politike, në sferën autoritative të sjelljes së vendimeve, për të realizuar dhe mrojtur atë interes ata i marrin karakteristikat e grupeve politike të interesit. Këta grupe në princip në të gjitha sistemet politike e sidoemos në sistemin amerikan i realizojnë interesat e tyre përmes një ndikimi të drejtpërdrejtë, nga një herë duke bërë edhe presion në institucionet e sistemit. Ndikimi i tyre vërehet në sjelljen e ndonjë ligji, vendimi politik dhe gjëra të ngjajshme. Në SHBA më të fuqishme janë grupet që ushtrojnë ndikim në qendrat e vendimmarrjes politike dhe shoqërore ose rreth tyre. Jo rastësishtë në literaturën shkencore amerikane shpesh herë për grupet e interesit përdoret termi grupe për presion (pressure groups). Shumica e autorëve amerikan as që bën ndonjë dallim mes këtyre dy terme. Termin grup për presion e hasim në shkencën politikologjike amerikane nga decenia e dytë e shekullit të 20 e këndej. Disa autorë amerikan prej fillimi e kontestonin, gjegjësishtë nuk e parapëlqenin termin grup për presion. Kështu për shembull David Trumani thoshte se termi grup për presion nënkupton „insistim egoist dhe të pa përgjegjshëm për realizim të privilegjeve të veçanta,.. Pra sipas tij termi grup për presion asocion në gënjeshtër dhe keqpërdorime politike.

Në kushtet amerikane të ndarjes së pushtetit dhe në kushte të një roli lart poshtë të zbehtë të partive politike, grupet e interesit e zgjerojnë gjithmonë e më shumë hapsirën e ndikimit dhe bëhen shumë të rëndësishme për funksionimin e sistemit politik në përgjithësi. Ndarja e

pushtetit në nivel federativ, në nivel të njësive federale dhe në nivel lokal ofron mundësi të gjëra për ndikim dhe veprim të grupeve të interesit në politikat e sistemit të pushtetit. Një gjë të atillë e mundëson para se gjithashë forma e organizimit të Kongresit amerikan, i cili paraqet një trup mjaftë të decentralizuar. Për ti zhvilluar aktivitetet një organ i këtillë brenda për brenda tij ashtu siç kemi konstatuar veprojnë një numër i madh i këshillave dhe nën këshillave të përherëshëm dhe të përkohëshëm që kanë rëndësi të madhe në sjelljen e ligjeve dhe vendimeve tjera të rëndësishme. Shkalla e lartë e disperzimit të pushtetit në Kongres krijon një fushë të gjërë të veprimit të grupeve të interesit. Grupet e interesit mirë të organizuara shpesh herë parandalojnë, gjegjësisht nuk mundësojnë sjelljen e ndonjë ligji që e konsiderojnë të dëmshëm. Nënkuptohet të gjithë këte e bëjnë përmes ndikimit ndaj anëtarëve të Kongresit.

Rrugët e ndikimit të grupeve politike të interesit janë të ndryshme, ndërsa ashtu siç thamë aktivitetin e tyre dukshëm e lehtëson edhe disiplina e dobët partiake, e cila është e atillë sepse brenda po të njëjtës parti politike veprojnë më tepër grupe me interesa heterogjene. Sa do të jenë të suksesshme grupet politike të interesit, gjegjësisht sa do të jetë i gjërë veprimi i tyre në institucionet e sistemit e sidoemos në pushtetin ligjvënës varet nga më shumë faktorë e në radhë të parë nga: pozita e grupit, organizimi i saj, udhëheqësia dhe baza sociale.

Grupet politike të interesit në sistemin politik të SHBA-ve mund të jenë të përkohëshme dhe të përherëshme varësisht nga synimet që i kanë. Për ti arritë qëllimet e paramenduara, për ti ruajtur pozicionet e krijuara dhe për të ndërtuar pozicione ende më të avansuara grupet politike të interesit një rëndësi të veçantë i kushtojnë stabilitetit, homogjenitetit dhe kompetencës si elemente të pa tjetërsueshme në realizimin e interesave politike.

Në sistemin politik të SHBA-ve vepron një numër enorm i grupeve të interesit. Ndikimi i tyre është i lloj llojshëm, duke filluar prej ndikimeve shumë të sofistikuara e deri te ndikimet me nivel shumë të lartë të vrazhdësisë. Të gjitha grupet politike të interesit kanë një emërues të përbashkët, dëshira dhe tendenca e ndikimit në sjelljen e vendimeve me interes jetik për grupin.

Për dallim nga partitë politike grupet politike të interesit në SHBA janë mirë të organizuara dhe të centralizuara. Edhe pse nga një herë është vështirë të bëhet dallimi ndërmjet veprimit të

partive politike dhe grupeve politike të interesit dallimet ekzistojnë. Partitë politike edhe formalisht në zgjedhje dalin me kandidat të tyre për të fituar kontrollin ndaj qeverisë. Ata luftojnë që kandidatët e tyre ti fitojnë zgjedhjet. Grupet politike të interesit në princip asnjë herë nuk dalin me kandidat të tyre para zgjedhësve. Por në praktikë gati se çdo herë kandidatët që fitojnë në zgjedhje janë ngushtë të lidhur me ndonjë grup interesi, kështu që si kandidatët ashtu dhe partitë e tyre politike u janë falënderues grupeve të interesit të cilat i kanë ndihmuar financiarisht gjatë fushatës zgjedhore. Kjo është edhe e logjikshme sepse grupet e interesit mbajnë llogari të veçantë për atë se kush duhet të fitojë e kush duhet të humb në zgjedhje. Ata i mbështesin kandidatët të cilët janë të përshtatshëm pasi të vijnë në pozita, pra kandidatët mbi të cilët më lehtë munden të ushtrojnë ndikimin e tyre.

Pra në këtë kuptim, shumica e hulumtuesve në SHBA por edhe jashtë tyre mendojnë se dallimi kryesorë në mes partive politike dhe grupeve politike të interesit qëndron në atë se grupet e interesit për dallim nga partitë politike nuk janë të interesuara për ta marrë pushtetin por për të ushtruar ndikimin e tyre në institucionet vendimmarrëse.¹²¹ Të gjitha analizat bëjnë të qartë se në SHBA grupet e interesit u formuan për të plotësuar zbrazëtirat e sistemit politik. Grupet politike të interesit nga një herë i zëvendësojnë partitë politike. Ata paraqesin plotësim funksional dhe në atë mënyrë bëhen pjesë përbërëse e sistemit partiak por edhe e sistemit politik. Ashtu siç potencuam edhe më lartë, opinioni publik amerikan gjatë kohë grupet e interesit nuk i shikonte me sy pozitiv. Lobimi si mënyrë e veprimit e atyre grupeve si dhe metodat tjera që i aplikonin grupet e interesit trajtoheshin si jo legale. Pra, metodat e veprimit të grupeve të interesit në princip vlerësoheshin si të palejueshme. Format e veprimit të cilat më herët shpesh herë ndërlidhenin me aferat korruptive pagëzohenin si „lobbying,„. Në fillim kjo formë veprimi nënkuptonte kontaktet e përfaqësuesve të grupeve të interesit me kongresmenë në korridoret e shtëpisë ligjvënëse para votimit të ndonjë ligji për të cilin grupa ishte e interesuar të sjellet ose të mos sjellet. Kongresmenët që u krynin punë grupeve të interesit merrnin para, andaj termi „lobbying,„ u bë sinonim i korrupsionit në politikë.

¹²¹ Etem Aziri, Partitë Politike, Zgjedhjet dhe Sistemet zgjedhore, Tetovë 2015, faqe 203-204.

Megjithate, lobimi, ndërmjetësimi apo siç e quajnë ndryshe avokaturat e specializuara nuk janë eliminuar si veprim në sistemin politik të SHBA-ve.

Përkundrazi, mënyra e vjetër e lobimit është zëvendësuar me mënyrën e re të lobimit.

PËRFUNDIMI

Hulumtimet e bëra në përqindje të konsiderueshme i kanë vërtetuar të priturat tona, në kuptimin e zhvillimit politik, karakteristikave bazë të sistemit politik amerikan, formave të organizimit politik, marrëdhënieve politike brenda sistemit, mekanizmave që ndihmojnë politikbërjen në të gjitha nivelet si dhe zhvillimin ekonomik si komponentë vendimtare në zhvillimin e shoqërisë amerikane në përgjithësi. Kushtet ideale për një zhvillim të qëndrueshëm i bënë Shtetet e Bashkuara të Amerikës „shoqëri të mundësive të pakufizuara,,.

Pas luftës qytetare SHBA-të përjetuan një ekspansion industrial që provokoi një rritje të shpejtë ekonomike dhe një koncentrim dhe centralizim të kapitalit të përmasave që nuk haseshin në pjesët tjera të globit. Nga ana tjetër ndodhi mobiliteti horizontal dhe vertikal shoqërorë i cili rezultoi me një rritje të shpejtë të standardit jetësorë të masave të gjëra popullore. E gjithë kjo ndikonte pozitivisht në zhvillimin e sistemit politik në përgjithësi.

Analizat më të thukta dhe më cilësore qartë flasin se amerikanët dukshëm dhe në mënyrë permanente kanë ndikuar në përmirsimin e sistemit të tyre politik, por kurrë nuk kanë treguar gatishmëri që ta ndryshojnë esencën e tij dhe në të njëjten mënyrë janë vënë në mbrojtje të identitetit dhe kontinuitetit. Këtë qartë e dëshmon fakti se shtyllat mbi të cilat ngritet sistemi politik i Shteteve të Bashkuara janë vendosur në kushtetutën e vetme të SHBA-ve të sjellur në vitin 1787 dhe të ratifikuar edhe nga shteti i fundit Rod Ajlëndi (Rhode Island) në vitin 1790. Shtetet e Bashkuara falë një doze të konsiderueshme të konzervatorizmit që e kultivojnë nuk kanë sjellë kushtetutë të re, por kanë plotësuar kushtetutën e vitit 1787 me 27 amandamente. Parimet bazë të kushtetutës më të vjetër, ose më mirë thënë njërës nga kushtetutat më të vjetra në botë, me gjithësejt 7 nene, kanë qenë dhe kanë mbeturë, republikanizmi, federalizmi, ndarja e pushteteve dhe ballansimi i pushtetit.

Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara çdo herë ka paraqitur burim të pashtërrshëm të zhvillimit në kontinuitet të sistemit politik dhe të sistemit shoqërorë amerikan në përgjithësi. Kushtetuta dhe interpretimi i saj në hap me kohën nga Gjykata Supreme, ndër decenie ka mundësuar

stabilitet dhe qëndrueshmëri të lartë të institucioneve të pushtetit politik. Falë mundësive adaptuese, elasticitetit të lartë dhe fleksibilitetit, kjo Kushtetutë e mbijetoi revolucionin industrial, luftën qytetare 1861-1865, shqetësimet që provokonin depresionet e kohë pas kohëshme, krizën ekonomike 1929-1933 dhe çrregullimet që i provokuan dy luftërat botërore.

Megjithatë, kjo që u tha nuk na jep të drejtë të konstatojmë se Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara është e plotëfuqishme dhe disponon me një imunitet juridiko-politik jashtë planetarë. Analizat e bëra tregojnë se principi i ndarjes së pushtetit që nënkupton një mëvetshëmëri shumë të shprehur të tre degëve të pushtetit që sipas Kushtetutës duhej ta kufizojnë njëra tjetrën dhe të mbajnë drejtëpeshimin ka pësuar deformime të caktuara falë forcimit të rolit të shtetit. Aparati i pushtetit ekzekutiv sipas forcës që disponon dhe madhësisë e kalon kornizën kushtetuese.

Sistemin e një ballansi të paraparë dhe të garantuar me kushtetutë e kanë çrregulluar edhe korporatat gjigante falë fuqisë ekonomike që disponojnë. Ata janë aq të fuqishme saqë paraqesin një kundër peshë ndaj pushtetit të presidentit.

Zhvillimi bashkëkohorë shkencor-teknik-teknologjik, dhe programi amerikan „Lufta e yjeve,, kanë sjellë ndryshime në proceset e vendimmarrjes. Kohëve të fundit teknostruktura shëndrrohet në faktor shumë të rëndësishëm në vendimmarrje. Teknostruktura paraqet asociacion të personave me njohuri teknologjike të avansuara, persona me talent të veçantë të cilët kanë vend dominant në sjelljen e vendimeve në industrinë moderne. Shtetet e Bashkuara jo rallë herë epërsinë e tyre teknologjike dhe shkencore e shfrytëzojnë për dominim dhe nënshtrim të ekonomive të shteteve tjera.

Ashtu siç kemi konstatuar në këtë punim në teorinë dhe shkencën amerikane dominon mendimi se sistemi politik i Shteteve të Bashkuara nismën e ka në pluralizmin e interesave. Në gjërësinë të asaj baze pluraliste vepron një numër i madh i interesave të llojllojshëm. Sistemi politik i SHBA-ve ia del të sigurojë një barazpeshë të interesave heterogjene në shoqëri.

Megjithatë, duhet theksuar faktin se kah fundi i shekullit të kaluar, në sistemin politik të SHBA-ve erdhi deri te çrregullimi i barazpeshës që e siguronte Kushtetuta përmes ndarjes së

pushteteve. Fuqia e pushtetit ekzekutiv falë instrumenteve me të cilat disponon u bë parësore, sidomos shiquar nga prizmi i sjelljes së vendimeve të rëndësishme, vendimeve madhore.

Sistemi politik i Shteteve të Bashkuara, gjatë tërë historisë së vet është dëshmuar jo vetëm për nga elasticiteti por edhe për nga dinamizmi. Ai është zhvilluar në hap me kohën dhe u ka paraprir proceseve në sferën e politikbërjes. Pra në këtë kuptim ai nuk është treguar konservator dhe indiferent. Sistemi politik amerikan përmes instrumenteve të shtetit në vitet e tridhëjeta të shekullit njëzet, gjatë periudhës së Depresionit të madh kontriboi përfundimisht në zbutjen e shqetësimeve sociale të provokuara nga kriza ekonomike.

Megjithatë, gjërat nuk duhet idealizuar. Edhe sistemi politik i Shteteve të Bashkuara ka zbrazëtira që patjetër një ditë të intervenohet. Ndarja aq e qartë e pushtetit në sistemin amerikan gjithësesi është një hap politiko-juridik që duhet respektuar. Por nuk jemi edhe aq të sigurtë se mospërgjegjësia e ministrave para institucionit ligjvënës e bën sistemin politik më të avansuar. Nuk mundemi me kompetencë të vëmë shenjë barazimi dhe të konstatojmë se përgjegjësia para një personi, presidentit dhe para një institucioni siç është Kongresi e ka po të njejtën peshë. Fakti se anëtarët e administratës i emëron presidenti dhe ligjërisht përgjigjen vetëm para tij e ndihmon dukshëm pozicionimin e ekzekutivit karshi ligjvënësit dhe gjyqësorit që ndikon në prishjen e ballanseve ndërmjet pushteteve.

Një kapitull në vehte paraqet zgjedhja e presidentit të shtetit. Sistemi ekzistues zgjedhor për postin e presidentit dhe zëvendës presidentit ka shumë mangësi. E para, zgjedhjet për president nuk janë të drejtëpërdrejta por të tërthorta. E dyta, parimi „unit rule“, sipas së cilit të gjitha votat e elektorëve të një shteti i takojnë partisë që e ka fituar shumicën e votave në shtetin në fjalë. E treta, vetë sistemi i elektorëve mundëson që për president në shumë raste të zgjidhet kandidati që ka fituar më pak vota, por që e ka siguruar numrin e votave të elektorëve. E katërta, sistemi i elektorëve ia imponon kandidatit për president të mbajë llogari për interesat e veçanta të grupeve të interesit nëqoftëse dëshiron të sigurojë një mbështetje më të gjërë.

Vlenë të potencohet edhe ajo se fuqizimi dhe forcimi i presidencës bashkëkohore filluar nga vitet e tridhëjeta të shekullit të kaluar është rezultat i etatizimit të shoqërisë amerikane, pra rezultat i ndryshimeve të thella në sferën politike dhe sociale. Përderisa etërit e Kushtetutës

parashikuan që Kongresi ta ndajë pushtetin me presidentin, presidenca sot i imponohet Kongresit përmes programit ligjvënës dhe politikave ligjvënëse të presidentit. Procesi i forcimit të pozitës së presidentit ndiqet nga formimi i një grupi të ngushtë të këshilltarëve dhe bashkëpunëtorëve të cilët e rrethojnë presidentin dhe ushtrojnë ndikim të madh ndaj vendimeve që merr ai.

Këtu duhet të përmenden edhe specifikat e sistemit partiak të SHBA-ve që gjithashtu ndikon në ndërtimin e presidencës bashkëkohore amerikane. Sistemi partiak amerikan është shumë difuz, i decentralizuar dhe me një nivel shumë të ulët të kohezionit. Edhe pse e proklamojnë karakterin mbi ideologjik, partitë e Shteteve të Bashkuara, drejtëpërdrejtë ose tërthorazi janë në shërbim dhe mbrojtje të rendit liberal përkatësisht neo liberal dhe raportin e forcave brenda atij rendi shoqërorë. Partitë politike si organizata me një decentralizim të lartë, më shumë paraqesin lidhje labile të partive të shteteve të veçanta se sa një organizim të vetëm të fuqishëm politik.

Sa u përket njësive federale, apo shteteve të veçanta duhet të thuhet se kanë një autonomi zhvillimore karshi organeve federale. Federata përmes fondeve të saja dhe lehtësimeve të caktuara i ndihmon shtetet më pak të zhvilluara. Edhe pushteti lokal nuk është i unifikuar në tërë territorin e Shteteve të Bashkuara. Megjithatë, edhe përpos kompleksitetit ai është mjaft funksional. Organizimi i pushtetit lokal nuk është në kompetencë të federatës, por në kompetencë të shteteve të veçanta.

Për fund duhet shtuar edhe atë se federalizmi amerikan, dhe organizimi politik brenda tij nuk janë konstitua dhe as që funksionojnë sipas ndonjë çelsi etnik. Në Shtetet e Bashkuara, rregullimi i multi etnicizmit, multi kulturalizmit, multi racizmit dhe multi konfesionalizmit është rregulluar sipas kushteve dhe rethanave amerikane që dallojnë nga vendet tjera që ballafaqohen me strukturë të ngjajshme të popullatës.

Shiquar në përgjithësi, ky punim i ka arritë qëllimet në vijim: E para, ka ofruar një qasje më ndryshe në lidhje me funksionimin dhe efikasitetin e sistemit politik të Shteteve të Bashkuara. E dyta, ka ofruar një pasqyrë të kthjellët për fleksibilitetin dhe elasticitetin e sistemit presidencial amerikan. E treta, ka ofruar të dhëna burimore për lexuesit në lidhje me mjeshtrinë e

përpiluesve të Kushtetutës së vitit 1787. E katërta, punimi ofron një pasqyrë të qartë të zhvillimit të sistemit politik të SHBA-ve nën ndikimin permanent të zhvillimit shkencor-teknologjik dhe e pesta, punimi vërteton konstatimet e veprimit më ndryshe të partive politike dhe grupeve të interesit brenda sistemit politik.

BIBLIOGRAFIA

Adams, J.Q., and Pearlie Strother-Adams (2001). Dealing with Diversity. Chicago: Kendall/Hunt. [ISBN 0-7872-8145-X](#)

["America's Founding Fathers-Delegates to the Constitutional Convention"](#). The U.S. National Archives and Records Administration. Retrieved April 16, 2016.

Aziri, Etem., Partitë Politike, Zgjedhjet dhe Sistemet zgjedhore, Tetovë 2015,

Aziri, Etem., Sistemet politike, Tetovë 2012

["Bureau of Economic Analysis"](#). www.bea.gov. Retrieved 2018-03-13.

Blackburn, Robin (1998). The Making of New World Slavery: From the Baroque to the Modern,

Bureau, U.S. Census. ["American FactFinder – Results"](#). factfinder.census.gov. Retrieved October 24, 2017.

[British Convicts Shipped to American Colonies](#). American Historical Review 2. Smithsonian Institution, National Museum of Natural History (October 1896).

Brannen Jr, Daniel E., Checks and Balances: The three branches of the American government, Thomson Gale, Detroit, 2007

Broder, David S., (March 18, 2007). ["Congress's Oversight Offensive"](#). [washington Post](http://washingtonpost.com). Retrieved 2010-09-11.

Bazan , Elizabeth B. and Elsea, Jennifer K. legislative attorneys (January 5, 2006). ["Presidential Authority to Conduct Warrantless Electronic Surveillance to Gather Foreign Intelligence Information"](#) (PDF). Congressional Research Service. Retrieved 2009-09-28.

Bianco, William T., A Proper Responsibility (1994)

Bone, Hugh A., American Politics and the Party System, New York, 1955,

Burnham, Walter Dean., Critical Elections and the Mainsprings of American Politics, New York 1970

"Committee Assignments Chart and Commentary". Ashland, Ohio: TeachingAmericanHistory.org. Retrieved April 16, 2016.

"Committees at the Constitutional Convention". U.S. Constitution Online. Retrieved April 16, 2016.

Davidson, Roger H., (Author), Congress and Its Members, 14th Edition (2006),

Dahl, Robert A., Democracy in the United States: Promise and Performance; Chicago, 1978

"Congress and the Dollar". New York Sun. Retrieved 2010-09-11

Cooper, Joseph, and Mackenzie, G. Calvin, eds., The House at Work(1981)

Chisholm, Hugh, ed. (1911). "Anti-Federalists".

Campbell, Linda P. and Elsasser, Glen., (October 20, 1991). "Supreme Court Slugfests A Tradition". Chicago Tribune. Retrieved 2010-09-11.

"CRS Report for Congress" (PDF). Senate.gov. January 22, 2003. Retrieved 4 October 2017.

Clapp, Charles L., The Congressman: His work as He Sees It, Washington,D.C.,1963

Corwin, Edward S., The President: Office and Powers, New York, 1957

Davidson, Roger H., and Oleszek, Walter, Congress and Its Members, 6th ed. (1997)

Dickson, Paul, and Clancy, Paul, The Congress Dictionary: The Ways and Meanings of Capitol Hill (1995)

Dodd, Lawrence C., and Oppenheimer, Bruce I., eds., Congress Reconsidered, 6th ed. (1997)

Dahl, R., Pluralist Democracy in the United States, Chicago,1967

Douglas, Arnold R., The Logic of Congressional Action (1990)

Encyclopedia Britannica. 2 (11th ed.). Cambridge University Press.

Eliot A., (July/August 2004). *"History and the Hyperpower"*. Foreign Affairs.

English, Ross M.; The United States Congress, Manchester Press, Manchester, 2003

Erlar, Edward., *"Essays on Amendment XIV: Citizenship"*. The Heritage Foundation.

Ferraro, Thomas., (April 25, 2007). *"House committee subpoenas Rice on Iraq"*. Reuters. Retrieved 2010-09-11.

Frantzich, Stehen E., Ernst, Howard R.; The Political Science Toolbox: A Research Companion to American Government, Rowman & Littlefield Publishin Inc, Maryland, 2009

"Frequently Asked Questions About the Minnesota Legislature". [Minnesota State Legislature](#).

2002 Census of Governments, Individual State Descriptions([PDF](#))

"Full- and Part-time Legislatures". National Conference of State Legislatures. Retrieved March 12, 2018.

"Frequently Asked Questions About the Minnesota Legislature". [Minnesota State Legislature](#).

Gerstenzang, James., (July 16, 2008). *"Bush claims executive privilege in Valerie Plame wilson case"*. Los Angeles Times. Retrieved 2009-10-04.

"Governors' Powers and Authority". Nga.org. Washington, D.C.: [National Governors Association](#). 2011.

"Government Code Section 424". State of California Legislative Council. Retrieved July 25, 2014.

Goati, Vlladimir., Politička Sociologija, Beograd 1984

Halili, Zenun., Politika dhe qeverisja e SHBA-ve, Prishtinë, 2006

Holland, Steve., (May 1, 2009). *"Obama revelling in U.S. power unseen in decades"*. Reuters UK. Retrieved 2009-09-28.

"History of the Nebraska Unicameral: The Birth of a Unicameral". Lincoln, Nebraska: Nebraska Legislature. Retrieved March 12, 2018.

"HISTORY OF BRITISH COLONIAL AMERICA". History World. 2010-06-16. Retrieved 2010-06-16.

U.S. Census Bureau. 2012 Census of Governments

Herrington, Stephen., (February 25, 2010). "Red State Anxiety and The Constitution". Huffington Post. Retrieved 2010-09-11.

Hinckley, Barbara, *Stability and Change in Congress*, 4th ed. (1987)

Jillson, Cal., *American Government: Political Change and Institutional Development*, Fourth Edition, Foutledge Pub, New York, 2008

Johnson, Gerald W., *The Presidency*, 1962

Jewell, Malcolm E., and Patterson, Samuel C., *The Legislative Process in the United States*, 4th ed. (1986)

Kinsley, Michael., (March 15, 1993). "The Case for a Big Power Swap". Time Magazine. Retrieved 2009-09-28.

KINCAID, J. LESLIE., (January 17, 1916). "TO MAKE THE MILITIA A NATIONAL FORCE.; The Power of Congress Under the Constitution "for Organizing, Arming, and Disciplining" the State Troops". The New York Times. Retrieved 2010-09-11.

Levy, Michael., (<https://www.britannica.com/topic/presidency-of-the-United-States-of-America/Selecting-a-president>)

Leiserson, A., *Parties and politics*; New York, 1958

Lowi, Theodore., *The End of Liberalism*, New York, 1969

Meltzer, D.J., (1992). "How Columbus Sickened the New World: Why Were Native Americans So Vulnerable to the Diseases European Settlers Brought With Them?". New Scientist: 38–38.

["Madison Debates September 15"](#). The Avalon Project at Yale Law School. Retrieved April 16, 2016.

Madison, James, Hamilton, Alexander and Jay, John (1987) *The Federalist Papers*, Penguin, Harmondsworth,

Maier,Pauline., *Ratification: The People Debate the Constitution, 1787–1788*. New York: Simon & Schuster, 2010.

["Madison Debates July 16"](#). The Avalon Project at Yale Law School. Retrieved March 31, 2014.

["Madison Debates August 6"](#). The Avalon Project at Yale Law School. Retrieved April 16, 2016.

["Madison Debates September 12"](#). The Avalon Project at Yale Law School. Retrieved April 16, 2016.

McDonald Forrest., The American Presidency: An Intellectual History Paperback – February 21, 1994

McMillion BJ. (2013). [President Obama's First-Term U.S. Circuit and District Court Nominations: An Analysis and Comparison with Presidents Since Reagan](#). CRS.

Mills, Wright C., *The Power Elite*, New York, 1959

McConnell, G., *Private Power and American Democracy*

Mikva, Abner J., and Saris, Patti B., *The American Congress* (1983)

Murphy, John., *The Impeachment Process*, InfoBase Publishing, New York, 2007

Nelson, Dana D., (October 11, 2008). ["The 'unitary executive' question"](#). Los Angeles Times. Retrieved 2009-10-04.

Neuman, Sigmund., *Modern political parties*; Chicago, 1957.

O'Connor, Ann, ed., *Congress A to Z: A Ready Reference Encyclopedia* (1993)

[Peopling of Americas](#). Smithsonian Institution, National Museum of Natural History (June 2004).

Parton, James., *The Life of Andrew Jackson*, voll.3, New York, 1960,

Pavkovic, Aleksandar & Radan, Peter (2007) *Creating New States: Theory and Practice of Secession* (Aldershot: Ashgate) ISBN 9780754672633

Russell, David Lee., (2005). *The American Revolution in the Southern Colonies*. Jefferson, N.C., and London: McFarland, p. 12. [ISBN 0-7864-0783-2](#).

Radler, Don., *How Congress Works*, New York, 1976

Rieselbach, Leroy N., *Congressional Reform* (1993)

Ripley, Randall B., *Congress: Process and Policy*, 4th ed. (1989)

Sartori, Giovanni., *Parties and party systems*; Cambridge, 1976.

Schlager, Najdan., Weisblatt, Jayne., Perez, Orlando J.: *World Encyclopedia of Political Systems and Parties*, Fourth edition, InfoBase Publishing, New York, 2006

Schepler, Bill., *How a law is passed*, InfoBase Publishing, New York, 2007

Sullivan, John V., (July 24, 2007). ["How Our Laws Are Made"](#).

Sisk, Gregory C., *Litigation with the Federal Government* (Philadelphia: American Law Institute, 2006), 418-425.

["Separation of Powers--Executive Veto Powers"](#). *National Conference of State Legislatures*. Retrieved March 12, 2018.

["State & Local Government"](#). whitehouse.gov. [The White House](#).

Swanson, Stevenson (September 2, 2001). ["Governors' powers ranked"](#). [Chicago Tribune](#). Retrieved November 4, 2014.

Tate, Neal.C., (Ch, Ed): *Governments of the world: A global guide to Citizen's rights and responsibilities Vol3*, Thomson Gale, Detroit, 2006

Tosqueville, Alexis de., *Democracy in America*, New York, 1956,

Turner, Jackson., (1961). [The Antifederalists: Critics of the Constitution, 1781-1788](#). The University of North Carolina Press. [ISBN 0-8078-5544-8](#).

The Library of Congress. Retrieved 2010-09-11.

["Time Essay: where's Congress?"](#). *Time Magazine*. May 22, 1972. Retrieved 2009-09-28.

["Timeline"](#). CBS News. 2010. Retrieved 2010-09-11. RANDY E. BARNETT (April 23, 2009). ["The Case for a Federalism Amendment"](#). *wall Street Journal*. Retrieved 2010-09-11.

Truman, David B., *The Governmental Process, Political Interests and Public Opinion*, New York, 1962

["The Law: The President's war Powers"](#). *Time Magazine*. June 1, 1970. Retrieved 2009-09-28.

[The President's News Conference of June 29, 1950](#)

["The Law: The President's war Powers"](#). *Time Magazine*. June 1, 1970. Retrieved 2010-09-11.

["THE PROCEEDINGS OF CONGRESS.; SENATE"](#). *The New York Times*. June 28, 1862. Retrieved 2010-09-11.

The Editorial Board. (2013). [Courts Without Judges](#). *NYTimes*.

["The Court of Appeals of Virginia"](#) (PDF). *state.va.us*. Retrieved 30 March 2018.

["The Debates in the Federal Convention of 1787 reported by James Madison : on June 15"](#). *The Avalon Project at Yale Law School*. Retrieved April 16, 2016.

["Variant Texts of the Virginia Plan, Presented by Edmund Randolph to the Federal Convention"](#). *The [Avalon Project](#) at Yale Law School*. Retrieved April 16, 2016.

Vile, John R., (2005). [The Constitutional Convention of 1787: A Comprehensive Encyclopedia of America's Founding \(Volume 1: A-M\)](#). ABC-CLIO. p. 705. [ISBN 1-85109-669-8](#). Retrieved October 21, 2015.

Vasović, Vučina., Savremene demokratije, Beograd 2006

Vile, M.J.C., Politics in the U.S.A. , London, 1976

Warren, Kenneth F. (2008). U.S. Encyclopedia of Campaigns, Elections, and Electoral Behavior

Watts, Dunvan., Understanding US/UK government and politics, Manchester University Press, Manchester, 2003

Wagner, Heather Lehr., How the president is elected, InfoBase Publishing, New York, 2007

Wilson, W., Congressional Government, New York, 1956

[Whitney, David C.,](#) The American Presidents: Biographies of the Chief Executives from Washington Through Clinton (Guild America Books) 1996

Wheeler R. (2013) [What's Behind all Those Judicial Vacancies Without Nominees?](#). Brookings Institution.

Wilson, Reid (August 23, 2013). ["GovBeat:For legislators, salaries start at zero"](#). Washington Post. Washington, DC. pp. A2. Retrieved August 26, 2013.

["What are Government Entities and Their Federal Tax Obligations?"](#). Washington, D.C.: Internal Revenue Service. Retrieved May 15, 2017.

Weisberg, Herbert F., and Patterson, Samuel C., eds., *Great Theatre: The American Congress in the 1990s* (1998).

Zuckert and Webb., *The Anti-Federalist Writings of the Melancton Smith Circle*

ZERNIKE, KATE., (September 28, 2006). ["Senate Passes Detainee Bill Sought by Bush"](#). The New York Times.

<https://sq.wikipedia.org/wiki/Federata>

<https://www.nga.org/cms/management/powers-and-authority>